



RAPORTI

(Auditim financiar dhe përputhshmërie)

BASHKIA RROGOZHINË

Tiranë, 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4 – 11
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II	HYRJA	11 - 18
1	Objektivat e auditimit	
2	Qëllimi i auditimit	
3	Identifikimi i çështjes	
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
5	Përgjegjësitë e audituesve	
6	Kriteret e vlerësimit	
7	Standardet e auditimit	
8	Metoda e auditimit	
9	Dokumentimi i auditimit	
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	18 – 128
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Rrogzhinë	15 – 18
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	18 – 128
2.1	<i>Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.</i>	<i>18 - 33</i>
2.2.	<i>Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.</i>	<i>33 – 42</i>
2.2.6	<i>Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.</i>	<i>42 – 55</i>
2.3	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2023.</i>	<i>55 – 76</i>
2.4	<i>Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit</i>	<i>76 – 84</i>
2.4.4	<i>Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.</i>	<i>84 – 92</i>
2.5	<i>Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.</i>	<i>92 – 98</i>
2.6	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit dhe Njësisë Vendore.</i>	<i>98 – 114</i>
2.7	<i>Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.</i>	<i>114 – 128</i>
IV	GJETJE DHE REKOMANDIME	128– 155
V	ANEKSE	155-170

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Rrogozhine, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Rrogozhinë për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, rezulton se mosrealizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 është në vlerën 471,540 mijë lekë. Në vetëm 4 Programe Buxhetore rezulton që vlera e parashikuar në PBA 2023-2025 të jetë e njëjtë me vlerën e shpenzimeve parashikuar në buxhetin fillestar 2023.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Rrogozhinë për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Funkcionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Organizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022,
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe - zbatimin e kontratave të punimeve.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej **19,562** mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Bashkia Rrogozhinë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim;
 - Burimet në dispozicion të strukturës audituese kanë mungesë të përvojës së punës në auditim;
 - Nuk janë realizuar fazat e përgatitjes së PBA-së për vitet 2023-2025;
 - Niveli i planifikimit të treguesve të buxhetit është në vlerën 1,449,652,029 lekë dhe realizuar në vlerën 978,111,490 lekë ose në masën 67.4%. Mos realizimi ka ardhur si rezultat i vonësive në zhvillimin e procedurave të prokurime, në lidhje kontratash apo në mosplotësim të organikës.
 - Gjendje e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Rrogozhinë në fund të vitit 2023 është në vlerën 148,534,252 lekë me burim financimi nga të ardhurat e veta;
 - Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifat vendore dhe nga dhënia me qira e sipërfaqeve të plazheve dhe ato të fondit pyjor kullosor në mënyrë progresive më datën 31.12.2023, të kenë vlerën 276,936,362 lekë.
 - Në 7 raste në procedurat e prokurimeve me vlera të vogla janë vendosur kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.
 - Në 18 raste në procedurat e prokurimeve me vlera të vogla nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues në fazën e dorëzimit të mallrave janë konstatuar mangësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë.
 - Në 2 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe më pas lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale të fondit limit 14,200,000 lekë.
 - Nga auditimi i zbatimit të punimeve për 2 kontrata është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale 157,878 lekë si pasojë e diferencave në realizimin e punimeve.
- Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren:
- Në 2 raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj;

-Në 3 raste projekti ndërtimor nuk është i plotë dhe ka mangësi në dokumentacionin e nevojshëm;

- Në 1 rast Bashkia Rrogozhinë dhe Drejtoria e Politikave Urbane nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik të banesave sociale. Nga auditimi i vendimeve të marra nga ana e IMTV, Bashkia Rrogozhinë konstatohet se:

-Në 5 raste, Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” ;

-Në 7 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”;

-Në 4 raste, IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal, për shkeljet e konstatuara;

-Në 8 raste, IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përlllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e”;

-Në 7 raste nga Kryeinspektori nuk është bërë “Kërkesë për mbështetje” drejtuar Institucioneve ligjzbatuese, në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektivit të kundërligjshëm;

-Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”, nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 285,127,409 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 49,166,662 lekë.

-Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk është përfshirë vlera 228,075,033 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifave vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore.

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 183,920,477 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 183,920,477 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Rrogozhinë, KLSH ka dhënë “Opinion të modifikuar me rezervë” për pasqyrat financiare dhe “Opinion të modifikuar” për përputhshmërinë.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar.
- Të marrin masat për ndërprerjen e angazhimeve për investime/shërbime pa fondet e nevojshme në dispozicion, kjo për të mos lejuar krijimin e detyrimeve të reja, si dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.
- Në hartimin e planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.
- Të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të taksave dhe tatimpaguesve vendorë, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, me qëllim ruajtjen dhe miradministrimin e të dhënave.
- Kryerjen e inspektimeve në terren në lidhje me statusin e subjekteve dhe të gjitha subjekteve që nga konstatimi ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar në QKB, t’u përlllogariten taksat dhe tarifave vendore përkatëse.

- Të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.
- Gjithashtu në bashkëpunim me Policinë Bashkisë dhe Inspektoriatin Mbrojtjes Territorit (IMT), nuk duhet të lejojë që në territorin e saj të përdorin sipërfaqe pyjore/kullorë pa kontratë me bashkisë.
- Të marrë masa për kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë. - Të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kunërparti llogarinë 470 “Të ardhura për t’u marrë”, si dhe pasqyrimi në kontabilitet i të gjitha detyrimeve nga taksat e tarifave vendore. -Të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,354,000 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara. - Të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.
- Për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.
- Titullari i AK Bashkia Rrogozhinë, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.
- Të marrë të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane të parashikuar në dispozitat ligjore dhe rregullatorë. - Të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqëruar të tij; - Të marrë siguri të lartë mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve; - Të miratuar vetëm ato aplikime për pajisje me çertifikatë përdorimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas dispozitave ligjore dhe rregullatorë në fuqi. DPU të kërkojë në çdo rast, ngarkimin në sistemin e-lejet të fotove në të gjitha orientimet të objektit që kërkon të pajiset me çertifikatë përdorimi; - Të kontrolluar zhvillimin e objekteve të miratuar gjatë ndërtimit, duke kërkuar hartimin e akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore, si dhe ushtrimin e kontrollit në territor në fazën e hartimit të akt-kontrolleve të përfundimit të karabinasë dhe sistemeve të jashtme.
- Të vijojë procedurën për nxjerrjen e Vendimit për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm“, për **5** subjekte që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi dhe të nxjerrë “Urdhër Ekzekutimi” për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për **7** subjekte që janë me Vendim për “Prishje Objekti të Kundërligjshëm”.-
- Të **rikërkoj** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces.
- Të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **80,300 lekë pa TVSh** nga OE “**A.-A.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 753 prot datë 24.02.2023, me objekt “Sistemim Asfaltim

- rruga Sharrdushk (Pjec) - Kryevidh, L=1400 ml”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
- Të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **77,578 lekë pa TVSh** nga OE “H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2862 prot, datë 07.08.2019, me objekt “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit, Loti III”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
 - Të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 208,542,829 lekë**, në zbatim të kuadrit ligjorë në fuqi.
 - Të marrë masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **6,840,000 lekë**, të vendosura nga IMTV. Gjithashtu, të merren masat për përlllogaritjen e kamat-vonesës dhe vjeljen e saj në çdo rast që gjobat nuk paguhen brenda afateve të përcaktuara, për vendosjen në dijeni dhe rritjen e bashkëpunimit me Shërbimin Përmbartimor, si dhe Drejtorinë e Financës dhe Shërbimit Social Bashkia Rrogozhinë.
 - Të masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **26,778,170 lekë për 1018 persona**. - Të masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e sipërfaqeve të plazheve dhe ato të fondit pyjor kullësor në vlerën **3,389,160 lekë**.
 - Të masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për vlerën detyrimit prej **43,542,236 lekë**, të subjekteve fizik/juridik sipas listave që vetë Drejtoria e Taksave administron, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin, në zbatim të kuadrit ligjorë në fuqi.

I. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

a. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë rrogozhinë për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

“Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Rrogozhinë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të modifikuar, me rezervë, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë

përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë **vlerën e materialitetit prej 19,562 mijë lekë**, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

-Nga auditimi i pasqyrave financiare ushtrimore konstatohet se për vitin 2023 nuk është realizuar procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit, ky proces ka mbetur në fazën e ngritjes së grupeve të punës. Në kushte të tilla pasqyrat financiare nuk japin siguri në lidhje me vlerat e kontabilizuara në aktiv.

-Nga auditimi i llogarisë 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje, plantacione*", 212 "*Ndërtesa e konstruksione*", 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", 214 "*Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune*", 215 "*Mjete transporti*" dhe 218 "*Inventar ekonomik*" konstatohet se nga Bashkia Rrogozhinë disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel ku në të specifikohet analitikët e këtyre llogarive si dhe në të paraqitet informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia.

-Llogaria 520 "*Disponibilitete në thesar*" paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 386,641,108 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 285,127,409 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*" në vlerën 285,127,409 lekë dhe llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në vlerën 49,166,662 lekë. Llogaria "*Disponibilitete në thesar*" është nënvlerësuar në vlerën 49,166,662 lekë.

-Në gjendjen e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk është përfshirë vlera 228,075,033 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitorë.

-Në gjendjen e llogarisë 202 "*Studime dhe kërkime*" është përfshirë projekti me objekt "*Studim Projektim i rrjetit të brendshëm ujësjellësi*" në vlerën 3,354,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohej në këtë llogari, pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit, për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

-Nga auditimi i llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" konstatohet se përpara vitit 2023 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 212,246,062 lekë në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Rrogozhinë.

-Në gjendjen e llogarisë 210 "*Toka, Troje, Terrene*" në vlerën 5,839,355 lekë kosto historike është përfshirë vlera 5,839,355 lekë, 211 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" në vlerën 1,596,452 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,483,547 lekë, 212 "*Ndërtesa e konstruksione*" në vlerën 441,699,446 lekë kosto historike është përfshirë vlera 319,460,588 lekë, 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" në vlerën 1,661,408,118 lekë kosto historike është përfshirë vlera 583,641,133 lekë, 214 "*Instalime teknike, makineri e pajisje*" në vlerën 12,201,621 lekë kosto historike është përfshirë vlera 7,951,055 lekë, 215 "*Mjete transporti*" në vlerën 34,016,264 lekë kosto historike është përfshirë vlera 7,042,960 lekë dhe 218 "*Inventar ekonomik*" në vlerën 42,051,090 lekë kosto historike është përfshirë vlera 31,337,048 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë (në formë tabelore në programin Excel), e paanalizuar, ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare

në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

-Nga auditimi i llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 59,836,638 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Rrogozhinë me NIPT J93610816L është 62,051,960 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës me NIPT M22031502M. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Rrogozhinë është 1,340,322 lekë ose 2.16%. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Klub Futboll Egnatia me NIPT M03227802Q është 3,500,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Rrogozhinë është 875,000 lekë ose 25% ($25 \times 3,500,000 / 100 = 875,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 62,051,960 lekë.

-Në gjendje të llogarisë 231 “*Për aktive afatgjata materiale*” janë kontabilizuar aktive me objekt “*Blerje kondicioner Bashkia Rrogozhinë*” në vlerën 778,900 lekë dhe “*Blerje kompjutera Bashkia Rrogozhinë*” në vlerën 789,000 lekë të cilat duhet të përfshiheshin në llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*”.

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “*Investime për aktive afatgjata jo materiale*” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” në vlerën 183,920,477 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 183,920,477 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “*Nga fondet e veta të investimeve*” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “*Teprica e grandeve kapitale të brendshme*” në vlerën 0 lekë.

-Në gjendjen e llogarisë 435 “*Sigurime shoqërore*” janë përfshirë edhe pagesat e sigurimeve shëndetësore në vlerën 578,172 lekë ku sipas trajtimit kontabël kjo vlerë duhet të kontabilizohet në llogarinë 436 “*Sigurime shëndetësore*”.

-Llogaria 466 “*Kreditorë për mjetet në ruajtje*” paraqitet në vlerën 49,116,662 lekë, nga të cilat 8,656,870 lekë i përkasin ngurtësimeve të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Rrogozhinë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve.

-Çelja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,984,651,618 lekë. Llogaria 101 kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*” në vlerën 71,630,753 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 24,425,050 lekë sipas llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit*”. Llogaria 101 debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 71,630,75 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 24,425,050 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar*” është nënvlerësuar në vlerën 96,387,066 lekë.

b. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Rrogozhinë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për Opinionin*”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar**.

Baza për opinion e modifikuar:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*” si dhe në mbështetje të

Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2018. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Dokumentacioni administrative dhe procedurat prokuruese, janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme.

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

-Niveli i planifikimit të treguesve të buxhetit është në vlerën 1,449,652,029 lekë dhe realizuar në vlerën 978,111,490 lekë ose në masën 67.4%. Mos realizimi ka ardhur si rezultat i vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurime, në lidhje kontratash apo në mosplotësim të organikës.

-Gjendje e detyrimeve të prapambetura në Bashkinë Rrogozhinë në fund të vitit 2023 është në vlerën 148,534,252 lekë me burim financimi nga të ardhurat e veta;

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifata vendore dhe nga dhënia me qira e sipërfaqeve të plazheve dhe ato të fondit pyjor kullësor në mënyrë progresive më datën 31.12.2023, të kenë vlerën 276,936,362 lekë.

- Në 2 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe më pas lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale të fondit limit 14,200,000 lekë.

-Në 7 raste në procedurat e prokurimeve me vlera të vogla janë vendosur kriteret të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve për 2 kontrata është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale 157,878 lekë si pasojë e diferencave të volumeve në realizimin e punimeve.

Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në terren:

-Në 2 raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj;

-Në 3 raste projekti ndërtimor nuk është i plotë dhe ka mangësi në dokumentacionin e nevojshëm;

- Në 1 rast Bashkia Rrogozhinë dhe Drejtoria e Politikave Urbane nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik të banesave sociale.

-Nga auditimi i vendimeve të marra nga ana e IMTV, Bashkia Rrogozhinë konstatohet se:

-Në 5 raste, Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” ;

-Në 7 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”;

-Në 4 raste, IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal, për shkeljet e konstatuara;

- Burimet njerëzore në dispozicion të strukturës audituese, kanë mungesë të përvojës së punës në auditim.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 187/1 prot., datë 20.02.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.02.2024, deri më 05.04.2024, në institucionin Bashkia Rrogozhinë u kryeauditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë” për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. Z (Përgjegjës grupi)
2. M. H, anëtar
3. A. Ç, anëtar
4. E. S, anëtar
5. P. Xh, anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Rrogozhine.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve

dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Rrogozhine, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Rrogozhine.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Rrogozhinë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësive së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.¹

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Rrogozhine dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar je me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të

¹ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Rrogozhine është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; Ligji nr. 137/2020 “*Për buxhetin e vitit 2021*” dhe Ligji nr. 115/2021 “*Për buxhetin e vitit 2022*”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “*Për përgatitjen e buxhetit vendor*”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë

Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimi i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzimi i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i

ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit. ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit². Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

² ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 187/9, datë 30.4.2024. Nga ana e Bashkisë Rrogozhine nuk është dërguar konfirmimi i marrjes së projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Rrogozhinë.

Zona Gjeografike: Rrogozhina kufizohet në Veri me Bashkinë Kavajë, në veri-lindje me Bashkinë Tiranë, në Jug me Bashkinë Lushnje, në Lindje me Bashkinë Peqin dhe në Perëndim me detin Adriatik. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Rrogozhinës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia numëron 22,148 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 40,684 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 223.5 km². Sipas regjistrit civil, densiteti i popullsisë është 182 banorë/km², ndërsa sipas censurit, densiteti është 99 banorë/km².

Bashkia Rrogozhinë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Rrogozhinë, Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Kavajës dhe Qarkut të Tiranës. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra.

Profili i bashkisë: Bashkia e Rrogozhinës shtrihet në një terren pjesërisht kodrinor dhe pjesërisht fushor deri në bregun e detit. Njësitë administrative rurale përbërëse të bashkisë kanë lidhje të kufizuara me qendrën e saj. Qyteti i Rrogozhinës zë rreth një të tretën e të gjithë popullsisë banuese të bashkisë. Dy komunat bregdetare, Gosa dhe Kryevidhi, kanë mundësi të zhvillojnë turizmin. Bashkia përfshin edhe zona të rëndësishme bujqësore, të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje të infrastrukturës rurale, sidomos lidhur me sistemet vaditëse dhe kanalet kulluese.

Aktualisht bashkia përfshin 20 kilometër vijë bregdetare. Hartimi i planeve të duhura zhvillimore, të shoqëruara me investimet e përshtatshme për rrugë, kanalizime, ndriçim dhe ujë të pijshëm ofron një mundësi për rritjen e të ardhurave të bashkisë së re, por përbën njëkohësisht edhe një sfidë për shkak se burimet aktuale buxhetore të Rrogozhinës dhe njësisive administrative janë shumë të kufizuara. Gjithashtu, infrastruktura rrugore drejt bregut të detit në ish-komunat Gosë dhe Kryevidh kanë ende nevojë për shumë investime.

Misioni i Bashkisë Rrogozhinë: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grantin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin). Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”. Ndërsa administrata (aparati) e këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me Vendimin nr. 5311 datë 06.01.2019 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Rrogozhine”. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.

Kodi i Etikës është miratuar me vendimin nr. 20 datë 25.02.2020, “Për miratimin e Kodit të Sjelljes në Bashkinë Rrogozhinë”, në mbështetje të ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik. Punonjësit janë njohur me rregulloren e brendshme të institucionit me anë të shkresës nr. 211 prot., datë 09.01.2020.

Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës.

-Me Vendimin nr. 28 prot., datë 18.01.2022 është miratuar “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave” në Bashkinë Rrogozhinë.

Gjatë vitit 2023 janë marrë 45 masa disiplinore:

42 “vërejtje me shkrim” për shkelje të rregullave të etikës;

2 “vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”;

1 “vërejtje me shkrim” për moszbatim të urdhrave të eprorit.

Bashkia i zbaton kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin për sinjalizuesit lidhur me marrjen e masave për zbatimin e procedurave antikorrupsion, por vlen të theksojmë se, **ende nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla.** Gjithashtu konstatohet se nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të ndershëm.

Nga auditimi i kryer konstatohet se zyrtarët raportues dhe zyrtari autorizues nuk kanë kryer vlerësimet e punës gjatë vitit kalendarik në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil. Nëpërmjet shkresës nr. 2488 prot., datë 12.07.2023, Drejtoria Juridike e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun ka rikujtuar drejtoritë e bashkisë mbi detyrimin ligjor për vlerësimin e rezultateve në punë,

Parimi 2 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Titullari i bashkisë nuk mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike për të gjithë komponentët dhe **nuk ka miratuar Planin e Veprimit për KB.**

Ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve periodike nga drejtoritë e bashkisë dhe njësitë e varësisë, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performace dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion. Titullari nuk ka miratuar plan menaxhimi për veprime korrigjuese/përmirësuese kur shfaqen mangësi në kontrollin e brendshëm.

Nëpërmjet shkresës nr. 835/1 prot., datë 29.02.2024 është dërguar pranë MFE-së “Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Nga auditimi konstatohet se titullari i bashkisë nuk ka përcjellë pranë MFE-së **“Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”** dhe **“Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon”**, për vitin e mëparshëm.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Me Vendimin nr. 102 datë 20.04.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë” është miratuar struktura e përbërë nga **317** punonjës, ndër të cilat **84** nëpunës civilë.

- Struktura organizative e bashkisë

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga: **Funksionet politike:** Kryetari; Zëvendëskryetarët; Administratoret; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.

Nëpunësit civilë: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

- a. Nëpunës të nivelit të lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.
- b. Nëpunës të nivelit të mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie
- c. Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori
- d. Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Struktura e Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	317	Nëpunës Civilë	
		Nëpunës me kontratë	84
Numri i të punësuarve me kontratë provizore	36	-	-
Vende vakante	9	-	-

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se përgjatë vitit 2023, janë rekrutuar **21** punonjës të rinj dhe janë larguar **29** punonjës. Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni, nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës.

Me shkresën nr. 925 prot., datë 06.10.2023, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) i ka dërguar bashkisë, raportim të mbikëqyrjes në lidhje me ligjshmërinë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira dhe vlerësimin e nëpunësve civil.

Disa nga problematikat e evidentuara në këtë vendim janë:

Për periudhën deri në shtator 2023, janë plotësuar 57 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, me punonjës me akt të përkohshëm emërimi, në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.

Komisioneri ka sjellë në vëmendjen e bashkisë se çdo marrëdhënie pune që lidhet pas fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, duhet të respektohet detyrimisht një procedurë e caktuar, që është konkurrimi. Ky proces kryhet duke ndjekur rregullat e përcaktuara shprehimisht në nenet 22, 23, 25 dhe 26 të këtij ligji dhe në aktet nënligjore që rregullojnë dispozitat e tij. Nëpërmjet shkresës nr. 3651/1 prot., datë 30.10.2023, Bashkia Rrogozhinë i ka kthyer përgjigje KMSHC-së lidhur me zbatimin e ligjshmërisë të plotësimit të pozicioneve të punës që përfshihen në sistemin e shërbimit civil, ku ndër të tjera, informon se ka ndërprerë marrëdhënien e punës për 7

punonjës dhe po punon për krijimin e strukturës së re organizative, planin vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe shpalljen e pozicioneve të punës.

Bashkia Rrogozhinë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia nuk ka hartuar dhe miratuar deklaratë të misionit dhe një strategji të miratuar me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Nuk janë zhvilluar mbledhje të menaxherëve të strukturave/ njësie të vartësisë mbi diskutime për plan strategjik.

Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku konstatohet se bashkia nuk përdor procedurat për delegimin e detyrave.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se përshkrimet e punës në bashki janë miratuar së bashku me vendimin nr. 102 datë 20.04.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë”. Për çdo punonjës të rekrutuar është krijuar dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, vërtetim të gjendjes gjyqësore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjeve të personelit, konstatohet se, një pjesë e **dosjeve të personelit janë të paplota**, në kundërshtim me VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, e cila në lidhjen 1 të saj cilëson dokumentacionin që duhet të përmbajë dosja e personelit me qëllim vërtetimin e pohimit të bërë në fletën prezantuese.

Në formë table paraqiten mangësitë e evidentuara mbi dokumentacionin përbërës të 6 dosjeve të personelit për vitin 2023 pasqyruar si më poshtë:

Bashkia Rrogozhinë					
Nr.	Emër/Mbiemër	Emërimi	Pozicioni i punës	Dokumentacioni përbërës që mungon në dosjen e rekrutimit	Nëpunës civil/Kontratë
1	L. Xh	01.09.2023	Roje Shkolle	-Dëshmi Penaliteti	Me kontratë
2	A .D	13.09.2023	Sekretar i Përgjithshëm	-Dëshmi Penaliteti -Libreza e punës	Nëpunës Civil
3	M. Xh	10.10.2023	Punonjës Shërbimi	-Libreza e punës -Certifikatë personale/familjare	Me kontratë
4	G. K	17.10.2023	Punëtor Shërbimi	-Dëshmi Penaliteti -Libreza e punës	Me kontratë
5	V. M	01.11.2023	Juriste	-Libreza e punës	Nëpunës civil
6	D. M	07.12.2023	Sanitare	-Libreza e punës	Me kontratë

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër, mangësitë e dosjeve të personelit, duke mos kryer përmirësimin dhe përditësimin e të gjitha elementeve përbërëse të tyre, ndikon negativisht në raportimin, zhvillimin dhe menaxhimin e proceseve të burimeve njerëzore.

Në lidhje me rekrutimin (punësimin) e punonjësve pranë Bashkisë Rrogozhinë

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se përgjatë vitit 2023, janë rekrutuar **21** punonjës (nëpunës civil dhe punonjës me kontratë), pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Për sa më sipër, grupi i auditimit ka verifikuar respektimin e kuadrit ligjor nga ana e bashkisë për rekrutimin (punësimin) e punonjësve gjatë kësaj periudhe kohore, konkretisht:

1-Për punësimin e z. H. Z, i punësuar me aktin nr. 281 datë 19.09.2023, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Specialist” në Drejtorinë e Politikave Urbane, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i z. **H. Z**, pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

2-Për punësimin e z. A. D, i punësuar me aktin nr. 271 datë 13.09.2023, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i z. **A. D**, pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

3-Për punësimin e z. S. V, i punësuar me aktin nr.280, datë 19.09.2023, “Urdhër për transferim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Përgjegjës” në Drejtorinë e Politikave Urbane, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i z. **S. V**, pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

4-Për punësimin e z. E. Xh, i punësuar me aktin nr. 291, datë 29.09.2023 , “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë e Bujqësisë nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

Përveç mungesës së një procedurë konkurimi të hapur për këtë pozicion, nga z. E. Xh, nuk plotësohet kriteri i arsimit në lidhje me pozicionin e punës. Konkretisht, niveli dhe lloji i arsimit që kërkohet është “master shkencor në agronomi”. Rezulton se z. E. Xh është pajisur me diplomën Master Profesional nr. MP-55-3465 pasi ka kryer studimet në vitet 2017-2019 pranë fakultetit të Shkencave të Edukimit në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në degën biologji-kimi nga ku ka marrë titullin “*Mësuesi për Biologji-Kimi me profil minor në edukim shëndetësor dhe mjedisor*”.

Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i Drejtorit të Bujqësisë **z. E. Xh**, në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

5-Për punësimin e z. S. Xh, e punësuar me aktin nr. 351 datë 09.10.2023, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Specialist ” në Drejtorinë e të Ardhurave, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

Përveç mungesës së një procedurë konkurimi të hapur për këtë pozicion, nga zj. **S. Xh**, nuk plotësohet kriteri i arsimit në lidhje me pozicionin e punës. Konkretisht, niveli dhe lloji i arsimit që kërkohet është “master profesional ose bachelor në Ekonomi/Administrim Biznesi”. Rezulton se zj. S. Xh, është pajisur me diplomën Master Profesional nr. MTI-46-87 pasi ka kryer studimet në vitet 2015-2017 në fakultetin e shkencave të natyrës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në degën Teknologjitë e informacionit.

Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i specialistes **zj. S. Xh**, në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

6-Për punësimin e z. A. D, i punësuar me aktin nr. 265 datë 11.09.2023, “Urdhër për punësim” të Kryetarit të Bashkisë në pozicionin “Koordinator i Mbrojtjes së Konsumatorit”, nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se: nga ana e Bashkisë Rrogozhinë nuk rezulton, e dokumentuar, të jetë zhvilluar një procedurë konkurrimi e hapur për këtë pozicion pune.

Grupi i auditimit vlerëson se, punësimi i z. **A. D** pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Si konkluzion, punësimi pranë Bashkisë Rrogozhinë i nëpunësve për të cilët nuk është zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi e hapur, përveçse bie ndesh me interesin publik, parimin e konkurrencës së lirë dhe barazisë përpara ligjit, ndër të tjera, përbën një risk të shtuar duke ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e punës në Bashkinë Rrogozhinë.

Për sa më sipër, Bashkia Rrogozhinë ka vepruar në kundërshtim me Kushtetutën e R. Sh., Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nenet 5, 20, 22, 23, 24, 25, 26 , VKM nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe **titullari i institucionit**.

Nga auditimi i dosjeve të punonjësve, sa i takon procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, *nuk është realizuar procesi i vlerësimit në përputhje me procedurat e hollësishme të përcaktuara në VKM-në nr.109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.*

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Nga drejtoria juridike, e burimeve njerëzore dhe marrëdhënies me publikun nëpërmjet shkresën nr. 4075/1 prot., datë 24.11.2023 është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. *Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.*

Për vitin 2023 janë kryer nga ASPA, MSHMS dhe AFK **19** trajnime ku kanë marrë pjesë **32** nëpunës të institucionit, të paraqitura Aneks 12 bashkëlidhur RPA:

Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Për vitin 2023, me shkresën nr. 651 prot., datë 16.02.2023, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 83 datë 16.02.2023 “Për ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjik në Bashkinë Rrogozhinë për vitin 2023”. Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje **9** anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se takimet e GMS, nuk dokumentohen me procesverbale. Vlen të theksojmë se GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësive publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësive si dhe përkujdeset për performancën e njësive publike.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitet publike”, pika 2.2.1 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK” a, b, c, d, pika 2.3.1;

-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit”;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, Kapitulli IV “Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”, Kapitulli V, Aneksset.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Nga auditimi i të dhënave konstatohet se, bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2023-2025 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 76 datë 27.12.2022.

Nëpërmjet shkresës nr. 80 prot., datë 27.12.2023, këshilli bashkiak ka miratuar Vendimin nr. 35 datë 27.12.2023 “Mbi Realizimin Faktik të Buxhetit 2023 për Bashkinë Rrogozhinë”.

Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, konstatohet se gjatë vitit 2023, është organizuar **1** Dëgjese Publike, ku morën pjesë qytetarë, përfaqësues të komunitetit, grupe të interesuara, subjekte, institucione shtetërore, të zgjedhur vendore, përfaqësues të biznesit, shoqëri civile etj., të cilët përfshinë të gjithë territorin e bashkisë. Nëpërmjet shkresës nr. 4992/2 prot., datë 16.12.2022 është bërë njoftimi për konsultimin publik mbi Paketën Fiskale 2023, PBA Afatmesëm 2023-2025 dhe Buxhetin e Bashkisë. Konsultimi publik është zhvilluar në datë 23.12.2022, ora 12.00 dhe kanë marrë pjesë **25** përfaqësues të komunitetit.

Bashkia nuk ka hartuar plan-veprime operationale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar. Rezulton se objektivat e miratuara nuk i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet emailit apo shkresave zyrtare.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se njësia publike nuk ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

-Konstatohet se nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe proritizimin e risqeve të përputhshmërisë. Nuk ka urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut dhe nuk janë hartuar strategjia dhe regjistri i riskut, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Rrogozhinë. Kryetari i bashkisë nuk ka deleguar funksionet e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Koordinatorit të riskut tek asnjë punonjës.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel të ulët. Bashkia Rrogozhinë ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2;
-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR”
-“Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Aneksat.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Në vijim të auditimit të kryer, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij. Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezultojnë se hartë proceseve të punës ka vetëm një prej drejtorive të bashkisë, Drejtoria e Financës.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia ka hartuar procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj.. Komisionet propozohen nga drejtorët e drejtorive sipas natyrës së objektit të prokurimit (punë, mall, shërbim etj.)

Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP... dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve. Ky regjister është publikuar në faqen e APP dhe përditësohet sa herë ka ndryshime.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikën e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.

Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike” i ndryshuar.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Bashkia ka në përdorim disa sisteme qeveritare si AMFIS dhe e-leje për të cilat rregullat e përdorimit janë të përcaktuara nga AKSHI. Hostimi i tyre kryhet nga AKSHI i cili për çdo përdorim i ofron bashkisë manuale dhe rregullore përdorimi. Të dhënat ruhen në cloud. Përveç sistemeve fikse, bashkia nuk përdor sisteme të tjera dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up-it. Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. *Bashkia nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.*

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

- **Gjurma e auditimit**

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, **bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës.** Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Bashkia nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare të dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës.

Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e dhura në buxhet.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2;
-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme nuk monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së

Bashkia Rrogozhinë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 835/1 prot., datë 29.02.2024 në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE-së.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm .

-Bashkia Rrogozhinë nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

NJAB ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2023.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. **E. M**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë; z. **N. T**, në cilësinë e Përgjegjës të Auditit të Brendshëm; z. **R. V**, në cilësinë e nëpunësit zbatues në Bashkinë Rrogozhinë; z. **H. P**, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

2.1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

NJAB, përgjatë periudhës objekt auditimi, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Urdhrit të Kryetarit nr. 102, datë 20.04.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë”, duke pasur në strukturën e saj 1 (një) Përgjegjës Sektori **z. N. T** dhe 2 (dy) specialiste auditit, **zj. D. K** dhe **z. J. B.**

Stafi auditues u intervistua lidhur me njohuritë mbi rolin, përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë e tyre për shërbimin që ofrojnë, ku u evidentua se eksperiencia profesionale e tyre në fushën e auditimit është (0-3) vite dhe rezulton se 3 (tre) audituesit janë të pa certifikuar.

Bashkia Rrogozhinë, në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së saj dhe përmbushjes së objektivave të vendosura, me Vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019, ka miratuar Rregulloren e Brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Rrogozhinë”.

Nga auditimi i kryer konstatohet se nuk janë përditësuar nenet 34-36 të Rregullores së Brendshme, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin e auditimit të brendshëm.

Struktura e njësisë AB për vitin 2023

Nr.	Periudha	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme	Aktualisht në punë apo larguar, data
	Për vitin 2023						
1	A. B	Përgjegjës	Financë	3.5	2023	1	Larguar (tetor 2023)
2	N. T	Auditues	Ekonomik	3.7	Pa certifikuar	-	Në punë
3	D. K	Audituese	Kontabilitet	1.9	Pa certifikuar	-	Në punë
4	J. B.	Auditues	Drejtësi	-	Pa certifikuar	-	Në punë

Burimi: NJAB Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Trajnimet e NjAB dhe certifikimet

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton nuk i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve për të zgjeruar njohuritë, të rrisin aftësitë dhe zotësitë e tyre nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Si konkluzion:

-NJAB, ka rekrutuar 2 (dy) auditues të cilët nuk kanë eksperiencë profesionale dhe në fushën e auditimit në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika 2/c të ligjit 114.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” që përcakton se:

c) audituesi i brendshëm duhet të këtë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në profesion dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”;

- Përgjegjësi i NJAB-së nuk ka përvojë pune në profesion dhe nuk është i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, në kundërshtim me kërkesat e nenit 1, pika 2/b të ligjit 114.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” që përcakton se:

b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të këtë përvojë pune 5 vjet në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit, dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”;

-NJAB, nuk ka filluar procesin e certifikimit për 3 (tre) auditues në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika (ç) të ligjit 114.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” që përcakton se:

ç) nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, gjatë 3 viteve të para punon nën 6 mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. **Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.**

Në rast se brenda këtij afati nëpunësi civil ose punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji.

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi: z. E. M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë; **z. H. P,** në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun.

-Komiteti i Auditit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësisë së saj, nuk është krijuar nga Bashkia Rrogozhinë.

Referuar ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12, pika b, përcakton se **Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për:** a) sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij; b) **krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike** përkatëse sipas kriterëve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12/b, 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”

Si konkluzion:

Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12/b, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

-Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB në mbështetje të Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Rrogozhinë e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr. 3807, datë 20.10.2023 dhe rezulton se është në përputhje me formatin e paraqitur në Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”.

-Planifikimi/ndryshimet dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve.

Në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, pika 3.3, kapitulli, III miratuar me Urdhrin e Ministrit të MFE Nr.100, datë 25.10.2016, përcaktohet se:

“Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga njësitë e AB, para se të dërgohet për miratim tek titullari i njësisë publike, duhet të dërgohet për mendim tek Komiteti i Auditimit të Brendshëm deri me datën 30 Shtator të çdo viti, i cili e shqyrton dhe jep mendim deri me datën **10 Tetor të çdo viti**. Planet pas dhënies së mendimit të KAB-së, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data **20 Tetor e çdo viti**, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.....”

Plani strategjik është një dokument që përgatitet nga NJAB mbi bazën e vlerësimit të riskut të njësisë publik edhe përfaqëson veprimtarinë audituese për një periudhë 3 vjeçare. Plani vjetor i auditimit hartohet vetëm pasi të jetë përfunduar plani strategjik i Auditimit të Brendshëm.

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik 2023-2025. Plani strategjik për vitet 2023-2025 dhe plani vjetor i auditimeve janë përcjellë zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë MFE, me shkresën nr. 4146 prot., datë 11.10.2022, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Nga auditimi i kryer konstatohet se, në pasqyrën nr. 1, “Vlerësimi i nivelit të risqeve për të gjithë subjektet që do të auditohen” të Planit Strategjik, kolona 2 ku duhet të paraqiten fushat/sistemet për t’u audituar, tek subjektet objekt auditimi, janë paraqitur sektorët/zyrat në varësi të Drejtorive brenda Bashkisë, ndërsa për 14 subjekte nuk janë përcaktuar fushat për auditim, ndonëse janë përcaktuar nivelet përkatëse të riskut.

Si konkluzion:

Në Planin Strategjik për vitet 2022-2024, për 14 subjekte nuk janë përcaktuar fushat për auditim, ndonëse janë përcaktuar nivelet përkatëse të riskut, në mospërputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, Pasqyra Nr.1, Vlerësimi i nivelit të risqeve për të gjithë subjektet që do të auditohen nga NJAB.

-Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2023

Nga auditimi rezultoi se:

Për vitin 2023, janë planifikuar për t’u kryer **9** auditime, është realizuar **1** angazhim auditimi dhe është në proces **1** auditim, pasqyruar si më poshtë:

Nr.	Planifikuar	Nr. Auditime	Subjekte të audituara nga NJAB	Nr. Auditime	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputhsh	Perform	Financ	IT	Kombin		
1	Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social	1									
2	Ujësullës Kanalizime SHA	1									
3	Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun	1									
4	Drejtoria Politike Urbane	1									
5	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	1									
6	Spektori i Mbrojtjes ndaj Zjarrit (MZSH)	1	Spektori i Mbrojtjes ndaj Zjarrit (MZSH)	1	1				1	1	
7	Njësia Administrative Krye vidh	1	Njësia Administrative Krye vidh	1							1
8	Policia Bashkiake	1									
9	Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik	1									
		9	Totali	2	1				1	1	1

Burimi: NJAB Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Raporti i veprimtarisë së Njësies së Auditimit të Brendshëm, është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit Auditimit të Brendshëm me shkresën nr. 554/1 prot., datë 15.02.2024. Për vitin 2023, janë dhënë **14** rekomandime gjithsej, të cilat janë pranuar nga subjektet objekt auditimi. Nga rekomandimet e pranuar janë në proces zbatimi **14** prej tyre. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelë si vijon:

Nr.	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demt)			
		Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar	Ne proces	Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2023	14	14		14	0			
TOTALI		14	14		14	0			

Burimi: NJAB Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Si konkluzion:

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se janë kryer 2 (dy) angazhime auditimi kundrejt 9 (nëntë) angazhimeve auditimi të programuara. NJAB, nuk ka audituar aktivitete që kryen Bashkia Rrogozhinë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë si: Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social, Ujësjellës Kanalizime SHA, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria Politike Urbane, Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit.

-Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB

Grupi auditimit, auditoi dokumentacionin përbërës të dy subjekteve të audituara në vitin 2023, që janë:

-dosja e auditimit të kryer në Njësinë Administrative Krye Vidh;

-dosja e auditimit të kryer në Sektorin e Mbrojtjes ndaj Zjarrit (MZSH);

1. Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Njësia Administrative Krye Vidh**, me objekt “Vlerësimi i plotë i veprimeve të marra nga menaxhimi i njësisë mbi shkallën e ndjekjes nga së ligjeve, rregullat e procedurave të zbatimit të tyre si dhe identifikimi i mangësive dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese mbi bazën e të cilave funksionon veprimtaria e Njësisë Administrative Krye vidh”

Nga Projekt-Raporti i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:

☛ Të ndihmojë njësinë administrative për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.

Konkluzion:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit **Njësia Administrative Krye Vidh** konstatohet se ka mangësi në respektimin e të gjitha proceseve për realizimin e angazhimit të auditimit, konkretisht: Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit; Vlerësimi i risqeve për sisteme/fusha të veçanta të llogarisë; Vlerësimi i përgjithshëm i riskut; Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit; Plani i veprimit i sugjeruar; Kundërshtitë (observacionet); Shkresa përcjellëse e raportit përfundimtar; Raporti përfundimtar; Reagimet (feedback) e auditimit; Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar; Memorandumi në mospërputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitullin VI që përcakton evidentimin dhe dokumentimin e punës audituese.

2. Dosja e auditimit të kombinuar për subjektin **Spektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)**, me objekt “Vlerësimi i sistemit të veprimtarisë së MZSH në mënyrë që të jenë sa me efikas në rastet e ndërhyrjeve për shuarjen e zjarrit”:

Nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer, rezulton se qëllimi i auditimit është:

☛ Të Vlerësojë nëse Spektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ka ndjekur me përpikmëri detyrat nëse janë kryer inspektimet, parandalimet, masat e marra të mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, nëse janë zbatuar të gjitha rregullat dhe ligjet me qëllim arritjen e objektivave.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit **Spektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)**, konstatohet se ka mangësi në respektimin e të gjitha proceseve për realizimin e angazhimit të auditimit, konkretisht: Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit; Takimi fillestar me organizatën (Projekt – Axhenda); Plani i veprimit i sugjeruar; Kundërshtitë (observacionet); Reagimet (feedback) e auditimit; Plani i veprimit i dërguar nga subjekti i audituar; Memorandumi në mospërputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitullin VI që përcakton evidentimin dhe dokumentimin e punës audituese.

-Në raportet e auditimit, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;

-NJAB nuk ka kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja.

-Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Për të analizuar mjedisin e kontrollit, në manual jepet formati standard 1 “Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm” në fund të kapitullit III i cili duhet të plotësohet një herë në vit dhe të bëhet si pjesë e procesit të planifikimit fillestar. Pyetësi i vlerësimit të Mjedisit të Kontrollit ka për qëllim të ndihmojë njësinë e auditimit të brendshëm të kuptojë se sa mirë menaxhohet njësia dhe se cilat janë fushat/sistemet më me risk.

NJAB, ka plotësuar pyetësin e vlerësimit për mjedisin e kontrollit të brendshëm si një nga detyrat themelore të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm është bërë nga drejtuesi dhe dy audituesit e NJAB duke qenë se nuk ka një komitet auditimi për të pasur një vlerësim më të saktë e profesional.

Si konkluzion: NJAB në Bashkinë Rrogozhinë nuk ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për MFK-në i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

-Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë, vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, NJAB nuk ka hartuar “Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm”

Si konkluzion: NJAB, nuk ka hartuar “*Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm*” në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII, i cili, referuar Standardit 1300 citon se: Programi i Siguri dhënies dhe Përmirësimit të Cilësisë Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të zhvillojë dhe të mirëmbajë programin e siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë, i cili mbulon të gjitha aspektet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

-Dosja e përhershme

Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.

Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të NJAB.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, NJAB nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi ku kryen angazhim auditimi.

Si konkluzion: NJAB nuk ka krijuar dosjet e përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

- NJAB, ka rekrutuar 2 (dy) auditues të cilët nuk kanë eksperiencë profesionale dhe në fushën e auditimit në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika 2/c të ligjit 114.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- NJAB nuk ka filluar procesin e certifikimit për 3 (tre) auditues në kundërshtim me kërkesat e nenit 11, pika (ç) të ligjit 114.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Nuk është krijuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12/b, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Në Planin Strategjik për vitet 2022-2024, për 14 subjekte nuk janë përcaktuar fushat për auditim, ndonëse janë përcaktuar nivelet përkatëse të riskut, në mospërputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III;
- Janë kryer 2(dy) angazhime auditimi kundrejt 9 (nëntë) angazhimeve auditimi të programuara. NJAB, nuk ka audituar aktivitete që kryen Bashkia Rrogozhinë, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë si: Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social, Ujësjetës Kanalizime SHA, Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun, Drejtoria Politike Urbane, Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, në mospërputhje me përcaktimet e bëra në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit;
- NjAB, për çdo angazhim auditimi të kryer përgjatë vitit 2023, nuk ka respektuar të gjitha proceset për realizimin e auditimeve në mospërputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitullin VI që përcakton evidentimin dhe dokumentimin e punës audituese;
- Në raportet e auditimit, audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara, nëse këto sisteme funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, si tek përmbledhja ekzekutive (e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara) dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar;
- NJAB nuk ka kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja;
- Nuk janë kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut;
- Nuk është hartuar “Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm” në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII;
- NjAB, nuk ka krijuar dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VI.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procedurave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (në vijim PBA) për vitet 2023-2025 konstatohet se, për realizimin e fazave të përgatitjes, Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë z. E. M. ka nxjerrë Urdhrin nr. 83, datë 16.02.2023, për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Titullari i institucionit nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programit (në vijim EMP).

Veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

EMP-të përfaqësojnë nivelin teknik menaxherial në procesin e planifikimit të PBA-së, ku fokusohen në dy çështje kryesore:

Së pari, roli i ri i stafeve teknike në procesin buxhetor (përgatitja e PBA-së) dhe së dyti, aspektet konceptuale të programeve buxhetore, definimi i qëllimeve të politikave që lidhen me funksionet që mbulon një program i caktuar buxhetor, objektivat specifike për 3 vitet e PBA-së, produktet dhe shërbimet konkrete që duhen realizuar për arritjen e tyre, si edhe treguesit përkatës të performancës. Si dhe

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA-së për vitet 2023-2025, u konstatua se nuk janë realizuar të gjitha fazat e përgatitjes si më poshtë:

-Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave i cili miratohet nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më se data 01.03.2022.

-Nuk janë hartuar tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendore për vitet 2023-2025 për çdo program, dokument i cili miratohet nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 15 Mars.

-Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së për vitet 2023-2025 për çdo program, nga Titullari i institucionit nuk është miratuar Udhëzimi i Brendshëm për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe e shpërdan tek secili Drejtues i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP).

-Nuk është hartuar udhëzimi i brendshëm për përgatitjen e PBA-së i cili përmban:

a. Listën e programeve buxhetore dhe përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve;

b. Tavanet Përgatitore të PBA-së për vitet 2023-2025 për çdo program, për tre vitet e ardhshme buxhetore;

c. Afate të detajuara për Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e kërkesave të shpenzimeve sipas programeve të PBA-së për vitet 2023-2025;

-Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (por këtu jemi në situatën kur EMP nuk është ngritur nga Titullari i institucionit) nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatori i GMS, brenda muajit Prill 2022. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet.

-Nga Sektorët e Bashkisë Rrogozhinë nuk janë hartuar kërkesat buxhetore të cilat duhen të dorëzohen tek kordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik.

-Nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2022, pranë MFE, Projektin dokumentin e PBA-së për vitet 2023-2025 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.

-Nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë organizuar takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së (pra nuk disponohen procesverbale për realizimin e këtyre takimeve).

Udhëzim nr. 8, datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025” paragrafi I, “Afatet e përgatitjes të kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”.

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetore (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 77, datë 27.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr. 2406/1 prot., datë 12.01.2024.

Në këtë VKB të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë qenë në vlerë 238,811,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 179,762,000 lekë, transfertat specifike ka vlerën 83,395,317 lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 888,487,000 lekë po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 888,487,000 lekë.

Buxheti vjetor është miratuar jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 3, ku përcaktohet që: “Bazuar në vlerësimin e të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 25 dhjetor, miraton projektbuxhetin sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji”.

Vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak është bazuar në projektvendimin dhe relacionin e hartuar nga Drejtori i Financës dhe Shërbimit Social z. R. V. dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. E. M sipas shkresës me nr. 5169 prot., datë 19.12.2023. Ky dokumentacion është dërguar pranë Këshillit Bashkiak jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 1, ku përcaktohet që: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratimin në këshill projektbuxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor”.

përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor”.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetin për vitin 2023 paraqitet sipas tabelave në vijim:

Lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Faza e I PBA 2023	Faza e II PBA 2023	Projekt Buxhet 2023
600	Paga	171,863,002	240,557,000	240,557,000	203,106,590
601	Sigurime Shoqërore	28,970,547	43,608,700	43,608,700	34,149,250
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	141,000,254	227,040,890	227,040,890	206,628,850
605	Transferta Korente të Huaja	0			0
606	Trans për Buxhuxhe Familjarë dhe Individë	388,173,902	408,734,000	408,734,000	532,196,280
I	Shpenzime Korrente	730,007,705	692,899,700	692,899,700	976,080,970
230	Kapitale të Patrupëzuara	11,606,000	5,000,000	5,000,000	8,278,000
231	Kapitale të Trupëzuara	50,865,053	115,662,090	115,662,090	110,470,000
	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	77,979,250	120,662,090	120,662,090	118,748,000
230	Kapitale të Patrupëzuara	0			0
231	Kapitale të Trupëzuara	216,387,089	477,376,910	477,376,910	229,512,630
	Shpenzime kapitale me financim të huaj	216,387,089	477,376,910	477,376,910	229,512,630
II	Shpenzime kapitale	278,858,142	598,039,000	598,039,000	348,260,630
III	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limiti				
	I+II +III Totali i shpenzimeve	1,008,865,847	1,290,938,700	1,290,938,700	1,324,341,600

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet respektive si më poshtë:

PBA-ja për vitet 2023-2025 është miratuar respektivisht me VKB-në nr. 76, datë 27.12.2022. Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023 si më poshtë:

Lekë

Emërtimi	Viti 2023
Të ardhura faktike	1,219,204,978.57
Shpenzime faktike	934,077,570

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Me VKB nr. 77, datë 27.12.2022, është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Rrogozhinë, institucioneve në varësi, njësisve administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2023. Gjithashtu më VKM-në e sipërpërmendur është miratuar niveli i pagave dhe numri i punonjësve me kontratë të përkohëshme.

Gjatë vitit 2023, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në muajin Dhjetor të vitit 2022). Këto ndryshime paraqiten si më poshtë:

-Me VKB nr. 7, datë 27.02.2023, “Për miratimin e fondit për Projektin “Tungjatjeta jetë, shërbim lëvizjes për fëmijë me aftësi të kufizuar”, në vlerën 3,607,516 lekë nga të cilat vlera prej 2,192,016 lekë do të mbulohej nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe vlera e mbetur prej 1,415,500 lekë do të mbulohej nga fondet e buxhetit vjetor të vitit 2023 nga Bashkia Rrogozhinë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr. 368/1 prot., datë 15.03.2023.

-Me VKB nr. 22, datë 19.09.2023, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 77, datë 27.12.2022, “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2023”, për të cilën do të mundësohet rritja e numrit maksimal të personelit zjarrëfikës në Sektorin e MZSH-së nga 14 punonjës në 17 punonjës me një fond shtesë në vlerën 544,500 lekë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr. 1333/1 prot., datë 04.10.2023.

-Me VKB nr. 27, datë 26.10.2023, “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr. 1481/1 prot., datë 06.11.2023.

-Me VKB nr. 28, datë 02.11.2023, “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, në vlerën 10,000,000 lekë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr. 1501/1 prot., datë 07.11.2023.

-Me VKB nr. 41, datë 27.12.2023, “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, në vlerën 21,302,000 lekë, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut me shkresën nr. 1709/1 prot., datë 29.12.2023.

Të dhëna në formë tabele për planifikimin e buxhetit bazë dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim:
Lekë

Njesia Artikulli	Emertimi	Bashkia Rrogozhinë + Ndërmarrjet e vartësisë Viti 2023						
		(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Plan Viti 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023 (VKB nr.77, datë 27.12.2022)	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(6) Fakti i 12-mujorit	(7)=(6)-(5) Diferenca	% e realizimit
600	Paga	171,863,002	240,557,000	184,895,200	203,106,590	191,803,880	11,302,710	94.44
601	Sigurime Shoqërore	28,970,547	43,608,700	31,721,400	34,149,250	32,444,450	1,704,800	95.01
600+600	Paga +Sigurime	200,833,549	284,165,700	216,621,040	237,255,840	224,248,330	13,007,510	94.52
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	141,000,254	227,040,890	196,761,000	206,628,850	145,363,580	61,265,270	70.35
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	874,850	1,020,400	1,445,000	575,000	574,280	720	99.87
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0			0	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	383,081,732	372,103,200	3,220,000	497,725,800	336,136,270	161,589,530	67.53
602-606	Shpenzime operative	4,217,320	35,610,400	24,329,000	33,895,480	2,060,740	31,834,740	6.08
	Shpenzime Korrente	529,174,156	408,734,000	225,755,000	738,825,130	708,383,200	304,411,930	95.88
230	Kapitale të Patrupëzuara	11,606,000	0	14,844,000	8,278,000	1,844,000	6,434,000	22.28
231	Kapitale të Trupëzuara	267,252,142	477,376,910	69,404,000	339,982,630	223,850,370	116,132,260	65.84
Totali	Shpenzime Kapitale	278,858,142	477,376,910	84,248,000	348,260,630	225,694,370	122,566,260	64.81
	Totali (korrente + kapitale)	1,008,865,847	1,290,938,700	526,619,600	1,324,341,600	934,077,570	390,264,030	70.53

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Pasqyra përmblendhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2023 sipas VKB përkatës të sipërpërmendura:

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor	Buxheti shtesë	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	233,811	0	233,811	600	186,867		186,867
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	11,401	0	11,401	601	33,409		33,409
Total të ardhurat e veta	250,212	0	250,212	602	207,966		207,966
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	362,296	0	362,296	604			0
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike	12,822	0	12,822	Art. 606	345,932	206,342	552,274
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023	179,762	0	179,762	230-231	84,259	229,513	313,772
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023	83,395	0	83,395	609	32,054		32,054
Transferta të kushtëzuara		435,855	435,855				
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	638,275	435,855	1,044,130				
Totali të ardhurave	888,487	435,855	1,324,342	Totali shpenzimeve	888,487	435,855	1,324,342

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2025, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

000/Lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga të ardhur e grant i pakushtëzuar e spec)	218,275	284,166	(65,891)
2	Shpenzime (602.604.609) (nga të ardhura e grant i pakushtëzuar e specif)	585,953	408,734	177,219
3	Investime Bashkia (nga të ardhura e grant i pakushtëzuar)	84,259	110,215	(25,956)
4	Investime nga FZHS	0	156,200	(156,200)
	Total i planit fillestar	0	0	0
	Shtesat nga pushteti qendror	0	0	0
5	Investime grant i kushtëzuar	229,513	210,962	18,551
6	Shpenzime për pagat (600+601)	0	0	0
7	Shpenzime (602.604.609)	206,342	119,817	86,525
	Grant i kushtëzuar (230-231)	0	0	0
	Totali	1,324,342	1,290,094	34,248

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2023 paraqitet si më poshtë:

Lekë

Kodi i detyrimit të prapambetur	Emërimi i detyrimit të prapambetur	Deyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 2023	Planifikimi për likuidim në planin e buxhetit 2023 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në fakt gjatë vitit 2023 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit
4864100	Për vendime gjyqësore	0	0	0
4864200	Për shërbime	82,373,713	33,118,899	42,813,357
4864300	Për mirëmbajtje	0	0	0
4864400	Për investime	83,318,997	23,666,206	69,149,564
4864400	Per investime nga Ministrinë e Linjës	0	0	0
4865600	Për mallra	0	0	0
4864900	Të tjera	0	0	0
	Totali	165,692,710	56,785,105	111,962,921

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

-Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të

krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak.

-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, është marrë në konsideratë realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kavajë dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate vitit		Ndryshimet e buxheteve		
	Numër datë	Vlera	Numër datë	Pakësuar artikulli/shtuar artikull			
				Shtesa artikull	Shuma	Paksime artikull	Shuma
Viti 2023	Nr. 77, datë 27.12.2022	88,8487,000	Nr. 49/3, datë 10.01.2023	(600 + 601) Paga dhe sigurime			
			Nr. 41, datë 27.12.2023	(602 – 609) Shpenzime të tjera	2,192,016		2,192,016
			Nr. 86/6, datë 27.03.2023	(602 – 609) Shpenzime të tjera	5,471,476		5,471,476
				(230 + 231) Investime	21,302,000		21,302,000
			Nr. 3895/1, datë 31.10.2023	(230 + 231) Investime	10,000,000		10,000,000
				(602) Shpenzime operative			609
				(602) Shpenzime operative			609
				(602) Shpenzime operative			609
				(602) Shpenzime operative			609
				(602) Shpenzime operative			609
				(602) Shpenzime operative			609
				(230 + 231) Investime			230+231
	(230 + 231) Investime			609			

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogzhinë.

- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Kavajë si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e

miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transferata e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Rrogozhinë, për vitin 2023									
Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit					
				Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			
						Nga transferata e pakushtëzuar	Nga transferata e kushtëzuar specifike	Nga transferata e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transferata e kushtëzuar për investimet
Paga 600	203,106,590	191,803,880	94%	102,041,070	93.5%	40,546,450	45,690,300	3,526,060	0
Sigurime shoqërore 601	34,149,250	32,444,450	95%	11,531,980	97.8%	11,331,050	8,977,170	604,250	0
ShP. Operat 602+ F. Rezervë	206,628,850	145,363,580	70.3%	71,770,410	55.7%	58,528,300	15,064,870	0	0
Subvencion Ujësjiellësi, etj. 603	0	0	-	0	-	-	0	0	0
K. Q Emergj Civile 604	34,470,480	2,635,020	7.6%	2,060,740	8.3%	574,280	0	0	0
Nd/Ekonom invalid 606	143,610,020	141,397,300	98.4%	0	-	0	0	14,139,730	0
Mjete ne ruajtje 466	0	0	-	0	-	0	0	0	0
Investime 230-231	348,260,630	225,715,120	64.8%	22,717,400	44.6%	55,282,600	0	0	147,715,120
Shpenzime 605	0	0	0	0	-	0	0	0	0
Interesa kredia 166	0	0	0	0	-	0	0	0	0
Principali 651	0	0	0	0	-	0	0	0	0
Shto, pakso sipas faktit në B.Rogozhinë	479,426,209	238,752,140	47.9%	0	-	0	0	238,752,140	0
Totali	1,449,652,029	978,111,490	67.4%	210,121,600	63.2%	166,241,280	69,732,340	384,279,750	147,715,120

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 vetëm me të ardhurat e veta vendore + transferata e pakushtëzuar, Bashkia Rrogozhinë së bashku me njësitë vartëse (analizë e cila mat saktë performancën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, pasi nuk përfshihen fondet që vijnë nga grantet):

-Artikulli 600 **“Paga personeli”** është planifikuar në vlerën 203,106,590 lekë dhe realizuar në vlerën 191,803,880 lekë ose në masën 94%.

-Artikulli **“Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”** është planifikuar në vlerën 34,149,250 lekë dhe realizuar në vlerën 32,444,450 lekë ose në masën 95%.

-Artikulli 602 **“Shpenzime operative” + Fondi Rezervë** është planifikuar në vlerën 206,628,850 lekë dhe realizuar në vlerën 145,363,580 lekë ose në masën 70.3%.

-Artikulli 604 **“Transferime korente të brendshme”** është planifikuar në vlerën 34,470,480 lekë dhe realizuar në vlerën 2,635,020 lekë ose në masën 7.6%.

-Artikulli **“Transferime për buxhetet familjare e individë”** është planifikuar në vlerën 143,610,020 lekë dhe realizuar në vlerën 141,397,300 lekë ose në masën 98.4%.

-Artikulli 230-231 **“Investime”** është planifikuar në vlerën 348,260,630 lekë dhe realizuar në vlerën 225,715,120 lekë ose në masën 64.8%.

-**Fonde për rindërtimin** janë planifikuar në vlerën 479,426,209 lekë dhe realizuar në vlerën 238,752,140 lekë ose në masën 47.9%.

Lekë

Objekti	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Dega e Thesarit		Plan	Fakt	Mbetja
Rindërtim i Shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi” Bashkia Rrogozhinë	01	4960	231	3513	VKM nr. 185, datë 30.03.2022	139,994,431	58,697,174	81,297,257
Rindërtim banesa individuale	01	6190	604	3513	VKM nr. 167, datë 18.03.2022	339,431,778	180,054,966	159,376,812
Totali						479,426,209	238,752,140	240,674,069

-Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Rrogozhinë së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2023, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken i rishikuar ka vlerën 1,449,652,029 lekë ndërsa realizimi është në vlerën 978,111,490 lekë ose në masën 67.4%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 investimet janë planifikuar në vlerën 348,260,630 lekë dhe realizuar në vlerën 225,715,120 lekë ose në masën 64.8% si de shpenzimet operative së bashku me fondin rezervë janë planifikuar në vlerën 206,628,850 lekë dhe realizuar në vlerën 145,363,580 lekë ose në masën 70.3%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Rrogozhinë në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46 “Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendore”, ku përcaktohet që: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontingjencës dhe emergjencë: Vlerat e llogaritura për këtë qëllim: Fondi rezervë dhe i emergjencës paraqitet në shumën 24,329,000 lekë.

Fondi Rezervë: Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, është krijuar Fondi rezervë.

Në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar fond rezervë në shumën 5,316,000 lekë. Fondi Rezervë nuk është përdorur në periudhën janar-dhjetor 2023.

Fondi i Kontingjencës: Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontingjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre)% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi i Kontingjencës i programuar në shumën 9,744,000 lekë nuk është përdorur.

Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile: Në zbatim të nenit 65 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, fondi i emergjencave civile planifikohet në shumë totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Në buxhetin e bashkisë janë parashikuar nga të ardhurat e veta fonde për emergjencën në shumën 9,269,000 lekë.

Subvencione: Bashkia Rrogozhinë për vitin nuk ka pasur subvencione për vitin 2023.

Kredi të marra: Bashkia Rrogozhinë nuk ka marrë kredi për vitin 2023.

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit:

Në Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet që:

Pika 19. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për përgatitjen, kontrollin e brendshëm financiar publik,

monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit, për të gjitha funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pika 20. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet këshillit, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Pika 22. Nëpunësi autorizues publikon raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të njësisë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pika 23. Nëpunësi autorizues, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet katër mujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare.

Për vitin 2023

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, konstatohet se nga Bashkia Rrogozhinë janë hartuar raportet e monitorimit mbi zbatimin e buxhetit me shkresën nr. 1003 prot., datë 30.05.2023, shkresën nr. 3493 prot., datë 29.09.2023, dhe shkresën nr. 844 prot., datë 26.02.2024.

- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.,). Detyrimet e prapambetura viti 2023:

Bashkia Rrogozhinë më datën 01.01.2022, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambeturanga të ardhurat e veta progresive në vlerën 281,220,713 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2023 vlera 0 lekë. Gjatë vitit 2023 është krijuar detyrim në vlerën 148,640,650 lekë dhe likuiduar në vlerën 281,327,111 lekë. Pra në total, gjatë vitit 2023 vlera e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2023, është në vlerën 148,534,252 lekë. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Lekë					
Nr.	Financimi	Vlera e detyrimeve më datë 31.12.2022	Shtesat gjatë vitit 2023	Likuiduar përgjatë vitit 2023	Vlera e detyrimit më datë 31.12.2023
1	Investime granti	30,958,288	26,000,000	44,165,998	12,792,290
2	Invenstime të ardhura	84,294,419	0	43,623,912	40,670,507
3	Shërbime nga granti	74,435,748	104,233,810	103,647,746	73,021,812
4	Shërbime nga të ardhurat	91,532,258	18,406,840	89,889,455	20,049,643
	Totali	281,220,713	148,640,650	281,327,111	148,534,252

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

- **Vendimet Gjyqësore:**

Gjatë vitit 2023 në Bashkinë Rrogozhinë janë aktive 38 procese gjyqësore. Në lidhje me këtë situatë nuk ka pagesa mbi humbjen e procesve gjyqësore. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si në aneksin 1 dhe 2 të Projektraportit të Auditimit për proceset gjyqësore dhe fatura e palikuiduara, si më poshtë:

- Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023
- Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023, për **investimet (Nga Granti)**;
- Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për **investimet (Nga të ardhurat e veta)**;
- Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për **mallrat dhe shërbimet (Nga Të Ardhurat e Veta)**;
- Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për **mallrat dhe shërbimet (Nga Granti)**;

- Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Për vitin 2023 Bashkia Rrogozhinë nuk ka fonde të përfituara nga FZHR.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: E. M Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. R. V me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Sociale në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Struktura organizative e aplikuar për vitin 2023 është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 102, datë 02.04.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2022”, ku pjesë e saj përfshihet edhe Drejtoria e Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik e cila përbëhet nga Sektori i Biznesit dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare. Kjo drejtori sipas strukturë së miratuar ka në përbërje të saj 8 punonjës konkretisht: 1 Drejtor të Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, 1 Përgjegjës Sektori i Tatim Taksave, 1 Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Familjare, 1 Inspektor i Tatim Taksave, 2 Specialist Tatim Taksave, 1 Specialist Kontrolli Verifikimi dhe 1 Specialist Taksambledhës. Në mënyrë të hollësishme të dhënat paraqiten si më poshtë:

Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik			
Nr.			
1	O	T	Drejtor
2	A	K	Përgjegjës Tatim-Taksave
3	M	Th	Përgjegjës i taksave dhe tarifave familjare
4	A	H	Inspektor Tatim/Takse
5	R	B	Specialist Tatim/Takse
6	S	Xh	Specialist kontrolli/verifikimi
7	E	S	Specialist Tatim/Takse
8	S	Xh	Taksambledhës

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Me VKB nr. 73, datë 27.12.2022, është miratuar struktura dhe niveli i taksave dhe tarifave vendore të cilat do të aplikohen në territorin e Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023. Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Kavajë parashikimi dhe realizimi i të ardhurave

nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023 paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2023	Fakti 2023	Diferenca	Realizimi në %
A	Të ardhurat nga taksat	115,110,905	82,894,117	32,216,788	72%
1	Taksa mbi ndërtesën	32,510,256	18,421,100	14,089,156	56.6%
2	Taksa mbi tokën bujqësore	27,058,548	19,863,313	7,195,235	73.4%
3	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	9,813,700	20,441,003	(10,627,303)	208.2%
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë	150,000	1,124,054	(974,054)	749.3%
5	Taksa e regjistrimit të automjeteve	216,000		216,000	0
6	Taksë table	1,650,000	1,486,605	163,395	90%
7	Taksa e Rentës minerale	0	0	0	-
8	Taksa e truallit	675,600	0	675,600	-
9	Tatim i thjeshtuar i biznesit të vogël	3,129,000	185,132	2,943,868	5.9%
10	Taksë tregu	612,024	0	612,024	-
11	Taksë regjistrimi biznesi	324,000	881,400	(557,400)	272%
12	Tatim mbi të ardhurat personale TAP	5,900,400	7,257,350	(1,356,95)	122.9%
13	Takse per toka e kullota	3,823,680	0	3,823,680	-
14	Takse fjetje ne hotel	6,750,517	3,991,868	2,758,649	59%
15	Takse vendore per urbanistiken	2,517,300	655,000	1,862,300	26%
16	Takse regjistrim mjeteve te perdorura	6,062,880	8,587,292	(2,524,412)	141.6%
17	Taksa te tjera	13,917,000	0	13,917,000	-
B	Të ardhurat jo tatimore	123,177,245	58,791,252	64,385,993	47.7
1	Tarifa e pastrimit	21,965,860	16,269,649	5,696,211	74%
2	Tarifa për hapsirat publike	40,113,600	30,301,158	9,812,442	75.5%
3	Tarifa e ndriçimit	873,675	1,683,715	810,040	192%
4	Tarifa e gjelbërimit	1,433,050	2,915,335	(1,482,285)	203%
5	Tarifa për reklamë	1,100,400	979,850	120,550	89%
6	Tarifa për parkim	150,000	199,500	(49,500)	133%
7	Leje Transporti	250,000	26,850	223,150	10.7%
8	Tarifa për shërbime të tjera administrative		74,500	(74,500)	0
9	Tarifa për dhënie autorizime hidrokarbureve	2,205,000	2,442,000	(237,000)	110%
10	Tarifë sporti & kultura	1,500,000	22,500	1,477,500	1.5%
11	Tarifë mirëmbajtje vaditje kullim	2,740,000	0	2,740,000	-
12	Qira toke & kullota	1,945,000	0	1,945,000	-
13	Qira ndërtese	1,381,200	1,630,499	(249,299)	118%
14	Të ardhura nga gjobat	2,704,200	767,701	1,936,499	28.3%
15	Tarife prodhimet pyjore	3,090,000	838,665	2,251,335	27.1%
16	Leje ndertimi urbanistika	20,000,000	0	20,000,000	-
17	Të tjera urbanistika & bujqesia	2,589,600	0	2,589,600	-
18	Te Ardhura nga bileta	0	0	0	-
19	Tarife Regjistrim Veprimtarie	324,000	0	324,000	-
20	Tarife per infr. nentokesore	120,000	0	120,000	-
21	Tarife Sherbimi	7,001,640	0	7,001,640	-
22	Leje Banimi	490,020	0	490,020	-
23	Tarife vendore per varerza	0	639,330	(639,330)	-
24	Te tjera	11,200,000	0	11,200,000	-
	Grand Totali	238,288,150	141,685,369	96,602,781	59.4%

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **238,288,150 lekë** dhe realizimi në vlerën **141,685,369 lekë** ose në masën **59.4%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **96,602,781 lekë**. Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

- “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” është planifikuar në vlerën 9,813,700 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 20,441,003lekë ose realizuar në masën 208.2%.
- “Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë është planifikuar në vlerën 150,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,124,054 lekë ose realizuar në masën 749.3% %.
- “Taksë regjistrimi biznesi është planifikuar në vlerën 324,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 881,400 lekë ose realizuar në masën 272% %.
- Tatim mbi të ardhurat personale TAP është planifikuar në vlerën 5,900,400 lekë ndërsa arkëtimet

janë në vlerën 7,257,350 lekë ose realizuar në masën 122.9%.

- e. Tarifa e ndriçimit është planifikuar në vlerën 873,675 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,683,715 lekë ose realizuar në masën 192%.
- f. Tarifa e gjelbërimit është planifikuar në vlerën 1,433,050 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,915,335 lekë ose realizuar në masën 203%.
- g. Tarifa për parkim është planifikuar në vlerën 150,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 199,500 lekë ose realizuar në masën 133%.
- h. Tarifa për dhënie autorizime hidrokarbureve është planifikuar në vlerën 2,205,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2,442,000 lekë ose realizuar në masën 110%.
- i. Tarifa për Qira ndërtese është planifikuar në vlerën 1,381,200 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,630,499 lekë ose realizuar në masën 118%

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

- a. “Taksa vendore mbi biznesin e vogël” është planifikuar në vlerën 3,129,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 185,132 lekë ose realizuar në masën 5.9%.
- b. “Takse vendore për urbanistiken” është planifikuar në vlerën 2,517,300 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 655,000 lekë ose realizuar në masën 26%.
- c. “Tarifa e pastrimit” është planifikuar në vlerën 21,965,860 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 16,269,649 lekë ose realizuar në masën 74%.
- d. “Taksa mbi Leje Transporti” është planifikuar në vlerën 250,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 26,850 lekë ose realizuar në masën 10.7%.
- e. “Tarifë sporti & kultura” është planifikuar në vlerën 1,500,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 22,500 lekë ose realizuar në masën 1.5%.
- f. “Të ardhura nga gjobat” është planifikuar në vlerën 2,704,200lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 767,701 lekë ose realizuar në masën 28.3%.
- g. “Tarife prodhimet pyjore” është planifikuar në vlerën 3,090,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 838,665 lekë ose realizuar në masën 27.1%

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.

Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Rrogozhinë që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit

buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

Si dhe,

Nga verifikimi i të ardhurave nga taksave dhe tarifave vendore rakorduar kjo edhe me aktrakordimet e Degës së Thesarit Kavajë dhe faturave të arkëtimit me anë të bankave të nivelit të dytë konstatohet se, në disa raste ka mospërputhje ose mbivendosje në disa prej kodeve të thesarit në lidhje me regjistrimin e të ardhurave konkretisht si më poshtë:

a) Për taksën vendore të regjistrimit të biznesit. Kjo taksë nuk është planifikuar nga ana e Bashkisë Rrogozhinë në planifikimin vjetor nga të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore, por në derdhjet e bankës nga arkëtarët është ngatërruar Kodi (7035001) nga Njësia Administrative Gosë dhe regjistrimi i arkëtimit është kryer në kodin e të ardhurave nga Taksat e Tregut.

b) Për taksën vendore për varreza. Referuar të dhënave në paketën fiskale kjo taksë nuk vilet më që prej vitit 2018 dhe ky Kod (7035045) është ngatërruar me Tarifë Vendore për Shërbime.

c) Të ardhura për qira dhe troje me Kod (7109200) i korrespondon të ardhurave nga trualli, por duke marrë në konsideratë faktin se nuk ka kod për këtë zë të dhëzat nga arkëtimet regjistrohem me kodin e sipërpërmendur.

d) Tarifë pastrimi dhe higjenë me Kod (7110501) ky kod është regjistruar nga Njësia Administrative Sinaballaj dhe arkëtimi regjistrohet gabimisht në Tarifë Pastrimi ndërkohë që duhej regjistruar në Kodin (7035014).

e) Tarifë e shërbime familjarë, për këtë zë nuk ka kod në Thesar dhe ky zë është ndarë në Tairfë Gjellbërimit dhe Tarifë Ndrëtimi për arsye se sipas të dhënave të paketës fiskale nuk ndahen gjellbërim dhe shërbim familjarë por si shumë totale.

Në lidhje me këtë situatë nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Sociale nuk dokumentohet një korrespondencë me Degën e Thesarit Kavajë për hapjen e kodeve të sipërpërmendura për regjistrimin e taskave dhe tarifave vendore respektive për çdo zëri në paketën fiskale në zbatim të trajtimit kontabël shtatëshifror sipas Klasës 7 “Struktura buxhetore”.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

- **Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:**

Në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë z. E. M nuk është përfshirë personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve me agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë, Drejtoria Rajonale e Tatime Durrës në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale dhe DSHTRR Durrës në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Rrogozhinë dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Kavajë konkretisht sipas aktrakordimit në formë elektronike më datë 08.01.2024. Nga auditimi konstatohet mangësi lidhur me mosdisponimin e aktrakordimeve me agjentët tatimorë si më poshtë:

a. Aktrakordimet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Durrës janë mbajtur vetëm për muajt janar, prill, maj, korrik, shtator dhe tetor viti 2023 pra vetëm për 6 muaj ndërsa për pjesën tjetër të vitit nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik nuk janë mbajtur aktrakordimet përkatëse. Në mënyrë të hollësishme paraqiten të dhënat si më poshtë:

-Me shkresën nr. 2068/1 prot., datë 15.05.2023, dhe me shkresën 1463 prot., datë 07.04.2023, është mbajtur aktrakordimi për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.01.2023, me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për Tatimin e Fitimit të Thjeshtuar.

-Me shkresën nr. 1970 prot., datë 26.05.2023, dhe shkresën nr. 3099/1 prot., datë 12.06.2023, është mbajtur aktrakordimi për periudhën nga data 01.04.2023, deri më 30.04.2023, me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për Tatimin e Fitimit të Thejshtuar.

-Me shkresën nr. 16895 prot., datë 02.11.2023, është mbajtur aktrakordimi për periudhën nga data 01.05.2023, deri më 31.05.2023, me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për Tatimin e Fitimit të Thejshtuar.

-Me shkresën nr. 6894 prot., datë 02.11.2023, është mbajtur aktrakordimi për periudhën nga data 01.07.2023, deri më 31.07.2023, me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për Tatimin e Fitimit të Thejshtuar.

-Me shkresën nr. 6893 prot., datë 02.11.2023, është mbajtur aktrakordimi për periudhën 01.09.2023, deri më 30.09.2023, me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për Tatimin e Fitimit të Thejshtuar.

-Me shkresën nr. 3905 prot., datë 26.10.2023, është ridërguar aktrakordimi për periudhën nga data 01.05.2023, deri më 31.05.2023, për periudhën nga data 01.07.2023, deri më 31.07.2023, dhe periudhën nga data 01.09.2023, deri 30.09.2023, me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për Tatimin e Fitimit të Thejshtuar.

-Me shkresën nr. 7598/1 prot., datë 15.12.2023, dhe me shkresën 4343 prot., datë 04.12.2023, është mbajtur aktrakordimi për periudhën 01.10.2023, deri më 31.10.2023, me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për Tatimin e Fitimit të Thejshtuar.

-Me shkresën nr. 6893 prot., datë 02.11.2023, është mbajtur aktrakordimi për periudhën 01.09.2023, deri më 30.09.2023, me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës për Tatimin e Fitimit të Thejshtuar.

b. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik nuk janë mbajtur aktrakordime me agjentët si, ASHK Kavajë dhe DSHTRR Durrës.

Konstatojmë se sipas Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik Bashkia Rrogozhinë mos arkëtimet nga ana e Drejtorisë Rajonale Vendore (ASHK Kavajë) janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës për të cilat nga Bashkia Rrogozhinë është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare me shkresën nr. 28 prot., datë 09.01.2023, që të mos i kryejnë

veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentacionin mbi kryerjen e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër Bashkia Rrogozhinë duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2023 paraqiten si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 2023	Sipas kodeve të DTHK	Realizimi 2023
1	Taksa e kalimit të pronësisë (ASHK Durrës)	150,000	7029200	1,124,054
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin (Agjenti DRT Durrës)	300,000	7020100	185,132
3	Taksa vendore e garkullimit për mjetet e përdorura (Agjenti DSHTRR Durrës)	6,062,880	7204101	8,587,929
4	Tatimi mbi të ardhurat personale (Agjenti DRT Durrës)	5,900,400	7204102	7,257,350
Totali		12,413,280		17,154,465

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”.

Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik për abonentët familjarë dhe abonentët privatë paraqiten si më poshtë:

Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik për abonentët familjarë dhe subjektet si biznesi i vogël dhe i madh paraqiten si më poshtë:

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën e Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifatat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj..

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) Bashkia Rrogozhinë nuk ka lidhur marrëveshje me Ujësjiellës Kanalizime Rrogozhinë Sh.a (sot Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës) për të luajtur rolin e agjentit tatimor.

Me shkresën nr. 752 prot., datë 19.02.2024, z. A. R me detyrë Nënkryetar i Bashkisë Rrogozhinë në cilësinë e personit të autorizuar, institucioni është drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës me kërkesë për bashkëpunim me qëllim lidhjen e një kontrate bashkëpunimi për aplikimin si agjent tatimor të SHRUKD për mbledhjen e detyrimeve nga abonentë familjarë si pjesë e faturës së konsumit me ujë. Deri më datë 05.04.2024, kjo situatë ka mbetur në fazën e shkresës së sipërcituar. Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumenti i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten të dhënat detyrimet e abonentëve familjarë për taksat dhe tarifatat vendore, si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi	Deri më datën 31.12.2022	Viti 2023	Totali progresiv	Numri i familjeve debitore
1	Taksa e tokës bujqësore	120,406,444	10,528,880	130,935,324	4235
2	Taksa e ndërtesës	28,832,042	6,616,485	35,448,527	4604
3	Tarifa e pastrimit	14,525,564	3,332,790	17,858,354	4663

4	Tarifa e shërbimit komunitar	10,665,483	3,000,075	13,665,558	4359
Totali		174,429,533	26,369,714	197,907,763	

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Në mënyrë të detajuar paraqiten të dhënat detyrimet e abonentëve familjarë për taksat dhe tarifatat vendore sipas qytetit dhe njësive administrative, si më poshtë:

Lekë

Nr.	Njësiti Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit	Tarifa e shërbimit komunitar	Totali
1	Rrogozhinë	10,269,978	13,641,063	4,028,900	2,660,300	20,948,560
2	Gose	48,092,980	8,602,400	3,315,150	2,647,670	62,658,200
3	Sinaballaj	8,355,093	1,000,761	245,800	352,400	9,954,054
4	Lekaj	28,391,487	12,028,593	4,640,367	3,228,642	48,289,089
5	Kryevidh	35,825,786	9,827,391	5,628,137	4,776,546	56,057,860
Totali		130,935,324	35,448,527	17,858,354	13,665,558	197,907,763

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë në vlerën **174,429,533 lekë**. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë krijuar debitorë në vlerën **26,369,174 lekë**. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, për abonentët familjarë janë në vlerën **197,907,763 lekë e cila përbën të ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë** si më poshtë:

1. Vlera 130,935,324 lekë për 4235 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore;
2. Vlera 35,448,527 lekë për 4604 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin Bashkisë Rrogozhinë nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës;
3. Vlera 17,858,354 lekë për 4663 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit;
4. Vlera 13,665,558 lekë për 4359 familje e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë nga mos arkëtimi i tarifës së shërbimit komunitar.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore".

Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifatat vendore:

Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjekte si biznes i vogël në vlerën 23,251,109 lekë dhe biznes i madh në vlerën 11,386,942 lekë ku totali shkon në vlerën **34,638,051 lekë**.

Përgjatë periudhës nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë krijuar debitorë subjekte si biznes i vogël në vlerën 4,481,444 lekë dhe biznes i madh në vlerën 4,422,741 lekë ku totali shkon në vlerën **8,904,185 lekë**.

Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, për subjektet biznes i vogël dhe i madh është në vlerën **43,542,236 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë**. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Nr.	Njësiti Administrative	Deri më datë 31.12.2022	2023	Totali progresiv
1	Subjektet fizik biznesi i vogël Rrogozhinë	10,568,142	1,997,417	12,565,559
2	Subjektet juridik biznesi i madh Rrogozhinë	4,238,321	2,040,991	6,279,312
3	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administrative Kryevidh	6,812,955	1,286,660	8,099,615
4	Subjektet juridik biznesi i madh Njësia Administrative Kryevidh	1,639,045	1,231,975	2,871,020

5	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administrative Gosë	3,251,273	764,780	4,016,053
6	Subjektet juridik biznesi i madh Njësia Administrative Gosë	2,575,600	533,610	3,109,210
7	Subjektet fizik biznesi i vogël Njësia Administrative Lekaj	2,618,739	432,587	3,051,326
8	Subjektet juridik biznesi i madh Njësia Administrative Lekaj	2,933,976	616,165	3,550,141
Totali		34,638,051	8,904,185	43,542,236

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Në lidhje me këtë situatë struktura tatimore e Bashkisë Rrogozhinë për asnjë nga subjektet si biznesi i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të kosiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 181 “Mos pagimi i taksës dhe tatimeve”. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, ku përcaktohet që: “Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”, Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore” si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 3, pikat 9-10.

Përlllogaritja e kamatëvonesave:

Nga auditimi konstatohet se, kamatëvonesat e aplikuara nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik për kategoritë biznesi i madh, biznesi i vogël dhe të tjera deri më datë 31.12.2023, janë në vlerën **5,319,033** lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.

Lekë

Kamatëvonesat të përlllogaritura deri më datë 31.12.2023				
Viti	Biznesi i madh	Biznesi i vogël	Të tjera	Totali
Kamatëvonesa deri më datë 31.12.2023, Njësia Administrative Gose	104,031	89,699		193,730
Kamatëvonesa nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 Njësia Administrative Gose	53,611	55,969		109,580
Kamatëvonesa deri më datë 31.12.2023 Njësia Administrative Lekaj	212,105	66,917		282,022
Kamatëvonesa nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 Njësia Administrative Lekaj	41,282	36,234		77,516
Kamatëvonesa deri më datë 31.12.2023 Njësia Administrative Kryevindh	304,085	988,427		1,292,512
Kamatëvonesa nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 Njësia Administrative Kryevindh	133,045	138,969		272,014
Kamatëvonesa deri më datë 31.12.2023 Rrogozhinë	624,114	1,372,030	664,090	2,660,234
Kamatëvonesa nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 Rrogozhinë	213,640	217,785		431,425
Totali	1,685,913	2,966,030	664,090	5,319,033

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Rrogozhinë kryhet në programin Excel. Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik nuk kryhen regjistrim

manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Rrogozhinë i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DAZHE.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DAZHE për të cilat mund të ketë gabimë në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DAZHE.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Situata e lëvizjes së subjeteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Rrogozhinë bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Rrogozhinë/Njësia Administrative Sinaballaj	1	Biznesi i Madh	2023	60	5	7	58
Rrogozhinë/Njësia Administrative Sinaballaj	2	Biznesi i Vogël	2023	161	15	19	157
Total 1+2				221	20	26	215
Njësia Administrative Gosë	3	Biznesi i Madh	2023	21	0	0	21
Njësia Administrative Gosë	4	Biznesi i Vogël	2023	92	7	5	94
Total 3+4				113	7	5	115
Njësia Administrative Kryevidh	5	Biznesi i Madh	2023	44	6	2	48
Njësia Administrative Kryevidh	6	Biznesi i Vogël	2023	114	10	4	120
Total 5+6				158	16	6	168
Njësia Administrative Lekaj	7	Biznesi i Madh	2023	11	0	0	11
Njësia Administrative Lekaj	8	Biznesi i Vogël	2023	47	0	0	47
Total 7+8				58	0	0	58

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7.

Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Rrogozhinë konstatohet se:

1. Me shkresën nr. 1379/1 prot., datë 14.04.2023 Bashkia Rrogozhinë është drejtuar QKB-së duke informuar se subjekti “E.D” me Nipt L.....E (me aktivitet shitje makinash dhe makina me qira) i ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifave vendore ndaj bashkisë.

Me aktkonstatimin me numër serie 0001344, datë 18.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 18.01.2023, subjekti mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit.

2. Me shkresën nr. 8916 prot., datë 16.06.2021, Qendra Kombëtare e Biznesit është drejtuar me kërkesë për informacion Bashkisë Rrogozhinë mbi shlyerjen e detyrimeve për subjektin “B. Ç” me Nipt L.....N (me aktivitet Bar-kafe) me qendër ushtrim aktiviteti në qytetin e Rrogozhinës me datë aplikimi për ç’regjistrim më datë 14.06.2021.

Me shkresën nr. 2565/1 prot., datë 06.07.2023, Bashkia Rrogozhinë është drejtuar QKB-së duke

informuar se subjekti i sipërpërmendur i ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj bashkisë.

Me aktkonstatimin me numër serie 0001339, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 17.01.2023, subjekti mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit.

3. Me shkresën nr. 22815 prot., datë 06.09.2022, Qendra Kombëtare e Biznesit është drejtuar me kërkesë për informacion Bashkisë Rrogozhinë mbi shlyerjen e detyrimeve për subjektin “H. K” me Nipt L.....R (me aktivitet Bar-kafe, piceri) me qendër ushtrim aktiviteti në qytetin e Rrogozhinës me datë aplikimi për ç’regjistrim më datë 02.09.2022.

Me shkresën nr. 3682/1 prot., datë 13.09.2022, Bashkia Rrogozhinë është drejtuar QKB-së duke informuar se subjekti i sipërpërmendur i ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj bashkisë.

Me aktkonstatimin me numër serie 0001338, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 17.01.2023, subjekti mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit.

4. Me aktkonstatimin me numër serie 0001337, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 17.01.2023, subjekti “M. R” me Nipt J.....N (me aktivitet tregtim me shumicë e pakicë mallra të ndryshme industrila...) mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit. Debitor për vitet 2012-2022.

5. Me aktkonstatimin me numër serie 0001333, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 17.01.2023, subjekti “R. F” me Nipt K.....U (me aktivitet tregtim artikuj të ndryshëm ushqimorë) mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit.

6. Me aktkonstatimin me numër serie 0001332, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 17.01.2023, subjekti “P.H.D” me Nipt L.....M (me aktivitet Tregtim me pakicë artikuj ushqimor dhe të ndryshëm) mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit. Debitor për vitet 2013-2022.

7. Me aktkonstatimin me numër serie 0001331, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R.B dhe z. A. K. ku në të citohet se prej datës 17.01.2023, subjekti “M.K.” me Nipt L.....R (me aktivitet tregtim metrazhe. Punime në pyje, shfrytëzim...) mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit. Debitor për vitin 2022.

8. Me aktkonstatimin me numër serie 0001329, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 17.01.2023, subjekti “A. Gj” me Nipt L.....D (Bar-kafe) mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit. Debitor për vitet 2020-2022.

9. Me shkresën nr. 1237/1 prot., datë 04.05.2022, Bashkia Rrogozhinë është drejtuar QKB-së duke informuar se subjekti i sipërpërmendur i ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj bashkisë.

Me shkresën nr. 8011 prot., datë 25.03.2022, Qendra Kombëtare e Biznesit është drejtuar me kërkesë për informacion Bashkisë Rrogozhinë mbi shlyerjen e detyrimeve për subjektin “A. R” me Nipt M.....T (me aktivitet Shit blerjesh makinash) me qendër ushtrim aktiviteti në qytetin e Rrogozhinës me datë aplikimi për ç’regjistrim më datë 23.03.2022.

Me aktkonstatimin me numër serie 0001328, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 17.01.2023, subjekti mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit. Debitor

për vitet 2021-2022.

10. Me aktkonstatimin me numër serie 0001330, datë 17.01.2023, i mbajtur nga Inspektori z. R. B dhe z. A. K ku në të citohet se prej datës 18.01.2023, subjekti “F. B” me Nipt K.....L (me aktivitet kafene dhe bar bufe) mos të ngarkohet me taksa dhe tarifa vendore në Bashkinë Rrogozhinë deri në momentin e rihapjes dhe ushtrimit të aktivitetit. Debitor për vitet 2013-2022.

11. Subjekti “D. Gj” me Nipt L.....L (me aktivitet Bar-kafe, kozmetikë, play station) referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik ky subjekt nuk ushtron më aktivitet, por në lidhje me këtë situatë nga inspektorët e kësaj drejtorie nuk është mbajtur një aktkonstatim në lidhje mos ushtrimin e aktivitetit.

12. Subjekti “K.V” me Nipt K.....K (me aktivitet tregtim me pakicëne xhamit) referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik ky subjekt nuk ushtron më aktivitet, por në lidhje me këtë situatë nga inspektorët e kësaj drejtorie nuk është mbajtur një aktkonstatim në lidhje mos ushtrimin e aktivitetit.

13. Subjekti “A. I. E. L” me Nipt K.....P (me aktivitet import-eksport) referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik ky subjekt nuk ushtron më aktivitet, por në lidhje me këtë situatë nga inspektorët e kësaj drejtorie nuk është mbajtur një aktkonstatim në lidhje mos ushtrimin e aktivitetit.

14. Subjekti “A. Sh” me Nipt L.....B (me aktivitet import-eksport fruta-perime dhe artikuj të ndryshëm) referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik ky subjekt nuk ushtron më aktivitet, por në lidhje me këtë situatë nga inspektorët e kësaj drejtorie nuk është mbajtur një aktkonstatim në lidhje mos ushtrimin e aktivitetit.

15. Subjekti “I. Sh” me Nipt L.....E (me aktivitet pajisje për sisteme gazi. Transport për nevojat e aktivitetit komion me targë A.....Y) referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik ky subjekt nuk ushtron më aktivitet, por në lidhje me këtë situatë nga inspektorët e kësaj drejtorie nuk është mbajtur një aktkonstatim në lidhje mos ushtrimin e aktivitetit. Për sa trajtuar më sipër subjektet e mësipërme pavarësisht se, për disa janë mbajtur aktkonstatime që subjektet nuk ushtrojnë aktivitet dhe për disa jo, këto subjekte janë aktive në QKB.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, neni 22, nenet 48-49.

Gjatë vitit 2023 ka ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Rrogozhinë 1 subjekt në fushën e ndërtimit i cili nuk kanë hapur nipt sekondar në zbatim të detyrimeve ligjore duke shlyer detyrimet për taksat dhe tarifën vendore ndaj institucionit konkretisht:

-Subjekti “P. V” me Nipt L.....C (me aktivitet ndërtim, rikonstruksion, restaurim në fushën e ndërtimit të objekteve të ndryshme civile...) ka ushtruar aktivitet përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Rrogozhinë referuar kontratës me nr. 1943 prot., datë 26.04.2021, me objekt “Rikonstruksion i Ujësjellësit Gosë, Bashkia Rrogozhinë” me vlerë 191,504,784 lekë me Tvsh, e amenduar me shkresat nr. 986/4 prot., datë 04.05.2022, shkresën nr. 996/3 prot., datë 27.07.2022, dhe shkresën nr. 1657/3 prot., datë 25.06.2023, me afat zbatimin e saj deri më datë 25.03.2024, me ndërkohë që ky subjekt nuk ka hapur nipt sekondar në zbatim të detyrimeve ligjore duke shlyer detyrimet për taksat dhe taksat dhe tarifën vendore ndaj institucionit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, neni 22, nenet 48-49.

- **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Politikave Urbane Bashkia Rrogozhinë në

lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave emërore për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluizinit Durrës janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe të destinuara për regjistrim në ZVRPP (sot ASHK Kavajë).

Referuar të dhënave të evidentuara në auditimin e ushtruar nga KLSH në auditimin e mëparshëm situata debitore për mos pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **më datë 31.12.2022, është në vlerën 26,778,170 lekë për 1018 persona, ndërsa për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, nga Drejtoria e Politikave Urbane nuk disponohen aktrakordime dhe të dhëna në lidhje me situatën debitore për mos likudimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se nga ASHK Kavajë nuk janë evidentuar sipërfaqet e objekteve.** Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. Në lidhje me këtë situatë evidentohen të dhënat si më poshtë:

Lekë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë				
Viti	Persona/praktika	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë	Vlera e arkëtuar	Vlera e detyrimit
Deri më datë 31.12.2022	989 praktika nga ASHK-Kavajë + 32 praktika nga zonat e stimuluar	Nga 989 + 32 = 1 021 praktika në total deri në vitin 2022, kanë paguar 603 subjekte me vlerë totale prej 26,778,170	26,778,170	1021-603=418 praktika për të vjelur TNI. Çdo praktikë paguan me formulën (sipërfaqe ndërtimi x 32105 lekë x 0.5%) Shënim: përdërisa 51 praktika janë pa sipërfaqe ndërtimi e kemi të pamundur të përlogarisim vlerën e detyrimit të përgjithshëm.
2023	228 praktika në vitin 2023 nga ASHK-Kavajë + 10 praktika nga zonat e stimuluar	Nga 228 + 10 = 238 praktika në total kanë paguar 91 subjekte me vlerë totale 4,038,023 lekë	4,038,023	Shënim: Nga ASHK-Kavajë njoftimet për afishim publik për qytetarët që u del Leja e legalizimit nuk përmbajnë sipërfaqe ndërtimi të objektit me përjashtim të njoftimeve që vijnë nga zonat e stimuluar. Për këtë arsye e kemi të pamundur të përlogarisim vlerën e detyrimit të përgjithshëm.
Totali/Progresim	(989+32+228+10)=1259 praktika në total ku prej tyre 694 kanë shlyer detyrimin per TNI		30,816,193 lekë për 694 praktika	Shënim: Në mungesë të sipërfaqeve të ndërtimit të disa objekteve e kemi të pamundur llogaritjen e vlerës totale të detyrimit.

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

- **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të liçencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Rrogozhinë dhe njësisve administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2023, gjithsej rezultojnë 14 subjekte të pajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që për 1 subjekt me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Rrogozhinë të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa liçencë, kërkesë për bashkëpunim nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Nr.	Subjekti	Nipti	Adresa	Fillimi	Përfundim i	Detyrime për tu paguar	Detyrimi i paguar	Diferenca
1	K.O. Shpk	L.....T	Lekaj	04.09.2022	04.09.2023	200,000	200,000	0
2	E. Shpk	J.....J	Sineballaj Rrogozhinë	05.01.2023	05.01.2023	200,000	200,000	0
3	M. O	J.....Q	Rrogozhinë	01.01.2023	31.12.2023	200,000	200,000	0
4	Sh. G	L.....S	Lekaj	01.01.2023	31.12.2023	200,000	200,000	0
5	G.C	K.....T	Sinaballaj	01.01.2023	31.12.2023	200,000	200,000	0
6	G.C	K.....T	Rrogozhinë	01.01.2023	31.12.2023	200,000	200,000	0
7	A.2	L.....E	Rrogozhinë	01.01.2023	31.12.2023	200,000	200,000	0
8	A.1	L.....E	Rrogozhinë	01.01.2023	31.12.2023	200,000	200,000	0
9	M. O	J.....Q	Gosë	01.01.2023	31.12.2023	200,000	200,000	0
10	A. O	K.....R	Gosë	17.09.2022	17.09.2023	200,000	200,000	0
11	Gj. O	M.....L	Kryevidh, Spill	25.08.2022	25.08.2023	200,000	200,000	0
12	O. Shpk. B	J.....L	Lekaj	01.01.2023	31.12.2023	200,000	200,000	0
13	A. T.	L.....Q	Rrogozhinë	15.02.2021	15.02.2026	100,000	100,000	0
14	K. G.	K.....F	Gosë	15.06.2021	15.06.2026	100,000	100,000	0
15	A. M	L.....I	Rrogozhinë	-	-	-	-	-
Totali						2,600,000	2,600,000	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të 197 kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, germa “b” dhe pika 9 dhe 15.

- **Të ardhurat dhe vlerat debitoare nga veprimtaritë e ndryshme dhe përdorimi i aseteve të Bashkisë Rrogozhinë:**

a. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Rrogozhinë ka lidhur 63 kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve të plazheve në zonat bregdetare si Spille (Kryevidh) dhe Vilë-Bashtovë (Gosë) (Aneksi 3 në Projektraportin e Auditimit). Nga auditimi konstatohet se, në fund të vitit 2023 janë debitorë 2 subjekte në vlerën **913,660 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.**

b. Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Rrogozhinë ka aktive 6 kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve të nga asetet e fondit pyjor kullor. Nga auditimi konstatohet se, në fund të vitit 2023 është debitorë 1 subjekt në vlerën **2,475,500 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë.**

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore, kullorore dhe improduktive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Rrogozhinë për të cilat nuk janë lidhur kontrata qiraje referuar dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik. Në territorin e Bashkisë Rrogozhinë ushtrojnë aktivitet 3 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullorore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private. Këto subjekte janë:

1. Subjekti “H...” Shpk me Nipt K.....B, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1150/1, datë 04.02.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Rrogozhinë për llojin e mineralit zhurë dhe me sipërfaqen 0.012 km².

2. Subjekti “S & V” Shpk me Nipt L.....M, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1200/2, datë 01.07.2008, për shfrytëzimin e vendburimit Lekaj për llojin e mineralit ranor konglomeratik dhe me sipërfaqen 0.138 km².

3. Subjekti “K-T” Shpk me Nipt K.....K, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1928, datë 19.11.2021, për shfrytëzimin e vendburimit objekti Zhabjak për llojin e mineralit konglomeratë dhe me sipërfaqen 0.184 km².

Veprime në kundërshtim me Neni 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullor”, pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. M Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, z. O. T Drejtor i të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik, z. A. K Përgjegjës i Tatim-Taksave, znj. M. Th Përgjegjës i taksave dhe tarifave familjare, z. A. H Inspektor Tatim/Takse, z. R. B Specialist Tatim/Takse, znj. S. Xh Specialist kontrolli/verifikimi, z. E. S Specialist Tatim/Takse, z. S. Xh Taksambledhës, z. G. Gj Drejtor i Politikave Urbane, z. E. Xh Drejtor i Bujqësisë dhe z. A. K Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

3.4. Auditim mbi administrimin e asetëve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare të Bashkisë Rrogozhinë për vitin ushtrimor 2023 janë të nënshkruara nga z. E. M Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. R. V me detyrë Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Kavajë me shkresën nr. 74 prot., datë 19.03.2024, brenda afatit ligjor.

- Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Rrogozhinë për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2023, deri më datën 31.12.2023.**

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike.

- Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 konstatohet se, deri më datë 05.04.2024, nuk është kryer procesi i inventarizimit për aktivet afatgjata por kjo situatë ka mbetur në fazën e ngritjes së grupeve të punës si më poshtë:

-Urdhri nr. 144, datë 02.04.2024, i Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023” i përbërë nga znj. A. D kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. E. B, znj. M. T, z. O. D, z. A. K.

-Urdhri nr. 145, datë 02.04.2024, i Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023” i përbërë nga znj. M. Th. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. M. K, znj. M. G, z. E. Xh, z. A. D.

-Urdhri nr. 146, datë 02.04.2024, i Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023” i përbërë nga znj. B. D kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A. S, znj. S. A.

-Urdhri nr. 147, datë 02.04.2024, i Kryetarit të Bashkisë me objekt “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023” i përbërë nga znj. Xh. Ç kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A. H, znj. S. Xh.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2023, të pozicionit financiar të Bashkisë Rrogozhinë, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

	Lekë
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	2,180,440,155
Aktivet	2,394,636,707
Pasivet	214,196,552
Aktivet Neto	2,180,440,155

	Lekë
Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2023	510,370,244
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	287,654,309
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	6,991,258
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	215,724,677

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	285,127,409	386,641,108	(101,513,699)
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	2,526,900	3,891,800	(1,364,900)
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
	Totali	287,654,309	390,432,908	(102,778,599)

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 386,641,108 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 285,127,409 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 285,127,409 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 49,166,662 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 49,166,662 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 49 dhe pika 50.

-**Llogaria 532 “Vlera të tjera”** më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 3,891,800 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 2,526,900 lekë me një pakësim në vlerën 1,364,900 lekë e cila përfaqëson vlerat me vlerë të Gjendjes Civile dhe blloqe biletarie për ushtrim aktiviteti tregtar.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
31	Materiale	5,208,826	21,535,300	(16,326,474)
32	Inventar i imët	1,782,432	9,881,008	(8,098,576)
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
	Totali	6,991,258	31,416,308	(24,425,050)

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 6,991,258 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 5,208,826 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 1,782,432 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 24,425,050 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 24,425,050 lekë.

-**Llogaria 31 “Materiale”**, ka vlerën 5,208,826 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2023	21,535,300
Shtesa (K)	13,648,849

Pakësime (D)	29,975,323
Gjendja në 31.12.2023	5,208,826

-**Llogaria 32 “Inventarë i imët”**, ka vlerën 1,782,432 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

		Lekë
Lëvizjet e llogarisë		Vlera
Çelje e vitit 2023		9,881,008
Shtesa (K)		5,629,860
Pakësime (D)		13,728,436
Gjendja në 31.12.2023		1,782,432

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

					Lekë
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022	
	Llogari të arkëtueshme				
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	4,906,701	5,447,339	(540,638)	
431	Tatime e taksa	0	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0	
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0	
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0	
44	Institucione të tjera publike	0	0	0	
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0	
468	Debitorë te ndryshëm	45,738,086	38,491,329	7,246,757	
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	165,079,890	184,251,587	(19,171,697)	
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0	
	Totali	215,724,677	288,190,255	(72,465,578)	
	Të tjera aktive afatshkurtra				
409	Parapagime	0	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0	
	Totali	0	0	0	

Gjendja e llogarisë **423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”** më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 5,447,339 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 4,906,701 lekë me një pakësim në vlerën 540,638 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë
Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”		
Çelje e vitit 2023		5,447,339
Shtesa (K)		0
Pakësime (D)		620,000
Gjendja debitore në 31.12.2023		4,906,701

Gjendja e llogarisë **468 “Debitorë të ndryshëm”** më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 38,491,329 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 45,738,086 lekë me një rritje në vlerën 7,246,757 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë
Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		
Çelje e vitit 2022		38,491,329
Shtesa (K)		12,003,401
Pakësime (D)		4,756,644

Gjendja debitore në 31.12.2022	45,738,086
--------------------------------	------------

Lekë

Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Debitorë biznesi Rrogozhina	17,182,127	5,701,152	4,038,408	18,844,871
Gosa	5,860,693	1,298,390	0	7,159,083
Lekaj	3,400,634	1,048,752	0	4,449,386
Kryevidh	9,852,025	3,955,107	718,236	13,088,896
OE "E" Shpk	2,011,000	0	0	2,011,000
OE "M" Shpk	74,461	0	0	74,461
OE "M" Shpk	13,288	0	0	13,288
OE "M" Shpk	37,101	0	0	37,101
OE "B. T"	60,000	0	0	60,000
Totali	38,491,329	12,003,401	4,756,644	45,738,086

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk është përfshirë vlera 228,075,033 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorisë së Financës dhe Shërbimit Social. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur për debitorët nga taksat dhe tarifat vendore paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Nr.	Debitorët	Situata debitore më datë 31.12.2023
1	Abonentët familjarë	197,907,763
3	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	26,778,170
4	Subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre	913,600
5	Dhënia me qira e tokave buqësore dhe sipërfaqeve për vendosjen e antenave	2,475,500
	Totali	228,075,033

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" me kundërparti llogarinë 468 "Kreditorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

Gjendja e llogarisë 4342 "Operacion me shtetin (të drejta)" më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 184,251,587 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 165,079,890 lekë me një pakësim në vlerën 19,171,697 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"	
Çelje e vitit 2023	184,251,587
Shtesa (K)	122,903,007
Pakësime (D)	142,074,704
Gjendja debitore në 31.12.2023	165,079,890

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	II. Aktive Afatgjata	1,884,266,463	1,959,055,370	(74,788,907)
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	34,553,999	32,709,998	1,844,001
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	34,553,999	32,709,998	1,844,001
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	1,603,740,027	1,622,960,884	(19,220,857)
210	Toka, Troje, Terene	5,839,355	5,839,355	0
211	Pyje, Plantacione	1,596,452	1,596,452	0
212	Ndërtesa e konstruksione	303,495,063	283,192,965	20,302,098
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,267,518,398	1,315,617,260	(48,098,862)
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	2,937,380	3,311,726	(374,346)
215	Mjete transporti	7,156,753	8,365,941	(1,209,188)
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	15,196,626	5,037,186	10,159,440
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	62,051,960	62,051,960	0
25	Huadhënie e nën-huadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	62,051,960	62,051,960	0
	4. Investime	183,920,477	241,332,528	(57,412,051)
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	183,920,477	241,332,528	(57,412,051)

1. Aktivët Afatgjata Jomateriale.

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 32,709,998 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,844,001 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,800,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 34,553,999 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		34,509,998
	2	Amortizim i akumuluar		1,800,000
	3	Gjendja në 01.01.2022		32,709,998
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)		1,844,001
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		36,353,999
	5	Amortizim i akumuluar		1,800,000
	6	Gjendja më datë 31.12.2022		34,553,999

Lekë

Studime-Projektme (kosto historike)		Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari					
Studim Projektim i rrjetit të brendshëm ujësjellësi		3,354,000	0	0	3,354,000
Studim Projektim rrugë dhe sheshe		32,999,999	0	1,884,001	31,155,998
Totali		36,353,999	0	1,884,001	34,509,998

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti me objekt “Studim Projektim i rrjetit të brendshëm ujësjellësi” në vlerën 3,354,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohej në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 5,839,335 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,839,355 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		5,839,355
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2023		5,839,355
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		5,839,355
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		5,839,355

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 1,596,452 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,596,452 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		1,596,452
	2	Amortizim i akumuluar		0
	3	Gjendja në 01.01.2023		1,596,452
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		0
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		1,596,452
	5	Amortizim i akumuluar		0
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		1,596,452

-Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 283,192,965 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 36,275,522 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 138,204,383 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 303,495,063 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	405,423,924
	2	Amortizim i akumuluar	122,230,959
	3	Gjendja në 01.01.2023	283,192,965
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	36,275,522
	5	Amortizim i shtesës	15,973,424
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	441,699,446
	5	Amortizim i akumuluar	138,204,383
6	Gjendja më datë 31.12.2023	303,495,063	

-Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 1,315,617,260 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 18,612,633 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 393,889,720 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,267,518,398 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" Objekte inventari		Lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,642,795,485	
	2	Amortizim i akumuluar	327,178,255	
	3	Gjendja në 01.01.2022	1,315,617,260	
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	18,612,633	
	5	Amortizim i shtesës	66,711,495	
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0	
	7	Amortizim nga pakësimet	0	
	4	Kosto historike	1,661,408,118	
	5	Amortizim i akumuluar	393,889,720	
6	Gjendja më datë 31.12.2022	1,267,518,398		

Nga auditimi i llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" konstatohet se, janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 212,246,062 lekë që i përket objektit "Ndërtimi i rrjetit të brendshëm i ujësjellës të qytetit Bashkia Rogozhinë Faza e III", në Ujësjellës Kanalizime Sh.a Rogozhinë (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Rogozhinë. Nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Rogozhinë dhe Ujësjellës Kanalizime Sh.a Rogozhinë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 35

-Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 3,311,726 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 360,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 9,624,241 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,937,380 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" Objekte inventari		Lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	12,201,621	
	2	Amortizim i akumuluar	8,889,895	
	3	Gjendja në 01.01.2023	3,311,726	
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	360,000	
	5	Amortizim i shtesës	734,345	
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0	

	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	12,561,621
	5	Amortizim i akumuluar	9,624,241
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	2,937,380

-Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 8,365,941 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 580,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 27,439,511 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 7,156,753 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	34,016,264
	2	Amortizim i akumuluar	25,650,323
	3	Gjendja në 01.01.2023	8,365,941
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	580,000
	5	Amortizim i shtesës	1,789,188
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	34,596,264
	5	Amortizim i akumuluar	27,439,511
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	7,156,753

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 5,037,186 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 13,958,597 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 26,854,464 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 15,196,626 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	28,092,493
	2	Amortizim i akumuluar	23,055,307
	3	Gjendja në 01.01.2022	5,037,186
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	13,958,597
	5	Amortizim i shtesës	3,799,157
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	42,051,090
	5	Amortizim i akumuluar	26,854,464
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	15,196,626

a. Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terene” në vlerën 5,839,355 lekë kosto historike është përfshirë vlera 5,839,355 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

b. Në gjendjen e llogarisë 211 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 1,596,452 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,483,547 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

c. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 441,699,446 lekë kosto historike është përfshirë vlera 319,460,588 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me

plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

d. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,661,408,118 lekë kosto historike është përfshirë vlera 583,641,133 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

e. Në gjendjen e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 12,201,621 lekë kosto historike është përfshirë vlera 7,951,055 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

f. Në gjendjen e llogarisë 215 “Mjete transporti” në vlerën 34,016,264 lekë kosto historike është përfshirë vlera 7,042,960 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

g. Në gjendjen e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 42,051,090 lekë kosto historike është përfshirë vlera 31,337,048 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rrogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Në mënyrë analitike paraqiten të dhënat si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Rrogozhinë	Sinaballaj	Gosë	Lekaj	Kryevidh	Totali
210	2,996,954	0	2,842,400	0	0	5,839,354
211	1,483,547	0	0	0	0	1,483,547
212	91,457,312	11,380,162	78,089,364	66,110,094	72,423,656	319,460,588
213	117,995,406	23,667,576	118,617,229	122,544,365	200,816,557	583,641,133
214	4,396,870	0	0	0	3,554,185	7,951,055
215	3,675,360	0	0	0	3,367,600	7,042,960
218	15,398,733	2,137,203	45,500	0	13,755,612	31,337,048
Totali	237,404,182	37,184,941	199,594,493	188,654,459	293,917,610	956,755,685

Shënim: Pjesë e të dhënave të aktiveve të transferuara janë të përfshira edhe aktivet e transferuara nga Bordi i Kullimit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30.

Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 59,836,638 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Rogozhinë me Nipt J.....L është 62,051,960 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës me Nipt M.....M. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Rogozhinë 1,340,322 lekë ose 2.16% ($2.16 * 62,051,960 / 100 = 1,340,322$ lekë). Vlera e

aksioneve të Sh. A. K. F. E me Nipt M.....Q është 3,500,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Rogozhinë është 875,000 lekë ose 25% ($25 \times 3,500,000 / 100 = 875,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 62,051,960 lekë.

Veprime në kundërshtim me Standardi Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

- **Invenstimet**

Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 241,332,528 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 223,850,372 lekë dhe pakësim në vlerën 281,262,423 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 183,920,477 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llekë	
Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Gjendje në 01.01.2023	241,332,528
Shtesa (K)	223,850,372
Pakësime (D)	281,262,423
Gjendja në 31.12.2023	183,920,477

Llekë	
Për aktive Afatgjata materiale (kosto historike)	
Objekte inventari	
	Gjendja 01.01.2023
Rikonstruksioni i rrugës Greth-Rreth Greth	26,000,000
Sistemim asfaltim rruga Shardushk-Piect	9,005,678
Blerje kondicionerë Bashkia Rogozhinë	778,900
Blerje kompjutera Bashkia Rogozhinë	789,000
Rikonstruksion rruga e varrezave Lekaj	13,000,000
Rikonstruksion rruga stacioni i trenit Rogozhinë	2,868,054
Totali	183,920,477

Në gjendje të llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” janë kontabilizuar aktive me objekt “Blerje kondicioner Bashkia Rogozhinë” në vlerën 778,900 lekë dhe “Blerje kompjutera Bashkia Rogozhinë” në vlerën 789,000 lekë të cilat duhet të përfshiheshin në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1.

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 183,920,477 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 183,920,477 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, gërma “c”.

- **Auditim mbi administrimin e asetëve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Rrogozhinë, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Rrogozhinë i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrija e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Rrogozhinë. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Rrogozhinë duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Rrogozhinë dhe Njësi Administrative Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre **brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Rrogozhinë, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, pra nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastrë.

b. Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se nga Bashkia Rrogozhinë disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel ku në të specifikohet analitikët e këtyre llogarive si dhe në të paraqitet informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Rrogozhinë ka në pronësi në total **2233 pasuri** të cilat janë transferuar sipas VKM-ve si më poshtë:

➤ **Bashkia Rrogozhinë:**

-Me VKM nr. 624, datë 07.09.2011, “Miratimi i listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Rrogozhinë, të qarkut Tiranë”. Lista e inventarit me 64 fletë që i bashkangjitet vendimit, përfundon me numrin rendorë 380.

➤ **Njësia Administrative Lekaj:**

-Me VKM nr. 115, datë 17.02.2011, “Miratimi i listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Lekaj, të qarkut Tiranë”. Lista e inventarit me 95 fletë që i bashkangjitet vendimit, përfundon me numrin rendorë 628.

➤ **Njësia Administrative Gosë:**

-Me VKM nr. 94, datë 06.02.2013, “Miratimi i listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Gosë, të qarkut Tiranë”. Lista paraprake sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Gosë të qarkut të Tiranës, miratuar me Vendimin nr. 718, datë 30.10.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunës Gosë, të qarkut Tiranë”.

➤ **Njësia Administrative Kryevidh:**

-Me VKM nr. 741, datë 08.09.2010, “Miratimi i listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kryevidh, të qarkut Tiranë”. Lista e inventarit me 95 fletë që i bashkangjitet vendimit, përfundon me numrin rendorë 794.

➤ **Njësia Administrative Sinaballaj:**

-Me VKM nr. 647, datë 31.07.2013, “Miratimi i listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Sinaballaj, të qarkut Tiranë”. Lista e inventarit me 95 fletë që i bashkangjitet vendimit, përfundon me numrin rendorë 256.

c. Në total në pronësi të Bashkisë Rogozhinë janë **2,233 pasuri** të transferuara sipas VKM-ve të sipërpërmendura **për të cilat janë pajisur me çertifikatë pronësie 8 pasuri**, si më poshtë:

Nr.	Bashkia/Njësiti Administrative	Numri i pronave të tranferuara	Prona të rregjistruara	Prona të pa rregjistruara
1	Bashkia Rogozhinë	VKM nr. 624, datë 07.09.2011, 380 pasuri	3	377
2	Njësia Administrative Lekaj	VKM nr. 115, datë 17.02.2011, 628 pasuri	2	626
3	Njësia Administrative Gosë	VKM nr. 94, datë 06.02.2013, 175 pasuri	1	174
4	Njësia Administrative Kryevidh	VKM nr. 741, datë 08.09.2010, 794 pasuri	2	792
5	Njësia Administrative Sinaballaj	VKM nr. 647, datë 07.09.2011, pasuri 256	0	256
Totali		2,233	8	2,225

Burimi i të dhënave: Bashkia Rogozhinë.

Si dhe përgjatë vitit 2023 janë kryer edhe 8 aplikime për pajisjen me çertifikatë pronësie si më poshtë:

Emërtimi	Zona Kadastrale	Numër pasurie	Indeksi i hartës	Sipërfaqe sipas VKM		Sipërfaqe sipas faktit	
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim
Terren sportiv	3234	2/143	RRO-J-6	13,581	0	13,205	0
Shkollë Xh. Soros	3234	1/134	RRO-J-7	4,855	0	3,917	0
Shkollë Q. Gjuzi	3234	1/135	RRO-J-7	1,904	1,904	1,904	1,904
Shkollë Lekaj	2399	134/1	K-34-100-(164-D)	6,000	360	5,150	560
Kopështi Okshtun	2824	55/1	K-34-100-(149-D)	6,800	400	5,800	0
Shkollë Vilë Ballaj	3774	81/19	K-34-100-(209-A)	2,198	321	2,348	0
Shkollë Kryevidh	2292	118/3	K-34-100-(178-A)	3,700	600	0	0
Shkollë Rreth Greth	3175	17/2	K-34-99-(208-D)	1,750	350	1,750	350

Burimi i të dhënave: Bashkia Rogozhinë.

d. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Rogozhinë **të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 8 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie**. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Rogozhinë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për

regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 26-30, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c”.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Rrogozhinë më datën 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,.

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 16,270,630 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 13,115,121 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 560,515 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,870,302 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 130,263,322 lekë ku totali shkon në vlerën 165,079,890 lekë e cila kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 165,079,890 lekë në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	16,270,630	26,169,069	(9,898,439)
42	Detyrime ndaj personelit	13,115,121	13,269,199	(154,078)
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	560,515	542,790	17,725
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	4,870,302	4,471,672	398,630
436	Sigurime shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njërive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	49,116,662	53,650,528	(4,533,866)
467	Kreditorë të ndryshëm	130,263,322	139,798,937	(9,535,615)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	0	0	00
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	
Gjendje në fund të periudhës		214,196,552	237,902,115	(23,705,563)

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” më datë 01.01.2023, është në vlerën 26,169,069 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Rrogozhinë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,524,400 lekë dhe pakësime në vlerën 13,422,839 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 16,270,630 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Llekë	
Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	
Çelje e vitit 2023	26,169,069
Shtesa (K)	3,524,400
Pakësime (D)	13,422,839
Gjendja debitore në 31.12.2023	16,270,630

Llekë			
Nr.	Objekti	Operatori ekonomik	Vlera
1	Materiale Hidraulike	M.B. Kurti Shpk	5743080
2	Blerje Kancelari	M.B.Kurti Shpk	4982400
3	Zhvendosje Shtyla Gose	Alvora Shpk	815760
4	Blerje Materiale Pastrimi	Euomega sh.p.k	1164600
5	Akomodim futbolliste	Sinani Trading Shpk	720000
6	Blerje Materiale Pastrimi	Sinani Trading Shpk	750000
7	Blerje Materiale Dezinfectimi	Sinani Trading Shpk	339000
8	Dekori i vitit të Ri	Sinani Trading Shpk	1797600
9	Blerje Dokumentacioni	Shtypshkr.Letra me vlerë	156000
10	Blerje goma automjeti	Kastriot Zotaj	134400
11	Blerje Materiale për Zjerrëfiksën	Geam Shpk	380400
12	Kontratë Karburanti	Gega Center Shpk	354000
13	Kontratë Karburanti	Gega Center Shpk	849770
14	Blerje materiale Dezinfectimi	TGSH Group Shpk	245950
15	Ndriçues Rugor	Shhid Doka	119280
16	Kolaudim punimesh Rugë të brendshme	Argi Shpk	90068
17	Kolaudim punimesh Riv.Q.Gose	Argi Shpk	40920
18	Kolaudim punimesh Këndi Sportiv	Argi Shpk	276394
19	Derë + me kasë, gjerësia fikse 194.5 cm	Atopi	413280
Totali			16,270,630

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë.

-Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit" referuar pasqyrave financiare vlera 13,115,121 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llekë	
Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2023	13,269,069
Shtesa (K)	106,768,828
Pakësime (D)	106,922,826
Gjendja debitore në 31.12.2023	13,115,121

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", paraqitet në vlerën 560,515 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Llekë	
Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2023	542,790
Shtesa (K)	6,736,754
Pakësime (D)	6,719,029
Gjendja debitore në 31.12.2023	560,515

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 4,870,302 lekë.

Llekë	
Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2023	4,471,672
Shtesa (K)	44,650,984
Pakësime (D)	44,252,354
Gjendja debitore në 31.12.2023	4,870,302

Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” janë përfshirë edhe pagesat e sigurimeve shëndetësore në vlerën 578,172 lekë ku sipas trajtimit kontabël kjo vlerë duhet të kontabilizohet në llogarinë 436 “Sigurime shëndetësore”.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Rogozhinë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 49,116,662 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Kavajë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llekë	
Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2023	53,650,528
Shtesa (K)	7,630,154
Pakësime (D)	12,164,020
Gjendja debitoare në 31.12.2023	49,116,662

Llekë		
Nr.	Subjekti/Kodi në Thesar	Vlera
1	Firma S.	18,670
2	Sh. C0100	313,838
3	E. C0356	81,516
4	E.2000 C0372	591,193
5	GPG C0401	1,173,177
6	H C0435	516,396
7	I.Shkumbin C0450	90,486
8	Murati C0572	165,325
9	UKA C0746	7,370
10	Vëllezërit Hysa C0760	250,000
11	Kaçani C0761	74,994
12	Xhast Shpk C0774	255,179
13	Spnera C1018	71,333
14	Bahas C1118	673,050
15	Bashkimi L C1208	49,966
16	Infratech C2251	23,520
17	Rivera C2315	704,050
18	Infratech C2663	562,500
19	Edmond Dranga C2896	23,314
20	Integrated C0869	180,136
21	Agro Korani C0756	362,882
22	H C0435	2,467,975
Totali		8,656,870

Për 22 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Rogozhinë përpara vitit 2022, janë ngurtësuar fonde në vlerën 8,656,870 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Kavajë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 8,656,870 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2023, janë në vlerën 139,798,937 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 119,116,250 lekë dhe pakësime në vlerën 128,651,865 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 130,263,322 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në Aneks 3.1 bashkëlidhur RPA

a. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” më datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 16,270,630 lekë e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

b. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 janë në vlerën 130,263,322 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 85, pika 2 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 82-91.

Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,984,651,618 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 71,630,753 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 24,425,050 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 71,630,75 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 24,425,050 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 96,387,066 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	2,180,440,155	2,371,192,726
D	FONDI I KONSOLIDUAR	2,180,440,155	2,371,192,726
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,895,312,746	1,984,651,618
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	285,127,409	386,541,108
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	2,394,636,707	2,609,094,841

		Lekë	
Fondi i konoliduar	Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”		
	Mbyllje më datë 31.12.2023		Çelje më datë 01.01.2023
2,180,440,155	Debi		Kredi
		1,984,651,618	Çelja gjendja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” i datës 31.12.2023
	0	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	71,630,753
	89,007,609	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	24,425,050
Totali	89,007,609		2,080,707,421
		2,080,707,421-89,007,609=1,991,699,812	
		1,895,312,746-1,991,699,812=96,387,066	

Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 17.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 118,711,967 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 122,131,312 lekë ose me një rritje në vlerën 3,419,345 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	122,131,312	118,711,967
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	185,132	687,862
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	185,132	687,862
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	39,408,467	43,464,979
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	38,284,413	43,464,979
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	1,124,054	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	82,537,713	74,559,126
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	82,537,713	74,559,126
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksë mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksë kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 4,787,162 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 3,709,415 lekë ose me një pakësim në vlerën 1,077,747 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	3,709,415	4,787,162
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	1,630,499	2,725,445
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	1,630,499	2,725,455
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	2,078,916	2,061,717
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	250,550	2,061,717
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	199,500	0
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	838,665	0
7114	Të ardhura nga biletat	22,500	0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	767,701	0
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	0	0

3. Grante korente:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 993,682,616 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 898,599,604 lekë ose me një pakësim në vlerën 95,083,012 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
72	V. GRANTE KORENTE	898,599,604	993,682,616
720	I. Grant korent i brendshëm	898,599,604	993,682,616
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	715,098,287	796,243,126
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	0	122,327
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	18,421,427	13,065,576
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	165,179,890	184,251,587
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	0	0
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0
7211	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 175,829,567 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 192,446,808 lekë ose me një rritje në vlerën 16,617,241 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 28,784,656 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 32,843,074 lekë ose me një rritje në vlerën 4,058,418 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Kavajë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
6001	Paga, personel i përhershëm	192,446,808	175,829,567
602	Paga personel i përkohshëm	0	0
603	Shpërblime	0	0
609	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	32,843,074	28,784,656
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	0	0
	Totali	225,289,882	204,614,223

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 143,703,230 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 150,826,708 lekë ose me një rritje në vlerën 7,123,478 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Kavajë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	150,826,708	143,703,230
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	5,981,169	9,241,318
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,981,934	4,276,930
6022	Shërbime nga të tretët	98,784,892	103,380,570
6023	Shpenzime transporti	12,095,851	6,732,805
6024	Shpenzime udhëtimi	34,000	30,150

6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	14,842,510	6,629,016
6026	Shpenzime për qiramarrje	2,320,850	3,274,621
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	0	0
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	8,500,000	3,512,000
6029	Shpenzime të tjera operative	6,285,502	6,625,820

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Rrogozhinë nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 338,771,282 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

		Lekë	
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
	V. TRANSFERIME KORENTE	338,771,282	383,637,208
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	338,771,282	383,637,208
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	338,771,282	383,637,208

Për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është 1,024,440,331 lekë dhe totali shpenzimeve është 739,312,922 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 285,127,409 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 285,127,409 lekë.

- **Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

- **Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:**

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitorë dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. M Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. R. V me detyrë Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

- Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrat të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet respektive të Këshillit Bashkiak.

- Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Rrogozhinë (regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve) si dhe të dhënave nga Sistemi i Prokurimit Elektronik të APP-së për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten si më poshtë:

Lekë						
Periudha	Lloji i procedurës	Numri i procedurave	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
2023	Hapura	1	11,200,000	11,200,000	0	Me marzh fitimi
	E hapur e thjeshtuar	1	3,000,000	2,512,500	487,500	16.25 %
	Blerje të vogla	33	29,800,000	24,478,966	5,321,034	17.85%
Shuma procedura sipas llojit		6	44,000,000	38,191,466	5,808,534	13.2%
Periudha	Procedura sipas objektit	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	% ndarë në lloje	
2023	Ne fushën e ndërtimeve	0	0	0	Fond limit kursyer	Kontratës
	Në shërbime/ blerje, etj	3	44,000,000	38,191,466	5,808,534	13.2%
	Shuma procedura sipas llojit	6	44,000,000	38,191,466	5,808,534	13.2%

Për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, janë realizuar **në total 2** procedura prokurimi me vlerë të lartë, me fond limit në shumën **14,200,000 lekë** pa Tvsh dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **13,712,500 lekë** pa Tvsh nga të cilat referuar llojit të procedurës janë realizuar **2** procedura në fushën e shërbimeve.

- Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Procedurat e prokurimit me vlerë të lartë të audituara për periudhën nga data **01.01.2023** deri më **31.12.2023**, paraqiten si më poshtë:

Janë audituar të 2 procedurat e hapura ku ka rezultuar si mëposhtë vijon:

Nr	Objekti	Fondi limit	Operatori fitues
1	“Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”	11,200,000	“G. C.GKG” ShPK
2	“Blerje dru zjarri dhe palet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë, Bashkia Rrogozhinë	3,000,000	“A” SHPK

1. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, Nr. REF-79948, datë 09-14-2020.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 239, datë 06.09.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 239, datë 06.09.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 239, datë 06.09.2023 (i njëjti UP)
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	Njësia e Prokurimit 1. H. P, Kryetar Personi përgjegjës, jurist	1. R. V, Kryetar

	2. M. D, Inxhinier 3. F. M, Ekonomist	2. G. Gj 3. A. P
5. Fondi Limit (pa TVSh) 11,200,000 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "G. C. GKG" ShPK me marzh fitimi 15 lekë/litër, sipas kontratës nr. 3131/2, datë 01.11.2023 me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit
8. Data e hapjes së tenderit Datë 02.10.2023	9. Burimi Financimit Nga Buxheti i Bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është "E Hapur, mallra", me vlerë 11,200,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e Bashkisë Rrogozhinë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet asnjë kërkesë për realizimin e kësaj procedure prokurimi, por vetëm Regjistri i parashikimit të prokurimeve 2023, bashkëlidhur Urdhrit të Prokurimit.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje nuk administrohet argumentimi i fondit limit dhe hartimi i specifikimeve teknike.

Hartimi i Kriteve të kualifikimit, është bërë nga Njësia e Prokurimit.

Në dosje nuk administrohet asnjë Urdhër i titullarit të AK z. E. M për grupin e punës për përlogaritjen e fondit limit, por vetëm UB nr. 1021 prot, datë 15.03.2022 "Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e harxhimit të karburantit nga mjetet e Bashkisë Rrogozhinë", i cili përcakton komisionin me 8 anëtarë. Në zbatim të këtij urdhri, administrohet një shkresë pa nr, pa datë, në të cilin janë pasqyruar normat e harxhimit për 11 mjete/pajisje të Bashkisë Rrogozhinë dhe një tjetër shkresë me sasi të vjetore për çdo mjet, e nënshkruar nga Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse O. D. Sipas këtyre shkresave, sasia vjetore e karburantit që duhet për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë, është 58333 litra.

Sa sipër, përcaktimi i nevojave për gazoil, nuk është i mirëargumentuar dhe mbart riskun për të mos qenë i saktë.

Mbi përcaktimin e kriteve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikime teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, datë 14.09.2023.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezultojnë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 14.09.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se ato janë konform natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave datë 02.10.2023 dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë 1 OE, i kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit
2	“G. C. G” SHPK	25 lekë/litër

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë
Punoi: KLSH

Në dosje administrohet procesverbali për vlerësimin e ofertave pa nr. prot, datë 13.10.2023. Në këtë procesverbal KVO ka vendosur të refuzojë marzhin e fitimit prej 25 lekë/litër, pasi çmimi i tregut të lirë të karburanteve është 199 lekë/litër, ndërsa nga përlllogaritja e çmimit që ka dërguar për sqarim OE, çmimi dilte 216 lekë/litër.

Pas këtij vendimi, me shkresën pa nr. prot, datë 16.10.2023 të administratorit të “G. C. G” ShPK, është kërkuar ndryshimi i normës së fitimit nga 25 lekë/litër, në 15 lekë/litër.

Pas kësaj shkrese, me shkresën pa nr prot., datë 24.10.2023 është bërë klasifikimi i ofertave, duke pranuar marzhin e fitimit prej 15 lekë/litër.

Nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 26.10.2023, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E. M.

Pas njoftimit të fituesit, është lidhur kontrata me shkresën nr. 3131/2, datë 01.11.2023 me vlerë 13,440,000 lekë me TVSh dhe marzh fitimi 15 lekë/litër, me OE “G. C. G” SHPK.

Nga auditimi në SPE i dokumentacionit të paraqitur nga OE “G. C. G” SHPK, rezultoi se

- Në dy bilance të njëpasnjëshme (2021 dhe 2022) ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit (me humbje).

- Ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore vetëm në Bashkinë Rrogozhinë dhe jo në të gjitha bashkitë ky operon, bazuar në ekstraktin e QKB-së.

Sa sipër, ky OE duhej skualifikuar.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...”.

Me skualifikimin e OE “G. C. G” SHPK, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 nr. 914, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, sipas të cilit “1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme...”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK propozimin për anulimin e kësaj procedure. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 13,440,000 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së R. V. A. P dhe G. Gj.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri dhe palet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje dru zjarri dhe palet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, Nr. REF-88685, datë 11-22-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 383, datë 15.11.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 383, datë 15.11.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 384, datë 15.11.2023
2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	Njësia e Prokurimit 1. V. M, Kryetar 2. M. D, Inxhinier 3. F. M, Ekonomist	1. E. B, Kryetar 2. A. K 3. A. K Urdhër nr. 394, datë 21.11.2023 për ndryshimin e KVO-së 1. R. V, Kryetar 2. A. K 3. E. B
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,000,000 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “A” ShPK me ofertë 2,512,500 lekë pa TVSh, sipas kontratës nr. 529, datë 06.02.2024 me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 487,500 lekë, ose 16.25%
8. Data e hapjes së tenderit Datë 04.12.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur, mallra”, me vlerë 11,200,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e Bashkisë Rrogozhinë.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë “Për sigurimin e ngrohjes së shkollave” me nr. 4165/1 prot, datë 15.11.2023 nga Drejtoria e Arsimimit, Kulturës, Rinisë Sportit dhe Turizmit.

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje nuk administrohet argumentimi i fondit limit, por vetëm nevoja për ngrohje e institucioneve arsimore të Bashkisë Rrogozhinë (me dru zjarri, energji elektrike, karburant dhe pelet), si dhe një preventivne te cilin është përcaktuar vlera prej 3,000,000 lekë pa TVSh (300 mst dru zjarri x 7500 lekë/mst + 7500 kg pelët x 100 lekë/kg), pa bërë testimin e tregut për çmimet e mallrave objekt prokurimi.

Sa sipër, përcaktimi i nevojave për dru zjarri dhe pelet, nuk është i mirëargumentuar dhe mbart riskun për të mos qenë i saktë, duke ngarkuar me përgjegjësi Drejtorin e Shërbimeve mbështetëse z. O. D.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

Kriteret e kualifikimit dhe specifikime teknike janë përcaktuar nga Njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit pa nr. prot, pa datë, si më poshtë:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 14.09.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se ato janë konform natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Nisur nga procesverbali i hapjes së ofertave datë 04.12.2023 dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë 1 OE, i kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit
1	Gj. B PF	2,992,500
2	“A” ShPK	2,512,500

Burimi i të dhënave: Bashkia Rrogozhinë
Punoi: KLSH

Në dosje administrohet formulari i njoftimit të fituesit (paraprak), datë 07.12.2023, në të cilin është skualifikuar OE “A” ShPK dhe kualifikuar OE Gj. B PF.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se OE “A” ShPK është skualifikuar nga KVO për arsyet e mëposhtme:

Arsyet e refuzimit të ofertës janë për mos përmbushje të kritereve si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme në lidhje me mallrat objekt prokurimi të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave: -leja mjedisore e paraqitur pa vule elektronike dhe pa koken e shkresës

2.3.4 Operatori duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratave perkatëse të noterizuara ambjent të përshtatshme për magazinimin e produkteve objekt prokurimi, për këtë qëllim operatori duhet të deklarojë vendodhjen e mallit dhe gjendjen aktuale të mallit që kërkohej, në mënyrë që të mund të verifikohet nga AK-ja-nuk është paraqitur as certifikate e pronësisë, as kontrate qeraje nëse ka.

2.3.5 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratave perkatëse të noterizuara, mjete transporti të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës si më poshtë:

- Te pakten një Automjet të përshtatshëm me kapacitet deri 3.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.
- Te pakten një Automjet vetëshkarkues me kapacitet deri 3.5-7.5 ton për transportimin e druve të zjarrit.

Per automjetet në përputhje me kodin rrugor të paraqitjen certifikatat e pronësisë, si dhe dokumentacioni perkatës; siguracioni, leja e qarkullimit, aktin e kolaudimit të automjetit në dispozicion-2 mjete të paraqitura janë mbi tonazhin e kërkuar. AA751TS-12.5 Ton deri në 18 Ton dhe TR7261K-10.3 Ton deri në 16 Ton.

-Në datën 13.12.2023 OE "A" ShPK ka bërë ankesë pranë AK-së dhe KPP-së, për shkelje të legjislacionit të prokurimeve në lidhje me vlerësimin e ofertave.

-Me UB i TAK me nr. 411, datë 18.12.2023 "Për shqyrtimin e ankesave nga AK", është ngritur KSHA me përbërje A. D, H. P dhe O. D.

-Me UB i TAK me nr. 412, datë 20.12.2023 "Për pezullim procedure prokurimi", është bërë pezullimi i procedurës deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

-KPP-ja, me Vendimin nr. 26/2024, datë 09.01.2024, dërguar në Bashkinë Rrogozhinë me shkresën nr. 3110/8, datë 09.01.2024, ka vendosur të pranojë ankesën e shoqërisë "A" ShPK dhe të shfuqizojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e këtij OE.

-AK, Bashkia Rrogozhinë, pasi ka bërë rivlerësimin e ofertave sipas Vendimit të KPP-së, ka renditur në vendin e parë si ofertë fituese OE "A" ShPK dhe ka bërë njoftimin e KPP-së me shkresën përcjellëse me nr. 220 prot., datë 16.01.2024.

- Me Vendimin nr. 90/2024, datë 24.01.2024, KPP-ja ka vendosur të lejojë AK Bashkia Rrogozhinë për vijimin me hapa të mëtejshme të kësaj procedure prokurimi

- Nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 02.02.2024, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.M.

Pas njoftimit të fituesit, është lidhur kontrata me shkresën nr. 529, datë 06.02.2024 me vlerë 3,015,000 lekë me TVSh, me OE "A" ShPK.

Ky veprim ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së R.V, A. K dhe E. B.

2.4.1 Për zbatimin e dispozitave ligjore mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik të blerjeve me vlera të vogla.

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Rrogozhinë ka realizuar në total 33 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 29,800,000 lekë pa Tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate 24,478,996 lekë pa Tvsh. Nga 33 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 29,800,000 lekë pa Tvsh janë audituar 33 procedura ose në masën 100% ku janë konstatuar problematikat si më poshtë:

-Bashkia Rrogozhinë për vitin 2023 ka realizuar 5 procedura prokurimi me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 4,900,000 lekë pa Tvsh duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me tenderim. Konkretisht, dy procedura "Blerje kompjutera", me urdhër prokurimi nr. 75 datë 30.01.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe procedura "F.V. Pajisje zyre elektronike" me urdhër prokurimi nr. 104, datë 15.03.2023, me fond limit 900,000 lekë pa Tvsh që i përkasin të njëjtit objekt prokurimi blerje pajisje elektronike. Si dhe tre procedura "Servis zjarrëfikëses" me urdhër prokurimi nr. 122, datë 18.04.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, procedura "Servis, mjetesh Bashkia Rrogozhinë" me urdhër prokurimi nr. 116, datë 06.04.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe procedura "Servis mjetesh, Bashkia Rrogozhinë" me urdhër prokurimi nr. 98, datë 09.03.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh që i përkasin të njëjtit objekt prokurimi servis mjetesh.

-Në 32 raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administroj dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.

-Në 9 raste nuk dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit.

-Në 15 raste nga KPVV është hartuar një preventiv, por në këtë dokument nuk argumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit.

-Në 33 raste nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla.

-Në 6 raste preventivi i punimeve është hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me licensat përkatëse profesionale në fushën e projektimit për procedurën “Rehabilitim rruga Gos e Vogël” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Rehabilitim lulishte Qendra Rinore Rrogozhinë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Rehabilitim sheshi i pallatave, rruga Peqinit Rrogozhinë” me fond limit 650,000 lekë pa Tvsh, “Rikonstruksion KUZ Reabilitim përroi, Rrogozhinë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Rikonstruksion objekti Qendra Rinore, Rrogozhinë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Sistemim i urave të bardha L-2 St. Trenit Rrogozhinë” me fond limit 600,000 lekë pa Tvsh.

-Në 30 raste nga KPVV nuk është publikuar në SPE procesverbali mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit.

-Në 7 raste në lidhje me kriteret e vendosura nga KPVV, janë konstatuar kritere jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çënojnë pjesëmarrjes e operatorëve ekonomikë të interesuar për procedurën “F.V. Zbukurime për festat e fundvitit” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Makineri Kositëse, Parku Qytetit Rrogozhinë” me fond limit 800,000 lekë pa Tvsh, “Rikonstruksion objekti Qendra Rinore, Rrogozhinë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Servis automjeti zjarrëfikëses” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Servis mjetesh Bashkia Rrogozhinë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Servis mjetesh Bashkia Rrogozhinë”, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe “Siguracione, Bashkia Rrogozhinë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh.

-Në 33 raste nga KPVV në SPE është dërguar ftesë pesë operatorëve ekonomikë, ku referuar të dhënave të publikuara në QKB konstatohet se asnjë prej operatorëve ekonomikë të cilët është dërguar ftesa nuk ka në veprimtarinë e tij objektin që prokurohet.

-Në 8 raste në Sistemin e Prokurimit Elektronik nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë), pra kalimi nga një operatorë ekonomik tek tjetri në rastet e s’kualifikimit apo të tyre.

-Në 7 raste nga KPVV nuk është mbajtur procesverbali i s’kualifikimit për kalimin nga një operator ekonomik tek tjetri.

-Në 16 raste fatuarat tatimore nuk janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Në 16 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë për procedurën “Blerje detergjentësh” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Blerje hidraulike” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Blerje kancelari” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Blerje kompjutera” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “F.V. Kondicionerë, Bashkia Rrogozhinë” me fond limit 700,000 lekë pa Tvsh, “F.V. Ndriçues Rrugorë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “F.V. Zbukurime për festat e fundvitit” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Makineri Kositëse, Parku Qytetit Rrogozhinë” me fond limit 800,000 lekë pa Tvsh, “Servis automjeti zjarrëfikëses” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Veshje pune” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “F.V. Dera kryesore Bashkia Rrogozhinë” me fond limit 400,000 lekë pa Tvsh, “F.V. Rrëzë bituminoze” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Rehabilitim rruga Gos e Vogël” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Riparim, lysterje, izolim, Banesa 2 kt Njësia Administrative Lekaj” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Sistemim i urave të bardha L-2 St. Trenit Rrogozhinë” me fond limit 600,000 lekë pa Tvsh, “Zhavorrime, Bashkia Rrogozhinë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe “Rehabilitim sheshi i pallatave, rruga Peqinit Rrogozhinë” me fond limit 650,000 lekë pa Tvsh.

-Në 18 raste nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues në fazën e dorëzimit të mallrave janë konstatuar mangësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë, për procedurën “Blerje detergjentësh” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Blerje hidraulike” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Blerje kancelari” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Blerje kompjutera” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “F.V. policë të shtrirë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “F.V. Stabilizant” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, “Makineri Kositëse, Parku Qytetit Rrogozhinë” me fond limit 800,000 lekë pa Tvsh, “Zhavorrime, Bashkia Rrogozhinë” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe “Rikonstruksion objekti Qendra Rinore, Rrogozhinë”, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh.

-Në 2 rast në dosjen e procedurës së prokurimit nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimit për procedurën “F.V. Arredim zyre Qendra Rinore” me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe “F.V. Pajisje zyre elektronike”, me fond limit 900,000 lekë pa Tvsh.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 36, pika 4, Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 72, pika 4, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-37 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 7, pika 11, pika 12, pika 18,

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. M Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe O. D, z. O. T, z. M. M për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 03.12.2023, dhe z. O. D, znj. M Th, z. E. Xh për periudhën nga data 04.12.2023, deri më 31.12.2023, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

1. “SistemimAsfaltim rruga Sharrdushk (Pjec) - Kryevidh, L=1400 ml”, Bashkia Rrogozhinë.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 753 prot datë 24.02.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. E. M dhe Operatorit Ekonomik “A-A” ShPK me përfaqësues z. L. M, me licencë profesionale NZ 5830/12. Vlera e kontratës është 13,994,400 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 21 ditë kalendarike (28.02.2023 – 20.03.2023).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit pa nr. prot, pa datë, është lidhur kontrata me OE “D. E” SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1713/11 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 217,771 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria “GBC. E” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2812/4.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 753/2 prot., datë 28.03.2023, nga grupi i punës me përbërje ing. Sh. Gj, administratori i NjAKryevidh,

topograf K. B dhe arkitekthe M. T, është hartuar Akti i Marrjes së Përkohshme në dorëzim me nr. 753/3 prot., datë 11.04.2023.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 297, datë 16.02.2023. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11/1, “Punime që duhet t’u kërkohet leja e ndërtimit”, sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukture.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Rrogozhinë, z. E. M.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga Drejtoria e Politikave Urbane, Bashkia Rrogozhinë në vitin 2022. Në dosje administrohet projekti i zbatimit i panënshtuar nga titullari i Bashkisë Rrogozhinë, në bazë të të cilit është shqyrtuar edhe kërkesa për leje ndërtimi.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 28.02.2023 dhe kanë përfunduar me datë 20.03.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve pa nr. prot., datë 10.03.2023, sipërmarrësi i punimeve “A-A” SHPK, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 1,437,200 lekë pa TVSH.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
- Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
- Libreza e masave,
- Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim rruga Sharrdushk (Pjec) - Kryeviidh, L=1400 ml”, Bashkia Rrogozhinë				
14. Lidhja e kontratës Nr. 753 prot datë 24.02.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 13,994,400 lekë OE fitues “A-A” SHPK		16. Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 13,994,400 lekë -Vlera pa tvsh 11,662,000 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 21 ditë , Zbatuar 21 ditë. Fillimi punimeve: 28.02.2023 Përfundimi punimeve : 20.03.2023		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “D-E” SHPK	Licenca Nr:MK 3429	Kontrata pa nr. prot, padatë	Likuiduarlekë	Pa likuiduar

21. Kolaudatori i punimeve "G.C. E" ShPK	Licenca Nr: MK 2812/4	Kontrata nr. Nuk administrohet	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 27.03.2023	23. Akt i marrjes në dorëzim nr. 1651/4 prot, datë 13.05.2021		24. Fletë Hyrja Nr..... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **80,300 lekë pa tvsh**.

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Sistemim Asfaltim rruga Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. -Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 753 prot datë 24.02.2023. -Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot, pa datë. -Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. B. D me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. G.B me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2. "Rikonstruksioni i magjistralit krvesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit, Loti III", Bashkia Rrogozhinë.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2862 prot, datë 07.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. H. M dhe Operatorit Ekonomik "H" ShPK me përfaqësues z. M. H, me licencë profesionale NZ 2993/26. Vlera e kontratës është 246,446,031 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Me kërkesë të mbikëqyrësit datë 12.02.2020, për shkak të mosdorëzimit të sheshit të ndërtimit, si dhe të ndryshimeve thelbësore në projektin e depove, është mbajtur Amendamenti me nr. 1074 prot, datë 17.02.2020, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 6 muaj. Me kërkesë të mbikëqyrësit datë 12.08.2020, për shkak të pengesave nga banorët e zonës, periudhës së pandemisë Covid 19, si dhe të ndryshimeve të skemës së furnizimit me ujë të banorëve, është mbajtur Amendamenti me nr. 4537/1 prot, datë 14.08.2020, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 4 muaj. Me kërkesë të mbikëqyrësit datë 17.12.2020, për shkak të mungesës së lejes së ndërtimit nga Bashkia Divjakë, është mbajtur Amendamenti me nr. 6527/2 prot, datë 17.12.2020, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 6 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1867/3 prot., datë 12.07.2019, është lidhur kontrata me OE "A" ShPK & "A" ShPK & "H-C" SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1666/3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 2,708,477 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas Kontratës me nr. 38/1 prot., datë 11.01.2022, është emëruar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "E S" ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2812/4.

Për marrjen e përhershme në dorëzim të objektit, në zbatim të Urdhrit të TAK me nr. 118 prot., datë 11.04.2023, nga grupi i punës me përbërje ing. G.Gj, topograf K. B dhe inxhinier M. D, është hartuar Akti i Marrjes së Përhershme në dorëzim me nr. 1476/1 prot., datë 18.04.2023.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje ndërtimi me nr. 2, datë 07.08.2019.

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, ish titullari i Bashkisë Rrogozhinë.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga BOE “A 4” ShPK dhe “I” ShPK në vitin 2016. Në dosje administrohet projekti i zbatimit i panënshkruar nga titullari i Bashkisë Rrogozhinë, në bazë të të cilit është shqyrtuar edhe kërkesa për leje ndërtimi.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 19.08.2019 dhe kanë përfunduar me datë 15.06.2021, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentet për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar dhe korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve pa nr. prot., datë 12.08.2020, sipërmarrësi i punimeve “H” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “A” ShPK & “A” ShPK & “H-C” SHPK dhe titullari i Bashkisë Rrogozhinë, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 63,836,708 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen prej 57,723,187 lekë pa TVSh. Janë negociuar 32 zëra të rinj pune, të paraqitura me analizë çmimi, ose të marra nga manualet e çmimeve në fuqi. Nga auditimi rezultoi se zërat me çmime sipas manualit, janë korrektë dhe ato të bëra me analiza çmimi, u janë referuar studimit të tregut.

Në dosjen teknike administrohet një kërkesë e sipërmarrësit të punimeve me nr. 196 prot., datë 27.08.2020, për shtesë financimi për vitin 2020.

Në dosjen teknike administrohet gjithashtu një kërkesë e sipërmarrësit të punimeve me nr. 287 prot., datë 19.11.2020, ku i kërkohet investitorit të marrë lejen e ndërtimit për punimet që do të kryhen në territorin e Bashkisë Divjakë. Gjithashtu është lidhur një Aktmarrëveshje me nr. 656/2 prot, datë 02.10.2020 me Hekurudhën Shqiptare për punimet që do të kryhen nën linjat hekurudhore të Stacionit Hekurudhor të Rrogozhinës, pa ndërprerjen e trafikut hekurudhor.

-Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
- Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
- Libreza e masave,
- Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit, Loti III”, Bashkia Rrogozhinë

14.Lidhja e kontratës Nr. 2862 prot, datë 07.08.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 246,446,031 lekë OE fitues "H" ShPK		16.Likuiduar deri dt	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 246,311,247 lekë -Vlera pa tvsh 206,354,206 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 180 ditë , Zbatuar 675 ditë. Fillimi punimeve: 19.08.2019 Përfundimi punimeve : 15.06.2021		19. Zgjatja e kontratës 1- Amendamenti me nr. 1074 prot, datë 17.02.2020, shtyrja e afatit 6 muaj. 2- Amendamenti me nr. 4537/1 prot, datë 14.08.2020, shtyrja e afatit 4 muaj. Amendamenti me nr. 6527/2prot, datë 17.12.2020, shtyrja eafatit 6 muaj.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE "A" ShPK & "A" ShPK & "H-C" SHPK	Licenca Nr: MK 3429	Kontrata me 1867/3 prot., datë 12.07.2019	Likuiduarlekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve "E.S" ShPK	Licenca Nr: MK 1666/3	Kontrata nr. Nuk administrohet	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 17.01.2022	23.Akt i marrjes në dorëzim nr. 1476/1 prot, datë 18.04.2023		24. Fletë Hyrja Nr.....datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **77,578** lekë pa tvsh.

Tabela nr. 1

	Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
	B	Depo 200 m³							
	B.4	Sistemime të jashtme							
1	10	FV bordura 20x35 cm, <u>çmimi</u>	ml	1515 lekë/ml	35.9		752 lekë/ml	763 lekë/ml	27,392
	C	Depo 100 m³							
	C.4	Sistemime të jashtme							
2	10	FV bordura 20 x 35 cm, <u>çmimi</u>	ml	1515 lekë/ml	38		752 lekë/ml	763 lekë/ml	28,994
3	14	Rrethim me kolona dhe tel gabionash H=2m	m ²	1766	140	154	128	12	21,192
								Total	77,578

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

A. Depo 2000 m³

1- Punime gjurmimi

1.Zëri 6 Transport materiale ndërtimi, dheu 2 km. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 3790 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 4332 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 4332 m³, i detajuar për murin e sipërm, depo, shesh, si dhe 202 m³, kanal Depo - Përrua. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se volumi i gjurmimit të kanalit është përdorur për mbushje dhe

nuk duhet të ishte librezuar për transport. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 4120 m³, ose 202 m³ më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

B. Depo 200 m³

4- Sistemime të jashtme

2.Zëri 10. FV bordura 20 x 35 cm, çmimi. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 80 ml me çmim 1515 lekë/ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 80 ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 80 ml. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se janë vendosur bordura 12 x 25 cm, të cilat në manualin e çmimeve rezultojnë me nr. An 3.616, me çmim 752 lekë/ml. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 763 lekë/ml për gjithë gjatësinë e bordurave (80 ml) është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

C. Depo 100 m³

4- Sistemime të jashtme

3.Zëri 10. FV bordura 20 x 35 cm, çmimi. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 80 ml me çmim 1515 lekë/ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 60 ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 60 ml. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se janë vendosur bordura 12 x 25 cm, të cilat në manualin e çmimeve rezultojnë me nr. An 3.616, me çmim 752 lekë/ml. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 763 lekë/ml për gjithë gjatësinë e bordurave (60 ml) është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4. Zëri 14. Rrethim me kolona dhe tel gabionash H=2m. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 140 m². Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 140 m². Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 154 m², i detajuar për gjatësinë e rrethimit, me lartësi të rrjetës 2 m. Nga verifikimi i projektit të azhurnuar dhe verifikimit në terren, konstatohet se lartësia e rrjetës është 1.7 m. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 128 m², ose 12 m² më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Veprime në kundërshtim me ligjin -Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. -Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2862 prot, datë 07.08.2019. Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr.1835 prot, datë 1867/3 prot., datë 12.07.2019 . Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 38/1 prot., datë 11.04.2022.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

1. Z. Ll. T me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. A. G me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

- Vonesat në zbatimin e projekteve

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit në Bashkinë Rrogozhinë, nga audituesit e KLSH-së z. A. Z dhe z. M. H u krye auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve në objektet “*Rikonstruksioni i ujësjellësit Gosë*” dhe “*Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshun dhe Mushnik, Nj. A. Lekaj*”, Bashkia Rrogozhinë.

1. “Rikonstruksioni i ujësjellësit Gosë”

Kontrata

Objekti i mësipërm është duke u kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1943 prot, datë 26.4.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. E. M dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B- B” ShPK & “P. v” & “D- C” me përfaqësues z. B. D. Vlera e kontratës është 191,504,784 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 11 muaj pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe marrja e lejes së infrastrukturës. Në dosje administrohet Leja Infrastrukturore Nr. 151, datë 26.05.2021.

Nisur nga fakti që ky objekt është ende i papërfunduar, u kërkua dokumentacioni teknik i administruar në Bashkinë Rrogozhinë për këtë objekt dhe rezultoi si më poshtë:

Nga fillimi i punimeve deri sot, kanë kaluar rreth 36 muaj.

Me kërkesë të mbikëqyrësit datë 04.05.2022, për shkak të pezullimit të punimeve në 4 faza, është mbajtur Amendamenti 1 me nr. 996/4 prot, datë 04.05.2022, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 75 ditë. Në dosje administrohen kërkesa të kontraktorit pa date dhe pa nr prot, që kërkojnë pezullimin e punimeve për shkak të kushteve atmosferike.

Në dosje administrohet Amendamenti nr. 2, me nr. 996/5 prot, datë 27.07.2022, sipas të cilit është bërë shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 25.06.2023. Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë nga mbikëqyrësi, ku të argumentohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve.

Në dosje administrohet Amendamenti nr. 3, me nr. 1657/3 prot, datë 25.06.2023, sipas të cilit është bërë shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 25.03.2024. Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë nga mbikëqyrësi, ku të argumentohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve.

Deri në datën e mbajtjes së këtij aktkonstatimi, nuk rezulton që punimet të kenë përfunduar.

Për këtë objekt, deri në datën e sotme janë paguar 140,667,546 lekë me TVSH, ose 73.4% e vlerës së kontratës.

2. Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshun dhe Mushnik, Nj. A. Lekaj

Kontrata

Objekti i mësipërm është duke u kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 534/2 prot, datë 04.02.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. E. M dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B-B” ShPK & “P- v” & “D- C” me përfaqësues z. B. D. Vlera e kontratës është 298,991,676 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj pas dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe marrja e lejes së infrastrukturës. Në dosje administrohet Leja Infrastrukturore Nr. 142, datë 09.03.2021.

Nisur nga fakti që ky objekt është ende i papërfunduar, u kërkua dokumentacioni teknik i administruar në Bashkinë Rrogozhinë për këtë objekt dhe rezultoi si më poshtë:

Nga fillimi i punimeve deri sot, kanë kaluar rreth 38 muaj.

Në dosje administrohet një kërkesë e Mbikëqyrësit të punimeve “A- S”ShPK datë 23.06.2023, për shkak të pengesave nga banorët e zonës, hartimit të Projektpreventivit sipas faktit dhe planit të disbursimit në vite.

Në dosje administrohet Amendamenti 1 me nr. 997/5 prot, datë 05.04.2022, i cili bën shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri në 25.11.2022. Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë nga mbikëqyrësi, ku të argumentohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve.

Në dosje administrohet Amendamenti nr. 2, me nr. 997/6 prot, datë 25.11.2022, sipas të cilit është bërë shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 25.04.2023. Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë nga mbikëqyrësi, ku të argumentohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve.

Në dosje administrohet Amendamenti nr. 3, me nr. extra prot, datë 25.04.2023, sipas të cilit është bërë shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 25.09.2023. Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë nga mbikëqyrësi, ku të argumentohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve.

Në dosje administrohet Amendamenti nr. 4, me nr. 3056/2 prot, datë 25.09.2023, sipas të cilit është bërë shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 25.03.2024. Në dosje nuk administrohet asnjë kërkesë nga mbikëqyrësi, ku të argumentohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve.

Deri në datën e mbajtjes së këtij aktkonstatimi, nuk rezulton që punimet vtë kenë përfunduar.

Për këtë objekt, deri në datën e sotme janë paguar 180,221,497 lekë me TVSH, ose 60.3 % e vlerës së kontratës.

-Nga sa sipër, mospërfundimi në kohë i punimeve është në kundërshtim me kontratat e lidhura ndërmjet investitorit Bashkia Rrogozhinë dhe dy kontraktorëve (në rastin konkret është vetëm një BOE), tek të cilat është cituar afati i përfundimit të kontratave.

- Është në kundërshtim me nenin 38 të kontratatve të lidhura për punët publike të sipërcituara, “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve”, në të cilat është e përcaktuar tarifa ditore si dëm i likuidueshëm për vonesat në përfundimin e punimeve.

- është në kundërshtim me UDHËZIM Nr.2, datë 13.5.2005 “PËR ZBATIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, sipas të cilit “7.2 Propozimet për rritjen e vleftës së kontratës dhe zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e veprës, vijjnë nga shkaqe pamundësisht të paparashikueshme, në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës”.

- Është në kundërshtim me UDHËZIM Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, sipas të cilit “13. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton çdo muaj investitorit për realizimin e tij. Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur punimet janë gati për t’u ekzaminuar prej tij”.

- Zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve në menyre të paargumentuar teknikisht, mbart riskun e shmangies së penaltetit për vonesat në përfundimin e punimeve, riskun për mospjesëmarrjen në procedurën e prokurimit të operatorëve të tjerë ekonomikë që nuk e kanë patur mundësinë për përfundimin e punimeve në afatin e përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe më e rëndësishmja, mosshkuarja në kohë tek qytetari i produktit të investuar nga fondet buxhetore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. M, në cilësinë e titullarit të Bashkisë Rrogozhinë;

2. Z. R. O si përfaqësuesi i mbikëqyrësit të kontratës së sipërmarrjes “A- S” ShPK;

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

2.5.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

2.5.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj.,.

V. ZBATIMI I KËRKESAVE TË LIGJIT PËR PLANIFIKIMIN

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me Nr. 187/1 Prot; datë 20.02.2024, me objekt: “**Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 ‘Për Planifikimin dhe Zhvillimin e**

Territorit’, i ndryshuar’, prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2023, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “e-lejet”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në Drejtorinë e Urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në Drejtorinë e Financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në Drejtorinë Juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Rrogozhinë ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** (këtu e në vazhdim PPV) dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT), nr. 07, datë 16.10.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik dhe ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret ligjore dhe rregullatore;
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik;
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë;
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit.

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUdhËN **01.01.2023 - 31.12.2023**

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Rrogozhinë, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2023**, ka pasur **140 aplikime** në sistem për lloje të ndryshme lejesh si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione, çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht 15 aplikime për leje zhvillimi, 2 aplikime për çertifikata përdorimi, 5 aplikime për leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m², 5 aplikime për leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe 250 m², 32 aplikime për deklarata paraprake për kryerje punimesh, 50 aplikime për leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni, dhe 1 aplikim për leje infrastrukture, të evidentuara në *Tabelën nr.1*.

Tabela nr. 1

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Çertifikatë përdorimi	2	2	0
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	32	25	7
Leje infrastrukture	1	1	0
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	5	8	0
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	5	3	2
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. deri në 250 m ²	0	0	0
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. më të madhe se 250 m ²	2	0	2
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	1	1	
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	0	0	0
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	0	0	0
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	1	1	0
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	0	0	0

Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	50	30	20
Leje zhvillimi	15	4	11
Njoftim fillim punimesh	31	30	1
Leje për ndryshim funksioni	0	0	0

Burimi: Bashkia Rrogozhinë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Politikave Urbane (këtu e në vazhdim DPU), Bashkia Rrogozhinë, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në Tabelën nr. 2:

Tabela nr. 2

Nr.	Kategoria	Objekti	Zhvilluesi	Vendimi i lejes	Preventivi
1	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	Fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit	“A. V ” ShPK	Vendim nr. 318, datë 24.04.2023	88,908,158 lekë
2	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të vogël se 250 m ²	Objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum	“BI .C” ShPK	Vendim Nr. 406; datë 22.12.2023	124,582,684 lekë
3	Çertifikatë përdorimi	Banesë 2 kate	Z. K. V	Vendim nr. 393, datë 30.11.2023	-

Burimi: DPU, Bashkia Rrogozhinë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në lidhje me auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy)** raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i lartësisë minimale të lejuar për katin përdhe me përdorim banim, respektimi i Koeficientit të Shfrytëzimit të Territorit, distancat urbane midis objekteve, nga kufiri i pronës dhe nga trupi i rrugës, si dhe mosrespektimi i numrit minimal të detyrueshëm të vend-parkimeve. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit, me adresë në fshatin Spille, Bashkia Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “A- V 2022” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 318, datë 24/04/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton lartësinë minimale të lejuar për katin përdhe me përdorim banim, sipas përcaktimeve të nenit 10 të Rregullores së PDV-së, pika 1, nënpika d), ku parashikohet se lartësia minimale e lejuar për katet me funksion banim është 3.24 metra, ndërsa lartësia faktike është 3.15 metra;

- Nuk respekton Koeficientin e Shfrytëzimit të Territorit (KSHT), sipas përcaktimeve të pasaportës së njësisë strukturore A14-08, nga e cila marrim informacionin se KSHT është 30%. Gjithashtu, në dokumentacion e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve për këtë aplikim, përcaktohet se KSHT_{faktike} është 30%. Nga ri-llogaritja e këtij kondicioni nga grupi i auditimit, është konstatuar se KSHT_{faktike} është 36.5 %;

- Objektet me funksion akomodues nuk respektojnë distancat urbane midis tyre, sipas përcaktimeve të nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të

Territorit”, i ndryshuar, pika 2. Referuar dipozitave ligjore të sipërcituara, distanca minimale midis dy objekteve me lartësi 2 kate (secili), do të duhej të ishte 5 metra. Distanca faktike midis tyre është 2 metra.

- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve për strukturat akomoduese, sipas përcaktimeve të nenit 28 të Rregullores së PPV-së, pika 3, nga ku marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për objektet me funksion jo-banim është 12 m^2 /përdorues dhe llogaritet mbi bazën e fluksit mesatar deri në maksimal 24 orësh të përdoruesve të objektit. Për objektet nën auditim nuk ka asnjë vend-parkim të parashikuar.

2. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum, me adresë në Rrugën e Kavajës, Lagja nr. 1, Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “B-C” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 406, datë 22/12/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk respekton distancat nga kufiri i pronës, sipas përcaktimeve të nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 1. Për rastit nën auditim, distanca e miratuar nga kufiri lindor është 1 metër, ndërkohë që do të duhej të ishte 2 metra.

- Nuk respekton distancat nga trupi i rrugës, sipas përcaktimeve të nenit 36 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, pika 3, nënpika c), nga ku marrim informacionin se distanca që objektet duhet të respektojnë nga trupi i rrugës, duke përfshirë edhe trotualet, për rrugë me gjerësi më të madhe se 15 metra, është 4 metra. Nga matjet e kryera mbi dokumentacionin e ngarkuar në sistemin *e-lejet* për këtë praktikë, konstatohet se gjerësia e trupit të rrugës është 17 metra. Distanca që objekti i miratuar ka nga rruga është 3.22 metra;

- Nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve, të parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor, neni 28 i Rregullores së PPV-së për Bashkinë Rrogozhinë, pika 3, nga i cili marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për hapësirat në funksion të banimit është minimalisht 1 vend-parkim / apartament, ndërsa për hapësirat e shërbimit është 1 vend-parkim / 100 m^2 . Referuar këtyre përcaktimve dhe llogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, nga ku rezulton se numri total i apartamenteve është 30 dhe sipërfaqja me funksion shërbim është 962 m^2 , shprehemi se numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 40. Numri faktik i vend-parkimeve është 29 në katin nëntokë dhe 6 parkime të hapura (në kuotën e sistemeve).

Veprime në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 34, pika 2; neni 35, pika 1; neni 36, pika 3, nënpika c); Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Rrogozhinë, neni 10, pika 1, nënpika d); neni 16 dhe pasaporta e njësisë strukturore A14-08; neni 28, pika 3.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E. M.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë;
- **Z. G. GJ.**, në cilësinë e drejtorit të DPU (aktualisht i larguar nga puna);
- **Z. I. B.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPU.

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në **3 (tre) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqëruar dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomalitë janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit, me adresë në fshatin Spille, Bashkia Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “A- V” ShPK,

për të cilën është marrë Vendimi Nr. 318, datë 24/04/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë prerjet teknike (nga dy prerje për secilën tipologji objekti), plani i mbulimit për të gjitha tipologjitë e objekteve, detajet teknike, si dhe mungon i gjithë projekti ndërtimor për pishinën, veprime këto në mos-përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika i);

- Mungon projekti i instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohje/ventilim për strukturën me funksion shërbim (restorant), veprim ky në mos-përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika iii);

- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, veprime këto në mos-përputhje me VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika e);

- Mungon çertifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e në vazhdim QKB) për hartuesin e projektit arkitektonik, projektit elektrik, hidrosanitar, të instalimeve të ngrohje-ftohje/ventilimit, si dhe për hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Mungon deklarata dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, kjo në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), g);

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit arkitektonik, kjo në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika g).

2. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum, me adresë në Rrugën e Kavajës, Lagja nr. 1, Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “B-C” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 406, datë 22/12/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon çertifikata e regjistrimit në QKB dhe/ose ekstrakti i regjistrit tregëtar për hartuesit e projektit ndërtimor (përveç hartuesit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis), veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Mungon raporti i auditimit të efikasitetit të energjisë, veprim ky jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika v). Ky raport është vendosur në dispozicion dorazi dhe është protokolluar pranë Bashkisë Rrogozhinë. Në çdo rast, i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe i detyrueshëm për pajisje me leje ndërtimi duhet të kalojë nëpërmjet sistemit *e-lejet*, që prej datës 01.09.2016. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 3 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar;

- Mungon dokumentacioni që do të vërtetonte marrëdhënien e punës midis hartuesit të projektit të mbrojtjes nga zjarri (z. E. M) dhe subjektit në emër të të cilit është ngarkuar polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale (“E” ShPK), siç do të ishte vërtetimi i regjistrimit në QKB ose kontrata e punës, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, pika 1, nënpika g).

3. Çertifikatë përdorimi për banesë 2 kate, me adresë fshatin Kërçukaj, nj. adm. Gosë, me zhvillues z. K. V, për të cilën është marrë Vendimi nr. 393; datë 30.11.2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, me problematika si më poshtë vijon:

- Aktet e kontrollit nuk janë hartuar dhe depozituar pranë njësisë vendore sipas afateve kohore të ndërtimit dhe në përputhje me grafikun e punimeve. Tre prej akteve të kontrollit (Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues; Piketimi i strukturës; Përfundimi i themeleve dhe kuota 0.00) janë hartuar në datën 03.04.2023, në mos-përputhje me grafikun e punimeve. Gjithashtu, tre aktet e tjera të kontrollit (Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin; Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik; Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese) janë hartuar në datën 19.04.2023. Referuar nenit 27/1 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 2, marrim informacion se: “...sipas fazave të grafikut të punimeve dhe afatit të lejes...”. Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi dhe neni, përcaktohet se: “Në çdo rast, verifikimi dhe konfirmimi i akteve të kontrollit, sipas shkronjave ‘ç’ dhe ‘dh’, të këtij neni, janë të detyrueshme”. Duke marrë të mirëqenë se akti i gjashtë është mbajtur në përfundimin e objektit, shprehemi se është e pamundur që të jetë verifikuar dhe kontrolluar përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin brenda së njëjtës ditë;

- Mungojnë aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), i lëshuar nga institucionet kompetente për menaxhimin e mbetjeve urbane, OSHEE dhe Ujësjiellës-Kanalizime, veprime këto jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë). Në sistemin e-lejet është ngarkuar një mandat-pagesë e faturës së lëshuar nga OSHEE, si dhe një foto e librezës së kontratës me UK. Asnjë prej këtyre evidencave nuk vërteton dhënien e miratimit nga autoritetet e sipërcituara, mbi konformitetin mbi të cilin secila prej tyre shprehet;

- Mungojnë fotografitë e objektit në të katërta orientimet, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika j). Grupi i auditimit nuk mund të shprehet nëse objekti është ndërtuar në përputhje me projektin e miratuar. Në sistemin e-lejet gjenden vetëm dy foto (të të njëjtës fasadë), si pjesë përbërëse e raportit përfundimtar të kolaudimit;

- Mungon licenca e shoqërisë ndërtuese, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika k);

- Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili duhet të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, veprim ky jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika gj).

Veprime në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 3; neni 15, pika 1, nënpika c), e), ë), g); pika 1/1, nënpika i), iii); neni 27/1, pika 2; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), j), k), gj).

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E. M.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë;
- **Z. G. Gj.**, në cilësinë e drejtorit të DPU (aktualisht i larguar nga puna);
- **Z. I. B.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPU.

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast** Bashkia Rrogozhinë dhe Drejtoria e Politikave Urbane nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik të banesave sociale. Në përmbushje të përcaktimeve ligjore të nenit 19 të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, pika 1, çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m², siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Këto anomali janë konstatuar në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit për objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum, me adresë në Rrugën e Kavajës, Lagja nr. 1, Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “B- C” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 406, datë 22/12/2023 i Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, në të cilën nuk janë përcaktuar sipërfaqet të cilat do të kalojnë në favor të fondit publik të banesave sociale.

Veprime në kundërshtim me ligjin 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, i ndryshuar, neni 19, pika 1 dhe 2.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E. M.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë;
- **Z. G. Gj.**, në cilësinë e drejtorit të DPU (aktualisht i larguar nga puna);
- **Z. I. B.**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPU.

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria e Politikave Urbane (DPU), Bashkia Rrogozhinë, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale në lidhje me inspektimin e objekteve përpara dhe gjatë ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit, me adresë në fshatin Spille, Bashkia Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “A- V ” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 318, datë 24/04/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi është pajisur me dokumentin e Njoftimit të Fillimit të Punimeve në datën 08.06.2023. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Shtator 2023 (pra, me një diferencë kohore për afërsisht tre muaj) konstatohet se objektet me funksion akomodues janë në një fazë të përparuar të ndërtimit, ku dallohen mbulesat e sipërme të objektit, gjithashtu dallohen muret perimetral të ndërtuar. Referuar grafikut të punimeve, marrim informacionin se ndërtimi i mureve perimetrale me tulla të lehtësuara dopio është parashikuar të kryhet në muajin e gjashtë pas fillimit të punimeve. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenit 39 të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 39.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. D.**, në cilësinë e krye-inspektorit pranë IMTV, Bashkia Rrogozhinë;
- **Znj. E. B.**, në cilësinë e inspektores pranë IMTV, Bashkia Rrogozhinë;
- **Z. Z. K.**, në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, Bashkia Rrogozhinë;
- **Z. A. T.**, në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, Bashkia Rrogozhinë;
- **Z. E. K.**, në cilësinë e inspektorit pranë IMTV, Bashkia Rrogozhinë;
- **Znj. J. D.**, në cilësinë e inspektores pranë IMTV, Bashkia Rrogozhinë;

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** nuk janë respektuar afatet kohore të parashikuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi ose certifikata përdorimi. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit, me adresë në fshatin Spille, Bashkia Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “A-V” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 318, datë 24/04/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë:

- Shqyrtuar për 147 ditë pune;

2. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum, me adresë në Rrugën e Kavajës, Lagja nr. 1, Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “B-C” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 406, datë 22/12/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë:

- Shqyrtuar për 234 ditë pune.

Veprime në kundërshtim me Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 20 dhe neni 21; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 44, pika 2.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E. M**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë;

- **Z. G. Gj**, në cilësinë e drejtorit të DPU (aktualisht i larguar nga puna);

- **Z. I. B**, në cilësinë e nëpunësit pranë DPU.

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)

2.6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

2.6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

2.6.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmerin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Përshkrimi i situatës

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria Juridike e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, në lidhje me organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Në strukturën e miratuar me Vendimin Nr.102, datë 20.04.2022, IMTV ka në përbërje **6 (gjashtë)** pozicione pune, nga të cilët **1 (një)** Kryeinspektor **5 (pesë)** inspektor të paraqitura në formë tablele si vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar
1	D. D	Kryeinspektor	Financë-Bankë		Larguar në 02.10.2023
2	B. S	Kryeinspektor	Bachelor Inxhinieri Elektrike	02.10.2023	Në punë
3	E. B	Inspektor	Drejtësi	21.06.2021	Larguar në 01.11.2023
4	Z. K	Inspektor	Drejtësi	11.09.2026	Në punë
5	A. T	Inspektor	Drejtësi	05.10.2017	Në punë
6	E. K	Inspektor	Financë- Bankë	04.05.2022	Në punë
7	J. D	Inspektor	Drejtësi	16.11.2023	Në punë

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore, Bashkia Rrogozhinë

Për periudhën objekt auditimi, IMTV është drejtuar nga Kryeinspektor **z. D. D.**, i cili rezulton me arsim të lartë në Financë-Bankë (për periudhën 01.01.2023-02.10.2023), dhe Kryeinspektor **z. B. S.**, i cili rezulton me arsim të lartë në degën Inxhinieri Elektrike (për periudhën 02.10.2023-31.12.2023). Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se arsimimi i Kryeinspektorit **z. B. S** dhe 1 (një) inspektori **z. E. K.**, të IMTV-së nuk është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në **ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”**, i ndryshuar me **ligjin Nr.183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11** “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”, ku përcaktohet se: “Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional **në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.** Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përkrahur teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

I. Auditim mbi vendimet e marra nga IVMT për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga Inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Rrogozhinë, janë proceduar gjithsej **15 subjekte** për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se IMTV- Rrogozhinë ka proceduar vetëm për **7 subjekte** me Vendim për “Prishje të Objektivit të Kundërligjshëm” për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 13 paragrafi i parë, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Në të gjitha rastet, nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”, që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishjeje **vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Rrogozhinë, duke u bërë shkatarrë i rritjes së numrit të ndërtimeve informale që kalojnë në procesin e legalizimit**, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5, pika (d) të ligjit nr. 9780/ 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar, i cili përcakton se gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm;

-Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, neni 52 (6) i cili përcakton se: "**Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit** ";

-Vendimin nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore” në pikën 1 (b)/(iv) përcakton se: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore, përfshin në kontrollin e tij punimin /zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, **prishjen e objektit**, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, **në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u shqyrtuan me zgjedhje procedurat e ndjekura nga IMTV për ndërtimet informale të ndërtuara pa leje ndërtimi dhe për objektet në shkelje të lejes së ndërtimit

I. Dosja e subjektit (PF) H. R

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 01.12.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **H. R** me adresë: Lagja nr. 2, Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 16, datë 01.12.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi pa leje” Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 29, datë 08.01.2024 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me vendimin nr. 14, datë 08.12.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me vendimin nr. 10, datë 08.01.2024 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 214 prot., datë 16.01.2024, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim zj. H. R për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me shkresën nr. 215 prot., datë 16.01.2024, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim zj. H. R mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Konstatim:

-Vendimet “Për Dënimin me Gjobë” dhe “Për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm” të nxjerra nga Kryeinspektori janë në tejkalim të afateve të parashikuara në Vendimin nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 4 që citon: Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori.

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetas H. R, për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e” që përcakton se: Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

II. Dosja e subjektit (PF) A. D

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 25.10.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **A. D** me adresë: Lagja nr. 2, Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 12, datë 25.10.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi pa leje” Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 25, datë 01.11.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 50,000 lekë**.

Me vendimin nr. 10, datë 26.10.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me vendimin nr. 06, datë 01.11.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 4106 prot., datë 10.11.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. A. D për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 50,000 lekë**.

Me shkresën nr. 4234 prot., datë 20.11.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. A. D mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 50,000 lekë**.

Konstatim:

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektivit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e” që përcakton se: Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

III. Dosja e subjektit (PF) D. Sh

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 20.10.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **A. T** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektin

(PF) **D. Sh** me adresë: Rruga Xhamisë, Njësia Administrative Kryevindh, Spille Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 11, datë 20.10.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi soletë betoni me sipërfaqe 90m/katror”. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 24, datë 30.10.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Denimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me vendimin nr. 09, datë 23.10.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me vendimin nr. 05, datë 30.10.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 4102 prot., datë 10.11.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. D. Sh për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me shkresën nr. 4231 prot., datë 20.11.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. D. Sh mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin “Për Denimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Konstatim:

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektivit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përlllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e” që përcakton se: Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

IV. Dosja e subjektivit (PF) E. M

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 26.10.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektivin (PF) **E. M** me adresë: Rruga Xhamisë, Njësia Administrative Kryevindh, Spille Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 15, datë 26.10.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi pa leje përkatëse”. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 27, datë 03.11.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me vendimin nr. 13, datë 27.10.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me vendimin nr. 09, datë 03.11.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 4103 prot., datë 10.11.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim zj. E. M për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me shkresën nr. 4235 prot., datë 20.11.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim zj. E. M mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Konstatim:

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-Nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektivit të kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përlllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e” që përcakton se: Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

V. Dosja e subjektit (PF) S. B

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 25.10.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **S. B** me adresë: Zeshtik, Njësia Administrative Kryevidh, Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 13, datë 25.10.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi pa leje përkatëse”. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 26, datë 01.11.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me vendimin nr. 11, datë 26.10.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me vendimin nr. 07, datë 01.11.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 4105 prot., datë 10.11.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. S. B. për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me shkresën nr. 4232 prot., datë 20.11.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. S. B. mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se procedurat janë në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, regjistruar për gjykim me nr. 6128 (31154-09395-80-2023), datë 25.01.2024 regjistrimi, çështje administrative që i përket paditësit z. S. B dhe palë paditëse Inpektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, me objekt “Shfuqizim Vendimi”.

VI. Dosja e subjektit (PF) D. K

Me shkresën nr. 2789 prot., datë 19.06.2023, Komisariati i policisë Kavajë i ka dërguar kërkesë me lëndë “Për Verifikim Ligjshmërie” IKMT-së dhe IMTV-së Rrogozhinë mbi punime ndërtimore të konstatuara në banesën e shtetasit D. K.

Me shkresën nr. 495/1 prot., datë 27.06.2023, IKMT i ka dërguar “Për Trajtim” IMTV-së Rrogozhinë “Për Verifikim Ligjshmërie” mbi punime ndërtimore në banesën e shtetasit D. K.

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 15.06.2023, Kryeinspektori **D. D** dhe Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K** kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) D. K me adresë: Fshati Vilë Bashtovë, Njësia Administrative Gosë, Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 09, datë 15.06.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi mbi katin e dytë pa leje përkatëse”. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali nuk shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 22, datë 27.06.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 240,000 lekë**.

Me vendimin nr. 08, datë 15.06.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 2316/1 prot., datë 03.07.2023, IMTV Rrogozhinë i ka kthyer përgjigje IKMT-së mbi konstatimin e kundërvajtjes për shtetasin D. K.

Konstatim:

- Në dosje mungon procedura e njoftimit, e ndjekur nga IMTV Rrogozhinë, në zbatim të kërkesave të nenit 151 të Kodit të Procedurës Administrative.

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit D. K, për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

-Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

VII. Dosja e subjektit (PF) T. G

Me shkresën nr. 4872 prot., datë 14.09.2022, Komisariati i policisë Kavajë i ka dërguar kërkesë me lëndë “Për Verifikim Ligjshmërie” IMTV-së Rrogozhinë mbi punime ndërtimore të konstatuara në banesën e shtetasit T. G.

Me shkresën nr. 5173 prot., datë 15.11.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë i ka dërguar kërkesë me lëndë “Kërkojmë dokumentacion” IMTV-së Rrogozhinë mbi procedimin penal me nr. 451 të vitit 2022 për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” parashikuara nga neni 199/a i K.Penal ndaj shtetasin T. G.

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 19.04.2023, Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **T. G** me adresë: Fshati Sharrdushk, Njësia Administrative Kryevidh, Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 06, datë 19.04.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi pa leje përkatëse”. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali nuk shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 20, datë 24.04.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me vendimin nr. 06, datë 19.04.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 1692 prot., datë 02.05.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. T. G për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me shkresën nr. 1692/1 prot., datë 02.05.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. T. G mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Konstatim:

- Në dosje mungon kthim përgjigje drejtuar Komisarariatit të Policisë Kavajë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, për procedurën e ndjekur nga IMTV Rrogozhinë, mbi shkresën nr. 4872 prot., datë 14.09.2022 dhe shkresën nr. 5173 prot., datë 15.11.2022.

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përlllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e” që përcakton se: Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

VIII. Dosja e subjektit (PF) Rr. K

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 19.04.2023, Kryeinspektori **D. D** dhe Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **Rr. K** me adresë: Fshati Ballaj, Njësia Administrative Kryeviidh, Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 05, datë 19.04.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi pa leje përkatëse”. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali nuk shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 19, datë 24.04.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 50,000 lekë**.

Me vendimin nr. 05, datë 19.04.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 1690 prot., datë 02.05.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. Rr. K për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 50,000 lekë**.

Me shkresën nr. 1690/1 prot., datë 02.05.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. Rr. K mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 50,000 lekë**.

Konstatim:

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit Rr. K, për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përlllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e” që përcakton se: Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

IX. Dosja e subjektit (PF) B. B

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 19.04.2023, Kryeinspektori **D. D** dhe Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **B. B** me adresë: Rruga e Plazhit, Spille, Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 04, datë 20.03.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse "Punime ndërtimi, sistemim dherash, vendosje trafik ndarëse pa leje përkatëse". Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali nuk shoqërohet me foto.

Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 18, datë 25.03.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi "Për Dënimin me Gjobë", në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me vendimin nr. 04, datë 23.03.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi "Për Pezullimin e Punimeve" të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 1691 prot., datë 02.05.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. B. B për vendimin "Për Dënimin me Gjobë", në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me shkresën nr. 169/1 prot., datë 02.05.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. B. B mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin "Për Dënimin me Gjobë", në shumën **prej 500,000 lekë**.

Konstatim:

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 30, ku përcaktohet se "**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**".

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-Kryeinspektori nuk ka nxjerrë "Vendim për Prishje" në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit B. B, për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit" i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përlllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, pika "e" që përcakton se: Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

X. Dosja e subjektit (PF) Gj. A

Nga inspektimi i bërë në terren, më datë 20.01.2023, Kryeinspektori **D. D** dhe Inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, pranë Bashkisë Rrogozhinë, **E. K** dhe **Z. K**, kanë ushtruar kontroll në subjektin (PF) **Gj. A** me adresë: Lagja nr. 2, sipër stacionit të trenit, Rrogozhinë, u konstatuan punime pa leje.

Inspektorët e IMTV-së, me procesverbalin nr. 03, datë 20.01.2023, kanë mbajtur konstatimin e kundërvajtës për punime pa leje përkatëse “Punime ndërtimi, objekt i ri nga themelet pa leje përkatëse”. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se proces-verbali nuk shoqërohet me foto. Duke vlerësuar sa më sipër si kundërvajtje administrative, inspektorët kanë vendosur njoftimin e kryeinspektorit, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Me vendimin nr. 17, datë 25.01.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me vendimin nr. 03, datë 23.01.2023 nga kryeinspektori është marrë vendimi “Për Pezullimin e Punimeve” të ndërtimit pa leje.

Me shkresën nr. 605 prot., datë 13.02.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. Gj. A për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Me shkresën nr. 605/1 prot., datë 13.02.2023, IMTV Rrogozhinë i ka dërguar njoftim z. Gj. A mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare për vendimin “Për Dënimin me Gjobë”, në shumën **prej 500,000 lekë**.

Konstatim:

-Gjoha nuk është paguar nga kundërvajtësi në mospërputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, ku përcaktohet se “**gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit**”.

-Në dosje mungon kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit në Gjykatë.

-Kryeinspektori i IMTV-së nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i cili në nenin 30, pika (4) përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative;

-Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal në ngarkim të shtetasit Gj. A, për shkeljen e konstatuar në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

-IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përlllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e” që përcakton se: Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

Nga auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV-ja për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi konstatohet se, janë proceduar gjithsej **15 subjekte** për ndërtime in formale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit të pa shoqëruara të gjitha me Vendim për “Prishje të Objektivit të Kundërligjshëm”. Në **5** raste, Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar. Në **7** raste, nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”, që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishjeje **vijojnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Rrogozhinë, duke u bërë shkaktarë i rritjes së numrit të ndërtimeve in formale që kalojnë në procesin e legalizimit**, ku subjektet kanë përfutur parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin

e turizmit, në kundërshtim me nenin 5, pika (d) të ligjit nr. 9780/ 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar; nenin 52 (6) i Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar; pikën 1 (b)/(iv) i Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore"

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, nenin 5 pika "d"; Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, neni 52 (6); Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore" pikën 1 (b)/(iv).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. **E. M**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë; z. **D. D**, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 01.01.2023-02.10.2023); z. **B. S**, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 02.10.2023-31.12.2023); z. **G. Gj**, në cilësinë e Drejtorit të DPU-së.

- Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

Grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2023, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë dosjet e procedurave të mbajtura nga IVMT:

- në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët;
- vendimet e gjobave;
- vendimet e pezullimit;
- vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve;
- kallëzimet penale;
- kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv;
- informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT;
- planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga k/inspektori.

Në formë table paraqiten vendimet e marra nga IMTV Rrogozhinë për vitin 2023 paqyruar si më poshtë:

Nr.	Lloji i aktit	2023
1	PV/Akte kontrolli	-
2	PV/Akte konstatimi	15
3	Vendime gjobe	15
4	Vendime pezullimi	13
5	Vendime prishje	7
6	PV ekzekutimi të prishjeve	0
7	Kallëzime penale	0
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	0
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	0
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	0
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	2

Burimi: IVMT Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se IMTV Rrogozhinë nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në mospërputhje me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësi të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni. Kryeinspektori, nuk ka miratuar planet vjetore dhe mujore të punës për (Janar-Tetor), në mospërputhje me pikën 1 gërma b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, që përcakton se:

b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

ii) kryen kontrole në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike.

-Kryeinspektori i IMTV-së, **nuk ka përcjellë asnjë Kallëzim Penal ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje** nga organet përkatëse, në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar.

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Rrogozhinë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, rezulton se janë vendosur **15** gjoba në vlerën prej 6,840,000 Lekë, dhe nuk është vjelë asnjë prej tyre **duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 6,840,000 lekë.**

Sa më sipër, rezulton se për të gjitha praktikat IVMT, DTTV-ja, dhe Drejtoria Juridike nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë në vlerën prej **6,840,000 lekë**, në mospërputhje me kërkesat e Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar, neni 16/a që përcakton se: “Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamata 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit”.

Subjekte kundërvajtës të konstatuar IMTV, Bashkia Rrogozhinë janë sipas Aneksit 5 të Projektraportit të Auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi nuk është bërë asnjë kërkesë për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit të gjobave, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" neni 30 (4) i cili përcakton se kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:

a) kryetari i bashkisë;

b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.

Mbi gjobat e mbartura (2018-2022)

Nga auditimi i kryer lidhur me vjeljen e gjobave ndër vite (2018-2022), konstatohet se, për **15** kundërvajtës, Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit Ekonomik, Sektori juridik dhe IMTV nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë **në vlerën totale prej 5,700,000 Lekë**, në mospërputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative"

Subjekte kundërvajtës të konstatuar për vitet 2018-2022

IMTV, Bashkia Rrogozhinë

Nr.	Viti	Nr. i gjobave	Vlera e gjobave
1	2018	2	550,000
2	2019	3	1,050,000
3	2020	1	500,000
4	2021	2	550,000
5	2022	7	3,050,000
Totali		15	5,700,000 Lekë

Burimi: IMTV Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër, rezulton se IMTV nuk ka bërë asnjë kërkesë për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e detyrimeve për **15** kundërvajtës.

Nga kontrolli i dokumentacionit konstatohet se me shkresën nr. 708 prot., datë 15.02.2024, me lëndë "Mbi vjeljen e gjobës në mënyrë vullnetare" IMTV Rrogozhinë i ka kërkuar Drejtorisë së Financës, Sektorit Juridik dhe Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik nisjen e procedurave ligjore për vjeljen e gjobave për këta kundërvajtës.

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Rrogozhinë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, rezulton se janë vendosur **15** gjoba në vlerën prej 6,840,000 Lekë, dhe nuk është vjelë asnjë prej tyre **duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 6,840,000 lekë.**

Nga auditimi i kryer lidhur me vjeljen e gjobave ndër vite (2018-2022), konstatohet se, për **15** kundërvajtës, Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit Ekonomik, Sektori juridik dhe IMTV nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Rrogozhinë **në vlerën totale prej 5,700,000 Lekë**, në mospërputhje me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "*Për Kundërvajtjet Administrative*".

Sa më sipër, konstatohet se përgjatë periudhës objekt auditimi nuk është bërë asnjë kërkesë për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit të gjobave, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "*Për Kundërvajtjet Administrative*" neni 30 (4).

Në 8 raste, IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*" i ndryshuar, pika "e". Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*", Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 "*Për Kundërvajtjet Administrative*".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E . M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë; **z. D. D,** në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 01.01.2023-02.10.2023); **z. B. S,** në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 02.10.2023-31.12.2023); **z. G. Gj,** në cilësinë e Drejtorit të DPU-së.

- *Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe, bashkëpunimi me Drejtorinë dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.*

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se IMTV Rrogozhinë i ushtron funksionet e veta **jo në përputhje të plotë me ligjin Nr. 9780, Datë 16.07.2007** "*Për inspektimin e ndërtimit*" i ndryshuar,

me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet e paligjshme si dhe kontrollin ndërtimeve të pajisura me leje.

Për periudhën objekt auditimi, bashkia rezulton të ketë **148** aplikime në sistem për leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi ndër të cilat rezultojnë të miratuara **105** leje, pasqyruar si më poshtë:

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 nga sistemi e-Leje

Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i miratimeve
Certifikatë përdorimi	2	2
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	32	25
Leje infrastrukture	1	1
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ²	8	8
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	1	1
Leje për ndryshim funksioni	0	0
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	0	0
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	0	0
Leje përshtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	0	0
Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	50	30
Leje zhvillimi	15	4
Njoftim për fillim punimesh	31	30
Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	1	1
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m ²	0	0
Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	5	3
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m ²	2	0
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	0	0

Burimi: Bashkia Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Kryeinspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në mospërputhje me nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

-nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar i cili përcakton se:

Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

-pikën 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” e cila përcakton se:

Kryeinspektori/inspektori i njësisë vendore, gjatë kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, i vlerëson shkelje të punimeve në ndërtim rastet e mospërputhjes së objektit në ndërtim me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik të zbatimit apo me deklarin paraprak të miratuar e të konfirmuar nga organi i autorizuar.

Nga auditimi konstatohet mungesa e një bashkëpunimi eficient, midis IMTV-së dhe Drejtorisë së Politikave Urbane, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit në Bashkinë Rrogozhinë në kundërshtim me

pikën (3) të nenit 51 në Ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, i cili përcakton se: **Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.**

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Arsimimi i Kryeinspektorit z. B. S dhe 1 (një) inspektori z. E. K, të IMTV-së nuk është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin Nr.183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11;

-Në 5 raste, Kryeinspektori nuk ka nxjerrë “Vendim për Prishje” në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar;

-Në 7 raste, nga Kryeinspektori i IMT-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e “Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm”, që do të thotë se objektet e konstatuara të kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishjeje vijnë të pa ekzekutuara nga IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë, në kundërshtim me nenin 5 pika “d” dhe nenin 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe në kundërshtim me nenin 52 pika 6 të Ligjit Nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar;

-Në 4 raste, IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal , për shkeljet e konstatuara në kundërshtim me nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar;

-Në 15 raste, nga IMTV-ja nuk ka vijuar me kërkesë për të nxjerrë “Urdhrat e Ekzekutimit” të gjobave, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në dispozitat ligjore të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" neni 30 (4);

-Në 8 raste, IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk e ka përllogaritur gjobën në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, pika “e”

-Në 7 raste nga Kryeinspektori nuk është bërë “Kërkesë për mbështetje” drejtuar Institucioneve ligj zbatuese, në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektivit të kundërligjshëm;

-IMTV Rrogozhinë nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në mospërputhje me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar;

Kryeinspektori, nuk ka miratuar planet vjetore dhe mujore të punës, (Janar-Tetor) në mospërputhje me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”,

-Nga kontrolli i dokumentacionit, konstatohet mungesa e një bashkëpunimi eficient, midis IMTV-së dhe DPU-së, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit, në mospërputhje me pikën (3) të nenit 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar;

Në përfundim të auditimit të dokumentacionit mbi aktivitetin e IMTV, Bashkia Rrogozhinë për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, arrihet në konkluzionin, se kjo strukturë nuk e ka përmbushur plotësisht qëllimin e saj, garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas kuadrit rregullator të fushës, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore përkatëse.

Veprimet e dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhshmëri me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- Ligji nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar;
- Ligji nr. 183/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, Datë 16.7.2007, "Për Inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 23/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9780, Datë 16.7.2007 "Për Inspektimin në ndërtim", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative";
- Ligji nr. 107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar;
- Vendimi nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. **E . M**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë; z. **D. D**, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 01.01.2023-02.10.2023); z. **B. S**, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 02.10.2023-31.12.2023); z. **G. Gj**, në cilësinë e Drejtorit të DPU-së.

2.7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.7.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

2.7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 203/16 prot., datë 15.09.2023, protokolluar në Bashkinë Rrogozhinë me nr. 3296 prot., datë 18.09.2023, ku janë lënë për zbatim 30 masa organizative, 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën 788,183 lekë, 5 masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 391,967,138 lekë, 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 627,332,000 lekë dhe 11 masa disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 30 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë zbatuar plotësisht, 5 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 20 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa në vlerën 788,183 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 2 masa janë të pa zbatuara.

c. Për arkëtimin e të ardhurave të munguara janë rekomanduar 5 masa në vlerën 391,967,138 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 4 masa janë të pa zbatuara.

d. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimit e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike është rekomanduar 1 masë në vlerën 627,332,000 lekë e cila është pranuar plotësisht, nga masa e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht.

e. Masa disiplinore janë rekomanduar 11 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë zbatuar plotësisht dhe 8 masa janë të pa zbatuara.

-Gjithashtu nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 20 ditorë dhe atë 6 mujor.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, gërma “j”, neni 30, pika 2.

- Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë masat e duhura për raportimin në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 20 ditor. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”, ku përcaktohet që: “Të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”.

- Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhënave”.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Rrogozhinë administruar në KLSH me nr. 203/16 prot., datë 15.09.2023, dhe protokolluar në Bashkinë Rrogozhinë me nr. 3296 prot., datë 18.09.2023, janë rekomanduar gjithsej:

- 30** masa organizative.
- 2** masa për shpërblim dëmi në vlerën **788,183 lekë**.
- 5** masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **391,967,138 lekë**.
- 1** masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efijçencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **627,332,000 lekë**.
- 11** masa disiplinore.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Rrogozhinë të Kryetarit të Bashkisë z. E . M me nr. 3674 prot., datë 11.10.2023, është ngritur komsioni për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të KLSH. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	30	30	0
Masa për shpërblim dëmi	2 788,183 lekë	2 788,183 lekë	0
Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara	5 391,967,138 lekë	5 391,967,138 lekë	0

Masa për eliminimin e efekteve negative	1 627,332,000 lekë	1 627,332,000 lekë	0
Masa disiplinore	11	11	0
Totali	49	49	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Mallakastër:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	30	3	5	2	20
Masa për shpërbllim dëmi	2 788,183 lekë	0	0	0	2
Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara	5 391,967,138 lekë	0	1	0	4
Masa për eliminimin e efekteve negative	1 627,332,000 lekë	0	1	0	0
Masa disiplinore	11	3	0	0	8
Totali	49	6	7	2	34
Totali në %	100%	12.2%	14.2%	4%	69.6%

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

-Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

-Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë marrë masat e duhura për hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara për secilin sektor dhe drejtori. Nuk është hartuar strategjia e riskut dhe gjurma e auditimit. Gjithashtu hartë të proceseve të punës ka hartuar vetëm Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Sociale.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

1.2. Rekomandim: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil si dhe të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Sektori i Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat e duhura për rregullimin e pozicioneve të punës konkretisht vendet të cilat i përkasin punonjësve që rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin për nëpunësin civil janë trajtuar si punonjës me Kod Pune. Me

shkresën nr. 4075/1 prot., datë 24.11.2023, Bashkia Rrogozhinë i ka dërguar ASP-ës vlerësimin e nevojave për trajnim për vitin 2024.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke marrë masa për certifikimin e audituesve të pa certifikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nuk është plotësuar struktura organizative e NJAB-së me punonjës konformë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu punonjësit e kësaj njësie nuk janë trajtuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

2.2. Rekomandim: Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, është hartuar karta e auditimit të brendshëm miratuar nga Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë me shkresën nr. 3807 prot., datë 20.10.2023.

Rekomandimi është zbatuar.

2.3. Rekomandim: Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Rrogozhinë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nuk janë përfshirë në planin vjetore auditimi i drejtorive apo sektorëve me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Rrogozhinë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

3.1. Rekomandim: Në Bashkinë Rrogozhinë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa që të paraqesin projektet e planifikuara për buxhetin me të gjitha specifikimet sipas kërkesave ligjore dhe EMP të secilit program, të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e Planit të zhvillimit vendor dhe Strategjive Kombëtare kryesisht atyre të mjedisit dhe pyjeve, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Rrogozhinë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

4.1 Rekomandim: Në Bashkinë Rrogozhinë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo situatë është konstatuar edhe në realizimin e buxhetit për vitin 2023 konkretisht, plani në vlerën 1,324,341,600 lekë dhe realizimi në vlerën 934,077,570 lekë ose realizuar në masën 70.5%.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

5.1. Rekomandim: Kryetari e Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet faturat e pa likuiduara më datë 31.12.2023, janë në vlerën 143,601,026 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

6.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit Bashkia Rrogozhinë, të kryejë veprimet dhe sistemimet kontabël për diferencat, nënvlerësimet, mbivlerësimet në llogaritë, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 466 “Mjete në ruajtje”, 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, 230-231, 218 “Inventar ekonomik”.

Të hartohen dhe të miratohen pasqyrat financiare në mbyllje të vitit ushtrimor brenda afateve ligjore datë 31 mars të vitit pasardhës; Të plotësohen me rigorozitet të gjitha pasqyrat sipas formateve të miratuara nga MFE.

Të ndiqen me vëmendje pagesat e aktiveve në proces, që me likuidimin e vlerës së kontratës, të merren në dorëzim objekti i investimit dhe të bëhen veprimet kontabël për mbylljen e llog. 230-231 dhe kontabilizimin e vlerës së tij në llogarinë përkatëse të AAGJM.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Pasqyrat Financiare të Bashkisë Rrogozhinë për vitin ushtrimor 2023 janë të nënshkruara nga z. E .M Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. R. V me detyrë Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Kavajë me shkresën nr. 74 prot., datë 19.03.2024, brenda afatit ligjor. Për sa i përket procesit të inventarizimit nuk është realizuar për vitin 2023 por ka mbetur në fazën e ngritjes së urdhrin të ngritjes së komisionit të inventarizimit. Gjithahstu nuk janë kryer sistemimet e llogarive të evidentuara në gjetjen e sipërpërmendur.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

7.1. Rekomandim: Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi zbatues dhe Sekretari i Përgjithshëm në Bashkinë Rrogozhinë të marrin masa për të zbatuar të gjitha hallkat e procedurës standard të Inventarizimit të aktiveve të njësisë kryesisht atë të nxjerrjes jashtë përdorimit/asgjesimit të atyre të amortizuara; në krijimin e regjistrit të aktiveve sipas kërkesave të akteve ligjore/nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Për vitin 2023 nga Bashkia Rrogozhinë nuk është realizuar procesi i inventarizimit të aktiveve afatgjata. Kjo situatë ka mbetur në fazën e ngritjes së urdhrave të komisioneve të inventarizimit.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

7.2. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të nisnin procedurat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie dhe të rivlerësojnë aktivet e bashkisë, me qëllim kontabilizimin e vlerave të sakta të tyre në llogaritë përkatëse të AAGJM në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i aktiveve afatgjata materiale konstatohet se, nga aktivet të cilat janë të kontabilizuara në llogaritë 210, 211, 212 dhe 213 vetëm 8 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie. Gjithashtu nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë marrë masat e duhura për kontabilizimin e 2,233 pasurive të transferuara me VKM-të përkatëse apo pajisjen e tyre me çertifikatë pronësie.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

7.3. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me njësitë e tjera në strukturë të hartojnë regjistrin e asetëve të bashkisë, ku të identifikohen dhe të pasqyrohen gjithë të dhënat konform udhëzimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, deri më datë 05.04.2024, nga Bashkia Rrogozhinë, Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social nuk janë masat e duhura për hartimin e regjistrit të asetëve.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

7.4. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të nisnin procedurat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie dhe të rivlerësojnë aktivet e bashkisë, me qëllim kontabilizimin e vlerave të sakta të tyre në llogaritë përkatëse të AAGJM në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Rrogozhinë nuk disponohet një korrespondencë me Agjencisë Shtetërore të Kadastër Dega Kavajë në lidhje me nisjen e procesit të pajisjes me çertifikatë pronësie të pasurive të saj. Për më tepër në buxhetin e vitit 2023 nuk janë parashikuar fonde për pajisjen e pasurive të institucionit me çertifikatë pronësie.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

8.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ligjore, Burimeve njerëzore dhe Komunikimit, menaxherët e të gjitha njësive të strukturës në Bashkinë Rrogozhinë të kompozojnë dhe miratojnë një strukturë organizative konform funksioneve që i atribuon ligji, për rritjen e efektivitetit të shërbimeve që bashkia i ofron komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Në strukturën organizative miratuar me Vendimin nr. 102, datë 20.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, janë përfshirë përshkrimet e punës për secilën drejtori. Nga auditimi i praktikave konstatohet se dosjet kanë mangësi dokumentacioni.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

9.1. Rekomandim: Titullari i AK, të ngrejë grupe pune me urdhrat përkatës për përllogaritjen e fondit limit pa copëzuar fondet, duke evidentuar mënyrën e ndjekur sipas rregullave të prokurimit publik duke dokumentuar me procesverbalet përkatëse procesin e vlerësimit, renditjes, tërheqjes dhe ftesën e OE për të lidhur kontratë.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë auditimit të procedurave të prokurimeve me vlera të Vogla për vitin 2023. Në mënyrë të hollësishme kjo situatë është trajtuar në aktkonstatimin nr. 8, datë 05.04.2024, me objekt "Auditimin e procedurave të prokurimeve me vlera të Vogla për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023".

Rekomandimi nuk është zbatuar.

9.2. Rekomandim: Komisioni për Blerjet e Vogla, të dokumentojë me procesverbalet përkatëse procesin e vlerësimit, renditjes, tërheqjes dhe ftesën e OE për të lidhur kontratë. Të administrohen dokumentet e OE me të cilët lidhet kontrata, dhe në çdo rast të shoqërohet me fletë hyrjen e mallit në magazinë, të firmosur nga personi përgjegjës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë auditimit të procedurave të prokurimeve me vlera të Vogla për vitin 2023. Në mënyrë të hollësishme kjo situatë është trajtuar në aktkonstatimin nr. 8, datë 05.04.2024, me objekt "Auditimin e procedurave të prokurimeve me vlera të Vogla për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023".

Rekomandimi nuk është zbatuar.

9.3. Rekomandim: Të evitohet copëzimi i fondeve nga AK. Procedurat për mallra/ shërbime me objekt të njëjtë ose të ngjashëm, të kryhen nëpërmjet procedurave në përputhje me vlerën e fondit përkatës kur ajo e kalon vlerën 1,000,000 lekë, dhe jo të copëzohet në disa të tilla.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë auditimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2023 konkretisht:

Bashkia Rrogozhinë për vitin 2023 ka realizuar 5 procedura prokurimi me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 4,900,000 lekë pa Tvsh duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me tenderim. Konkretisht, dy procedura "Blerje kompjutera", me urdhër prokurimi nr. 75 datë 30.01.2023, me fond limit

1,000,000 lekë pa Tvsh dhe procedura “F.V. Pajisje zyre elektronike” me urdhër prokurimi nr. 104, datë 15.03.2023, me fond limit 900,000 lekë pa Tvsh që i përkasin të njëjtit objekt prokurimi blerje pajisje elektronike. Si dhe tre procedura “Servis zjarrëfikëses” me urdhër prokurimi nr. 122, datë 18.04.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh, procedura “Servis, mjetesh Bashkia Rrogozhinë” me urdhër prokurimi nr. 116, datë 06.04.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh dhe procedura “Servis mjetesh, Bashkia Rrogozhinë” me urdhër prokurimi nr. 98, datë 09.03.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh që i përkasin të njëjtit objekt prokurimi servis mjetesh.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

9.4. Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Rrogozhinë, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë auditimit të procedurave të prokurimeve me vlera të Vogla për vitin 2023. Në mënyrë të hollësishme kjo situatë është trajtuar në aktkonstatimin nr. 8, datë 05.04.2024, me objekt “Auditimin e procedurave të prokurimeve me vlera të Vogla për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023”.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

10.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit Urban në procesin e miratimit për lejet e ndërtimit, të respektojë rregullat e zhvillimit të territorit kjo për të mundësuar trajtim të barabartë të parametrave teknik të zhvillimit, duke mos cenuar të drejtat e zhvillimit të subjekteve tjera sipas njësive strukturore.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se në dy raste të audituara që i përkasin vitit 2023, nuk janë respektuar kondicionet urbane.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

10.2. Rekomandim: Në mungesë të PDV-ve, të miratohen lejet e ndërtimit vetëm kur subjekti zhvillues të jetë pajisur me lejen e zhvillimit.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se problematika e trajtuar në rekomandimin nr. 10.2, nuk është hasur gjatë auditimit të praktikave të zhvilluara në vitin 2023.

Rekomandimi është zbatuar.

10.3. Rekomandim: Për të gjitha aplikimet për leje ndërtimi mbi 50 m², të kërkohet në çdo rast Raporti i Auditimit të Eficencës Energjetike dhe Certifikata e Performancës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se problematika e trajtuar në rekomandimin nr. 10.3, nuk është hasur gjatë auditimit të praktikave të zhvilluara në vitin 2023.

Rekomandimi është zbatuar.

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nuk janë rekrutuar punonjës të kualifikuar me qëllim rritjen e cilësisë së inspektimit dhe kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Më hollësisht kjo problematikë është trajtuar në aktkonstatimin nr. 3, datë 05.04.2024.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

11.2. Rekomandim: IMT Bashkia Rrogozhinë, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: IMT Bashkia Rrogozhinë nuk ka mbajtur aktkontrolle për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës. Më hollësisht kjo problematikë është trajtuar në aktkonstatimin nr. 3, datë 05.04.2024.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

11.3. Rekomandim: IMT Bashkia Rrogozhinë, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve. Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: IMT Bashkia Rrogozhinë nuk ka aplikuar të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes. Kryetari i Bashkisë nuk ka marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje. Më hollësisht kjo problematikë është trajtuar në aktkonstatimin nr. 3, datë 05.04.2024.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

11.4. Rekomandim: IMT Bashkia Rrogozhinë, të disponojë të gjitha praktikantët në dosje të veçanta për secilin konstatim, duke u dokumentuar krahas akteve të mbajtura, edhe fotografitë për situatat e konstatuara të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga praktikantët e audituara përgjatë vitit 2023, në disa raste nuk janë të shoqëruara me foto konstatimet në lidhje kundërvajtjet e ndërtimeve pa leje. Më hollësisht kjo problematikë është trajtuar në aktkonstatimin nr. 3, datë 05.04.2024.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

11.5. Rekomandim: IMT Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë

e Financës dhe Drejtorinë e Taksave, të bashkërendojnë punën për të mundësuar arkëtimin e gjobave të nxjerra.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: *IMT Bashkia Rrogozhinë, Drejtorinë Juridike e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik nuk janë marrë masat e duhura për vjeljen e gjobave. Më hollësisht kjo problematikë është trajtuar në aktkonstatimin nr. 3, datë 05.04.2024.*

Rekomandimi nuk është zbatuar.

12.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik/Bashkia Rrogozhinë të marrë masat për krijimin e një regjistri elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: *Të dhënat mbi debitorët nga taksat dhe tarifave vendore mbahen në programin Excel. Si dhe nuk është hartuar regjistri i tatim paguesve në formë shkresore.*

Rekomandimi është në proces zbatimi.

12.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: *Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë vitit 2023 konkretisht:*

Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është në vlerën 238,288,150 lekë dhe realizimi në vlerën 141,685,369 lekë ose në masën 59.4% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 96,602,781 lekë. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në aktkonstatimin nr. 4, datë 05.04.2024, me objekt "Burimi i krijimi të të ardhurave".

Rekomandimi nuk është zbatuar.

12.3. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Rrogozhinë nga taksat që mbledhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Rrogozhinë të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: *Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, vetëm me Agjentin Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Durrës ka rakordime periodike për disa muaj. Ndërsa për agjentët tatimore si ASHK Kavajë dhe DSHTRR Durrës nuk janë mbajtur akt*

rakordime mujore. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në aktkonstatimin nr. 4, datë 05.04.2024, me objekt “Burimi i krijimi të të ardhurave”.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

13.1. Rekomandim: Kontrolli i Lartë i Shtetit inkurajon subjektin Bashkia Rrogozhinë që krahas punës që ka bërë për zbatimin e rekomandimeve, të vijojë procedurat administrative e ligjore për zbatimin e masave të pazbatuara dhe në proces zbatimin deri në mbylljen e plotë të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Rrogozhinë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

B. Masa shpërblim dëmi

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **93,600 lekë pa Tvsh** nga BOE “B- B” Shpk & “B- N” Shpk & “M” Shpk & “P- V” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, me objekt: “Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Rrogozhinë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **694,583 lekë pa Tvsh** nga BOE “B- II” Shpk, & “Sh” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1521/2 prot., datë 26.05.2021, me objekt: “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë.”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Rrogozhinë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

C. Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik /Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore progresive në vlerën totale 343,141 mijë lekë (familjarë dhe biznese), duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

-Të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme/Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme)

-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet

kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

-Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke i njoftuar nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) dhe ndjekjen e konfirmimit prej familjeve, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, situata debitore më datë 31.12.2023, për abonentët familjarë është në vlerën 197,907,763 lekë dhe për biznesin e vogël dhe të madh në vlerën 43,542,236 lekë, nga dhënie me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullësor 2,475,500 lekë dhe dhënien me qira të sipërfaqeve të plazheve në vlerën 916,660 lekë.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

1.2. Rekomandim: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorinë Ligjore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 38,580,035 lekë dhe t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Kavajë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, në lidhje me situatën progresive mbi debitorët për mos likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë deri më datë 31.12.2023, Bashkia Rrogozhinë nuk disponon informacion. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në aktkonstatimin nr. 4, datë 05.04.2024, me objekt “Burimi i krijimi të të ardhurave”.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

1.3. Rekomandim: DAZHE në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj 5 subjekteve për arkëtimin e vlerës 4,100,000 lekë krijuar nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, në territorin e Bashkisë Rrogozhinë ushtrojnë aktivitet 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Autorizimet janë të lidhura ndërmjet Bashkisë Rrogozhinë dhe subjekteve përkatëse për një periudhë kohore 1 deri në 5 vjet. Për vitin 2023 këto subjekte nuk janë debitore. Gjithashtu është konstatuar se një subjekt ushtron aktivitet pa u pajisur me autorizim. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike në aktkonstatimin nr. 4, datë 05.04.2024, me objekt “Burimi i krijimi të të ardhurave”.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

1.4. Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutivë, duke

Ilogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën totale 5,700,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Rrogozhinë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **446,103 lekë** ndaj subjektit Rifat Kaziu për taksën e ndikimit në infrastrukturë e cila është përlllogaritur gabim nga personat përgjegjës.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Rrogozhinë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masat për hartimin e kriterëve teknike në dokumentet e tenderit, të argumentuara dhe në përputhje me objektin e kontratës dhe të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomikitet dhe eficencë të fondeve publike për vlerën **627,332 mijë lekë pa Tvsh.**

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Për periudhën 01.01.2023, deri më 31.12.2023, në total janë realizuar 2 procedura prokurimi me fond limit 14,200,000 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate 13,712,500 lekë pa Tvsh.

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, viti 2023, me fond limit 11,200,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “G-C-G” ShPK, me vlerë të ofertës 11,200,000 lekë pa Tvsh rezulton se, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT.

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje dru zjarri dhe palet, për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, viti 2023, me fond limit 3,000,000 lekë pa Tvsh, me fitues OE “A” ShPK, me vlerë të ofertës 2,512,500 lekë pa Tvsh rezulton se, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT. Ndërsa në këto dy procedura nuk janë konstatuar kritere të pa argumentuara.

Rekomandimi zbatuar pjesërisht.

E. Masa disiplinore

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 germa g, neni 15, pika 4, ligjin nr. 7961, datë

12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, kontratën individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje”, deri në “*LAm nga shërbimi civil*”, në proporcion me shkeljen, për punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nga “Vërejtje”, deri në “*Zgjidhje të kontratës së punës*”, në proporcion me shkeljen, për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta.

1. Z. G. Gj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Urban për veprimet dhe mos veprimet në arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve të reja, si dhe për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Z. A. K, me detyrë Përgjegjës Sektori i Biznesit dhe Kontabilizimit e të Ardhurave për mos marrjen e masave për të ulur vlerën e borxhit tatimor.

3. Z. O. T, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik për mos marrjen e masave për të ulur vlerën e borxhit tatimor dhe mos pagesën e detyrimeve për autorizim nga subjektet që tregtojnë lëndë djegëse me pakicë.

4. Znj. M. Th, me detyrë Përgjegjëse i Sektorit e taksave dhe tarifa familjare për mos marrjen e masave për të ulur vlerën e borxhit tatimor.

5. Z. D. D, me detyrë Kryeinspektor i IMTV për veprime dhe mos veprime lidhur me pagesën e gjobave të vendosura nga IMTV Rrogozhinë si dhe problematikat e konstatuara në zbatimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e territorit .

6. Z. H. P, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë së Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit, duke hartuar kriterë jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar.

7. Z. F. M, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

8. Z. O. D, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

9. Z. E. S, në cilësinë e Kryetarit të KVO për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

10. Z. A. M, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.

11. Z. I. B, me detyrë Specialist për veprimet dhe mos veprimet në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Për punonjësit e larguar

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion si rezultat nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore:

1. Z. A. S, me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit, duke hartuar kriterë jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar, si dhe për shkeljet në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Z. E. H, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit, duke hartuar kriterë jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar.

3. **Z. S. L**, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit, duke hartuar kriterë jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar.
4. **Z. J. M**, në cilësinë e Kryetarit të KVO për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.
5. **Z. S. B**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.
6. **Z. G. Gj**, në cilësinë e anëtarit të KVO-së për shkeljet e konstatuara në kualifikimin e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor për prokurimet publike.
7. **Z. Z. P**, me detyrë Kontrollues për veprimet dhe mos veprimet në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
8. **Zj. L. S**, me detyrë Specialist për veprimet dhe mos veprimet në zbatimin e kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se:

- Nuk është janë hartuar planet vjetore të punës.
- Nuk ka raportime periodike nga njësitë e varësisë si dhe menaxherët e strukturave brenda institucionit.
- Zyrtarët raportues dhe zyrtari autorizues nuk kanë kryer vlerësimet e punës gjatë vitit kalendarik në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.
- Titullari i bashkisë nuk ka përcjellë pranë Ministrisë së Financave “Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike” që mbulon, për vitin e mëparshëm. - Dosjet personale të punonjësve kanë mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, vërtetim të gjendjes gjyqësore etj. Punësimi i 6 nëpunësve civilë në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të kërkuara dhe pa zhvilluar paraprakisht një procedurë konkurrimi të hapur, është në kundërshtim të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.
- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të. Takimet e GMS nuk dokumentohen me minuta takimi apo procesverbale. Bashkia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.
- Nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Pyetëtori i vetëvlerësimit të këtij institucioni nuk paraqet situatën reale të tij në lidhje me këtë fushë, ku mbi 70 % e pyetjeve të pyetësit janë të pa përgjigje.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 18-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për:

-Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performance, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

-Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.

-Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.

- Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

-Dosjet e personelit të plotësohen me dokumentacion origjinal apo fotokopje të noterizuara, duke bërë dhe inventarizimin e tyre.

-Punonjësit të njihen me formularin përkatës të vlerësimit të performancës dhe ky i fundit të jetë pjesë e dosjeve të personelit.

-Punësimi i punonjësve të kryhet me një procedurë konkurrimi të hapur dhe në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara për pozicionin e punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Rrogozhinë përgjatë vitit 2023, u konstatua se:

Burimet në dispozicion të strukturës audituese kanë mungesë të përvojës së punës në profesion dhe në auditim, ku konstatohet se janë rekrutuar 2 (dy) auditues të cilët nuk kanë eksperiencë në punë si auditues të brendshëm dhe nuk ka filluar procesin e certifikimit për 3 (tre) auditues, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Në Rregulloren e Brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Rrogozhinë”, nenet 34-36 nuk janë përditësuar në mospërputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin e auditimit të brendshëm.

Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, si dhe nuk është hartuar “Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë së auditimit të brendshëm”, veprime në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII. Në Planin Strategjik për vitet 2022-2024.

Për 14 subjekte nuk janë përcaktuar fushat për auditim, ndonëse janë përcaktuar nivelet përkatëse të riskut, në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III.

Janë kryer 2 (dy) angazhime auditimi kundrejt 9 (nëntë) angazhimeve auditimi të programuara në Planin Vjetor të Punës. NJAB, nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë. Për çdo angazhim auditimi të kryer përgjatë vitit 2023, nuk janë evidentuar dhe dokumentuar të gjitha proceset e punës audituese në mospërputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitullin VI.

Nuk janë dokumentuar programet e angazhimit të auditimeve sipas formatit të miratuar, duke përcaktuar llojin, metodat e teknikat e auditimit që do të përdoren për kryerjen e auditimeve. Në raportet e auditimit audituesit nuk kanë dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e audituara.

Nuk është kryer auditim tematik për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH-ja. NJAB nuk ka dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2-2.1.3, faqe 18-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore., të marrë masat për emërimi i punonjësve në strukturën e NJAB në përputhje me kuadrin rregullator ligjor, si dhe përditësimin e rregullores së brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të institucionit dhe me bazën rregullatore të auditimit të brendshëm.

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa për:

-Hartimin dhe miratimin e Programit për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë së veprimtarisë audituese;

-Shqyrtimin e risqeve më të rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e projekteve, programeve në të cilat janë fokusuar objektivat strategjike, të njësive publike;

-Në raportet e hartuara në përfundim të çdo angazhim auditimi, audituesit të respektojnë strukturën e përcaktuar dhe të plotësojnë opinionin e përgjithshëm lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023, rezulton se:

Nuk janë zbatuar hapat për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm, sipas të gjitha fazat përkatëse në përmbushje të dispozitave ligjore përkatëse.

Buxhetet nuk janë miratuar në Këshillin Bashkiak sipas afateve ligjore të përcaktuara.

Për vitin 2023, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifikën e rishikuar ka vlerën 1,449,652,029 lekë ndërsa realizimi është në vlerën 978,111,490 lekë ose në masën 67.4%.

Zëri investime si një ndër zërat kryesore në buxhet që ndikon direkt në të mirat e komunitetit është realizuar në masën 64.8%, ku nga vlera e parashikuar prej 348,260,630 lekë është realizuar në vlerën 225,715,120 lekë. Shpenzimet operative së bashku me fondin rezervë janë planifikuar në vlerën 206,628,850 lekë dhe realizuar në vlerën 145,363,580 lekë ose në masën 70.3%.

Këto mosrealizime vijnë si rezultat i mungesës së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës, pasi nga Bashkia Rrogozhinë në fillim të vitit buxhetor nuk janë planifikuar angazhime buxhetore realiste, duke u mbështetur tek planifikimi i të ardhurave dhe jo tek faktiku i vitit të mëparshëm.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 41, “Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vjetor”, pika 1 dhe neni 46 “Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendore”, Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025” paragrafi I, “Afatet e përgatitjes të kërkesave të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar.

3.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social të marrin masat për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm, duke ndjekur të gjitha fazat përkatëse në përmbushje të dispozitave ligjore përkatëse, si dhe miratim e tyre në Këshillin Bashkiak brenda afateve ligjore.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se vlera e faturave të palikujduara në fund të periudhës 01.01.2022 ka rezultuar në vlerën 281,220,713 lekë (detyrime të prapambetura progresive). Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2023 vlera 0 lekë. Gjatë vitit 2023 është krijuar detyrim në vlerën 148,640,650 lekë dhe likuiduar në vlerën 281,327,111 lekë. Pra në total, gjatë vitit 2023 vlera e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2023, është në vlerën 148,534,252 lekë.

Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penaltitësh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura, moszbatim të kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, vlera jo të besueshme për detyrimet e prapambetura, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101 “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social të marrin masat për ndërprerjen e angazhimeve për investime/shërbime pa fondet e nevojshme në dispozicion, kjo për të mos lejuar krijimin e detyrimeve të reja, si dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura.

Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën 238,288,150 lekë dhe realizimi në vlerën 141,685,369 lekë ose në masën 59.4% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 96,602,781 lekë. Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, germa “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik të marrë masa që:

- Në hartimin e planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e

prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

- Të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

- Që rakordimet me Degën e Thesarit Kavajë në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të kryer sipas kodeve të paketës fiskale, me qëllim evidentimin e realizimit të secilës taksë apo tarifë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje ka rezultuar se vetëm në 15 raste, nga inspektorët tatimorë janë mbajtur akt konstatime për subjektet që nuk ushtrojnë aktivitet, ndërkohë që këto subjekte janë aktive në QKB. Mos kryerja e inspektimeve në terren nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, krijon risk për ushtrimin nga subjektet të aktivitetit, pa u pajisur me licencat përkatëse, duke krijuar të ardhura të munguara për institucionin

Gjithashtu gjatë vitit 2023 ka ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Rrogozhinë 1 subjekt në fushën e ndërtimit i cili nuk kanë hapur NIPT sekondar në zbatim të detyrimeve ligjore.

Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, neni 22, nenet 48-49.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për:

- Kryerjen e inspektimeve në terren në lidhje me statusin e subjekteve dhe të gjitha subjekteve që nga konstatimi ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar në QKB, t’u përlllogariten taksat dhe tarifat vendore përkatëse.

- Të gjithë subjektet që kanë lidhur kontratë investimesh me bashkinë, pajisjen e tyre me NIPT sekondar dhe përlllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore deri në momentin e përfundimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të karburantit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Rrogozhinë dhe njësisive administrative është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga **15 subjekte**.

Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2023, gjithsej rezultojnë **14 subjekte** të pajisura me autorizim me afat 1-5 vjeçar, këto subjekte e kanë paguar të plotë vlerën e autorizimit sipas rastit. Ndërkohë që për 1 subjekt me aktivitet tregtimin e karburanteve që operojnë në territorin e Bashkisë Rrogozhinë të pa pajisur me autorizimin përkatës, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa liçencë, kërkesë për bashkëpunim nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të 197 kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, germa “b” dhe pika 9 dhe 15.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Bashkia Rrogozhinë, Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa të menjëhershme për pezullimin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitetet për tregtimin karburanti pa u pajisur me autorizim/liçencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore, kullosore dhe improduktive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Rrogozhinë, rezulton se:

Në territorin e Bashkisë Rrogozhinë ushtrojnë aktivitetet 3 subjekte, “H” ShPK, “S & V” ShPK dhe “K-T” ShPK, të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullosore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private.

Këto veprime janë në kundërshtim me Nenin 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin kullosor”, pikat 3, 7, 9, 10, 11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008, “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Gjithashtu në bashkëpunim me Policinë Bashkisë dhe Inspektoriatin Mbrojtjes Territorit (IMT), nuk duhet të lejojë që në territorin e sajë të përdorin sipërfaqe pyjore/kullosore pa kontratë me bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Rrogozhinë nga titullari i institucionit janë ngritur komisionet përkatëse. Nga auditimi i pasqyrave financiare ushtrimore konstatohet se për vitin 2023 nuk është realizuar procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit, ky proces ka mbetur në fazën e ngritjes së grupeve të punës. Në kushte të tilla pasqyrat financiare nuk japin siguri në lidhje me vlerat e kontabilizuara në aktiv, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimit Social, të marrin masa për zbatimin dhe ndjekjen e urdhrave për inventarizimin e aktiveve të institucionit në fund të çdo viti, duke ndjekur punën e komisioneve deri në hartimin e relacioneve përfundimtare për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare vitin 2023, rezulton se Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2023 në vlerën 386,641,108 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023 në vlerën 285,127,409 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 285,127,409 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 49,166,662 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 49,166,662 lekë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 49 dhe pika 50.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social të marrë masa për kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare vitin 2023, rezulton se gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 38,491,329 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 45,738,086 lekë me një rritje në vlerën 7,246,757 lekë.

Në këtë llogari nuk është përfshirë vlera 228,075,033 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitorë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorisë së Financës dhe Shërbimit Social. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Të ardhura për t’u marrë”, si dhe pasqyrimi në kontabilitet i të gjitha detyrimeve nga taksat e tarifatat vendore.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare vitin 2023, rezulton se Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 32,709,998 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,844,001 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,800,000 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 34,553,999 lekë. Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti me objekt “Studim Projektim i rrjetit të brendshme ujësjellësi” në vlerën 3,354,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohej në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar dhe ky projekt ka përfunduar,

si rrjedhë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit -Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,354,000 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara. Gjithashtu dhe për vlerën e projekteve të tjera të cilat nëse prokurohen duhet ti kalojnë vlerës së investimit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se, janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 212,246,062 lekë që i përket objektit “Ndërtimi i rrjetit të brendshëm i ujësjellës të qytetit Bashkia Rogozhinë Faza e III”, në Ujësjellës Kanalizime Sh.a Rogozhinë (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Rogozhinë. Nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Rogozhinë dhe Ujësjellës Kanalizime Sh.a Rogozhinë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Bashkia Rogozhinë në bashkëpunim me Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Rogozhinë të marrin masa për hartimin e procesverbaleve për transferimin dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në vlerën kontabël 212,246,062 lekë, si dhe të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

15. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terene” në vlerën 5,839,355 lekë kosto historike është përfshirë vlera 5,839,355 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

b. Në gjendjen e llogarisë 211 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 1,596,452 lekë kosto historike është përfshirë vlera 1,483,547 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

c. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 441,699,446 lekë kosto historike është përfshirë vlera 319,460,588 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

d. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,661,408,118 lekë kosto historike është përfshirë vlera 583,641,133 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

e. Në gjendjen e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 12,201,621 lekë kosto historike është përfshirë vlera 7,951,055 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

f. Në gjendjen e llogarisë 215 “Mjete transporti” në vlerën 34,016,264 lekë kosto historike është përfshirë vlera 7,042,960 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

g. Në gjendjen e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 42,051,090 lekë kosto historike është përfshirë vlera 31,337,048 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Vlerat e mësipërme janë trashëguar nga bilanci i ish-komunave Rogozhinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar që ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 59,836,638 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Rogozhinë me NIPT J.....L është 62,051,960 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës me NIPT M.....M. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Rogozhinë 1,340,322 lekë ose 2.16% ($2.16 \times 62,051,960 / 100 = 1,340,322$ lekë). Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare K.F.E me NIPT M.....Q është 3,500,000 lekë. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Rogozhinë është 875,000 lekë ose 25% ($25 \times 3,500,000 / 100 = 875,000$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 62,051,960 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Sociale, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 241,332,528 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 223,850,372 lekë dhe pakësim në vlerën 281,262,423 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 183,920,477 lekë. Në gjendje të llogarisë janë kontabilizuar aktive me objekt “Blerje konditioner Bashkia Rrogozhinë” në vlerën 778,900 lekë dhe “Blerje kompjutera Bashkia Rrogozhinë” në vlerën 789,000 lekë të cilat duhet të përfshiheshin në llogarinë 218 “**Inventar ekonomik**”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Sociale të marrë masa për sistemin e vlerës 1,567,900 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar, të shpenzimeve të likuiduara për blerje mallrash, që i përkasin llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” duke i kontabilizuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

18. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 183,920,477 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 183,920,477 lekë, nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, germa “c”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Çështjeve Sociale pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Rrogozhinë dhe Njësi Administrative Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1.

Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Rrogozhinë, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, pra

nuk ka një sektor/strukturë të posaçme, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar dhe më pas regjistrimin në kadastrë.

- Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik”, konstatohet se nga Bashkia Rogozhinë disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel ku në të specifikohet analitikët e këtyre llogarive si informacion për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia.

Bashkia Rogozhinë ka në pronësi në total **2233 pasuri** të transferuara sipas VKM-ve përkatëse për të cilat janë pajisur me çertifikatë pronësie 8 pasuri.

Për aktivitetet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Rogozhinë të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 8 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie.

Nga Bashkia Rogozhinë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Bashkia Rogozhinë të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 4,870,302 lekë. Në gjendjen e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” janë përfshirë edhe pagesat e sigurimeve shëndetësore në vlerën 578,172 lekë ku sipas parimit kontabël kjo vlerë duhet të kontabilizohet në llogarinë 436 “Sigurime shëndetësore”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Sociale të marrë masa për sistemin e vlerës 578,172 lekë, e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të shpenzimeve mbi sigurimet shëndetësore, që i përkasin llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” duke i kontabilizuar në llogarinë 436 “Sigurime shëndetësore”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Rogozhinë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 49,116,662 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Kavajë. Për **22 objekte** të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Rogozhinë janë ngurtësuar fonde në vlerën **8,656,870 lekë** për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Kavajë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 8,656,870 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Rogozhinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimit Ekonomik të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontrator për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimit të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 1,984,651,618 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 71,630,753 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 24,425,050 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 71,630,75 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 24,425,050 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 96,387,066 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 17.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 55-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social të marrë masa për kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi 2 procedurave të prokurimit publik me vlerë mbi kufirin e ulët monetar (nga 2 të prokuruar gjithsej), të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, në vlerën totale të fondit limit prej 14,200,000 lekë, u konstatua se kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes të disa kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT, veprime këto në mospërputhje të plotë me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 84-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Titullari i AK Bashkia Rrogozhinë, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Rrogozhinë ka realizuar në total 33 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 29,800,000 lekë pa TVSh dhe realizuar me vlerë kontrate 24,478,996 lekë pa TVSh. Nga 33 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 29,800,000 lekë pa TVSh janë audituar 33 procedura ose në masën 100%, ku janë konstatuar problematikat si më poshtë:

- Në **5 procedura** prokurimi me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 4,900,000 lekë pa TVSh duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me tenderim.
- Në **32 raste** nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administroj dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.
- Në **9 raste** nuk dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit.
- Në **15 raste** nga KPVV është hartuar një preventiv, por në këtë dokument nuk argumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit.
- Në **33 raste** nuk është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla.
- Në **6 raste** preventivi i punimeve është hartuar nga punonjës të cilët nuk janë të pajisur me licencat përkatëse profesionale në fushën e projektimit.
- Në **30 raste** nga KPVV nuk është publikuar në SPE procesverbali mbi argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit.
- Në **7 raste** në lidhje me kriteret e vendosura nga KPVV, janë konstatuar kritere jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çënojnë pjesëmarrjes e operatorëve ekonomikë të interesuar.
- Në **33 raste** nga KPVV në SPE është dërguar ftesë pesë operatorëve ekonomikë, ku referuar të dhënave të publikuara në QKB konstatohet se asnjë prej operatorëve ekonomikë të cilët është dërguar ftesa nuk ka në veprimtarinë e tij objektin që prokurohet.
- Në **8 raste** në Sistemin e Prokurimit Elektronik nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë), pra kalimi nga një operatorë ekonomik tek tjetri në rastet e s'kualifikimit apo të tyre.
- Në **7 raste** nga KPVV nuk është mbajtur procesverbali i s'kualifikimit për kalimin nga një operator ekonomik tek tjetri.
- Në **15 raste** faturat tatimore nuk janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.
- Në **16 raste** mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë.
- Në **18 raste** nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues në fazën e dorëzimit të mallrave janë konstatuar mangësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë.
- Në **2 rast** në dosjen e procedurës së prokurimit nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 36, pika 4, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5, Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 72, pika 4, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-37 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 7, pika 11, pika 12, pika 18.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 76-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në dokumentimin e kërkesave, publikimin e dokumenteve në sistemin elektronik dhe respektimin e afateve, në mundësinë e mos copëzimit të fondeve, përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave, etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 1943 prot, datë 26.04.2021, me objekt “Rikonstruksioni i ujësjellësit Gosë”, Bashkia Rrogozhinë dhe kontratës me nr. 534/2 prot, datë 04.02.2021, me objekt “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të fshatrave Lekaj, Harizaj, Kryeluzaj, Zambisht, Okshtun dhe Mushnik, Nj. A. Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë, fituar të dyja nga BOE “B-B” ShPK & “P. v” ShPK & “D-C Company” SHPK, rezultoi se deri në fund të auditimit në subjekt (datë 05.04.2024), ose më shumë se tre vjet nga lidhja e kontratave, punimet nuk kanë përfunduar. Amendamentet për shtyrjen e afateve të përfundimit të punimeve janë të paargumentuara teknikisht.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UKM Nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 7.2 dhe UKM Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 13.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 84-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Rrogozhinë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për shtyrjen e paargumentuar të afatit të përfundimit të punimeve, të penalizojë konform kontratës shoqërinë kontraktore për mosrespektimin e afateve kontraktuale për përfundimin e punimeve, duke e nxitur njëkohësisht për marrjen e masave për përfundimin sa më shpejt të këtyre dy objekteve, me qëllim dhënien në kohë qytetarit të produktit të investuar nga fondet buxhetore.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy)** raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i lartësisë minimale të lejuar për katin përdhe me përdorim banim, respektimi i Koeficientit të Shfrytëzimit të Territorit, distancat urbane midis objekteve, nga kufiri i pronës dhe nga trupi i rrugës, si dhe mosrespektimi i numerit minimal të detyrueshëm të vend-parkimeve. Më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit, me zhvillues shoqëria “A-V” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 318, datë 24/04/2023

2. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum, me zhvillues shoqëria “B-C” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 406, datë 22/12/2023.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 34, pika 2; neni 35, pika 1; neni 36, pika 3, nënpika c); Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Rrogozhinë, neni 10, pika 1, nënpika d); neni 16 dhe pasaporta e njësisë strukturore A14-08; neni 28, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

26.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Politikave Urbane (DPU), Bashkia Rrogozhinë të merren të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane të parashikuar në dispozitat ligjore dhe rregullatore, në çdo rast të respektohen distancat urbane nga kufiri i pronës, trupi i rrugës dhe midis objekteve kufitare, sipas përlllogaritjes së parashikuar në rregullore, me qëllim zhvillimin e kontrolluar të territorit; të respektohet lartësia e lejuar e kateve të objektit, sipas funksioneve të përcaktuara; të respektohet Koeficienti i Shfrytëzimit të Territorit (KSHT), duke e llogaritur sipas përcaktimeve të rregulloreve në fuqi; në çdo rast të kërkohet respektimi i numrit minimal të vend-parkimeve në katet nëntokësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në **3 (tre) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit, me zhvillues shoqëria “A.V” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 318, datë 24/04/2023.
2. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum, me zhvillues shoqëria “B-C” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 406, datë 22/12/2023.
3. Çertifikatë përdorimi për banesë 2 kate, me adresë fshatin Kërçukaj, nj. Adm. Gosë, me zhvillues z. K. V, për të cilën është marrë Vendimi nr. 393; datë 30.11.2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Shtojca II; Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 3; neni 15, pika 1, nënpika c), e), ë), g); pika 1/1, nënpika(i), (iii); neni 27/1, pika 2; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), j), k), gj)

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

27.1 Rekomandimi: Drejtoria e Politikave Urbane (DPU), Bashkia Rrogozhinë, të marrë të gjitha masat për:

- Të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij;
- Të marrë siguri të lartë mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve;
- Të miratuar vetëm ato aplikime për pajisje me çertifikatë përdorimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas dispozitave ligjore dhe rregullatorë në fuqi. DPU të kërkojë në çdo rast, ngarkimin në sistemin e-lejet të fotove në të gjitha orientimet të objektit që kërkon të pajiset me çertifikatë përdorimi;
- Të kontrolluar zhvillimin e objekteve të miratuar gjatë ndërtimit, duke kërkuar hartimin e akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore, si dhe ushtrimin e kontrollit në territor në fazën e hartimit të akt-kontrolleve të përfundimit të karabinasë dhe sistemimeve të jashtme.

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Bashkia Rrogozhinë dhe Drejtoria e Politikave Urbane nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik të banesave sociale. Në përmbushje të përcaktimeve ligjore të nenit 19 të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, pika 1, çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m², siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Këto anomali janë konstatuar në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit për objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum, me adresë në Rrugën e Kavajës, Lagja nr. 1, Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “B-C” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 406, datë 22/12/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, në të cilën nuk janë përcaktuar sipërfaqet të cilat do të kalojnë në favor të fondit publik të banesave sociale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

28.1 Rekomandimi: Drejtoria e Politikave Urbane (DPU) dhe Drejtoria Juridike, Bashkia Rrogozhinë të marrë masa për të hartuar akt-marrëveshjen midis zhvilluesve të cilët ndërtojnë objekte me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m² dhe Drejtorisë Juridike, duke përcaktuar sipërfaqet dhe apartamentet të cilat do të kalojnë në favor të fondit për strehim social, përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria e Politikave Urbane (DPU), Bashkia Rrogozhinë, nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale në lidhje me inspektimin e objekteve përpara dhe gjatë ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit, me adresë në fshatin Spille, Bashkia Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria “A-V ” ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 318, datë 24/04/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi është pajisur me dokumentin e Njoftimit të Fillimit të Punimeve në datën 08.06.2023. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Shtator 2023 (pra, me një diferencë kohore për afërsisht tre muaj) konstatohet se objektet me funksion akomodues janë në një fazë të përparuar të ndërtimit, ku dallohen mbulesat e sipërme të objektit, gjithashtu dallohen muret perimetral të ndërtuar. Referuar grafikut të punimeve, marrim informacionin se ndërtimi i mureve perimetrale me tulla të lehtësuara dopio është parashikuar të kryhet në muajin e gjashtë pas fillimit të punimeve. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me nenit 39 të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 105-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

29.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Politikave Urbane, Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), të merren masa për kryerjen e inspektimeve në territor, përpara fillimit të punimeve, si dhe gjatë zhvillimit të objekteve me leje ndërtimi të miratuar, me qëllim marrjen e një sigurie të lartë se subjekti zhvillues ka plotësuar të gjitha kriteret që rrjedhin nga dispozitat ligjore dhe rregullatorë, përpara fillimit të punimeve

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** nuk janë respektuar afatet kohore të parashikuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikata përdorimi. Më konkretisht:

1. Leje ndërtimi për fshat turistik (kompleks vilash turistike) + strukturë shërbimesh në funksion të kompleksit, me adresë në fshatin Spille, Bashkia Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria "A-V" ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 318, datë 24/04/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, e cila është shqyrtuar për 147 ditë pune;

2. Leje ndërtimi për objekt banimi dhe shërbimi 1 dhe 6 kate + 1 kat podrum, me adresë në Rrugën e Kavajës, Lagja nr. 1, Rrogozhinë, me zhvillues shoqëria "B-C" ShPK, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 406, datë 22/12/2023, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, e cila është shqyrtuar për 234 ditë pune.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 92-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

30.1 Rekomandimi: Drejtoria e Politikave Urbane, Bashkia Rrogozhinë, të marrë të gjitha masat për të shqyrtuar aplikimet që vijnë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, brenda afateve të parashikuara në dispozitat ligjore dhe rregullatorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV-ja për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi konstatohet se:

- Janë proceduar gjithsej **15 subjekte** për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit të pa shoqëruara të gjitha me Vendim për "Prishje të Objektivit të Kundërligjshëm".

Në **5 raste**, Kryeinspektori nuk ka nxjerrë "Vendim për Prishje" në kundërshtim me nenin 5 pika "d" të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Në **7 raste**, nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektivit të Kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishjeje vijnë të pa ekzekutuara nga IMT-ja e Bashkisë Rrogozhinë, duke u bërë shkaktarë i rritjes së numrit të ndërtimeve in formale që kalojnë në procesin e legalizimit, ku subjektet kanë përfituar parcela ndërtimore në pronësi publike, në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, në kundërshtim me nenin 5, pika (d) të ligjit nr. 9780/ 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar; nenin 52 (6) i Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar; pikën 1 (b)(iv) i Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 98-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

31.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Rrogozhinë, të vijojë procedurën për nxjerrjen e Vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", për **5 subjekte** që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi dhe të nxjerrë "Urdhër Ekzekutimi" për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për **7 subjekte** që janë me Vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm".

Menjëherë dhe në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore mbi veprimtarinë e IMTV Bashkia Rrogozhinë, u konstatua se ka ushtruar funksionet e veta jo në përputhshmëri të plotë me detyrimet që përcakton ligji, i vijon:

- Struktura e IMT nuk është organizuar në përputhje me dispozitat ligjore, pasi si Kryeinspektori dhe Inspektori nuk janë arsimin e nevojshëm;
- Kryeinspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtim;
- Kryeinspektori, nuk ka miratuar planet vjetore dhe mujore të punës
- Mungesa e një bashkëpunimi eficient, midis IMTV-së dhe DPZHT-së, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit
- Në 4 raste, IMTV-ja e Bashkisë Rrogozhinë nuk i është drejtuar Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor me kallëzim penal.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5 germat (a, f, dh), neni 11 të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar, pikën (3) të nenit 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, si dhe me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 98-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, të marrë masat që në strukturën organizative të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të punësohen vetëm ata punonjës të cilët plotësojnë kriteret e duhura kualifikuese arsimore.

32.2. Rekomandimi: Inspektoriat i Mbrojtjes Territorit Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa si vijon:
-Mbajtjen e aktkontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

-Moslejimin e zhvillimit të ndërtimit në kushtet e mungesës së lejes së zhvillimit dhe të ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

-Në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.

-Rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Politikave Urbane, për shkëmbimin e informacionit midis tyre. Realizimin e kontroleve periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar nëse zbatimi i punimeve kryhet sipas projektit të miratuar.

-Përgatitjen e planeve vjetore dhe mujore të punës dhe informacionin periodik tre mujor ndaj Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 203/16 prot., datë 15.09.2023, protokolluar në Bashkinë Rrogozhinë me nr. 3296 prot., datë 18.09.2023, rezulton se:

Nga Bashkia Rrogozhinë nuk janë masat e duhura për raportimin në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve, duke mos respektuar afatin 20 ditor. Gjithashtu nuk është raportuar dhe për ecurinë e tyre në afatin 6 mujorë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j” dhe neni 30, pika 2.

a. Nga **30 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa, 2 masa janë në proces zbatimi, **5 janë zbatuar pjesërisht dhe 20 janë të pa zbatuara.**

b. Nga **2 masa shpërblim dëmi** në vlerën **788,183 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat **nuk është zbatuar asnjë masë nga subjekt me vlerë 788,183 lekë.**

c. Nga **5 masa** për të ardhura të munguara në vlerën **391,967,138 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat 1 (një) masë është zbatuar pjesërisht dhe **4 masa janë të pa zbatuara.**

d. **Për eliminimin e efekteve negative** të konstatuara në administrimet e fondeve publike është rekomanduar 1 masë në vlerën 627,332,000 lekë, pranuar 100% nga subjekti e cila është zbatuar pjesërisht.

e. Nga **11 masa disiplinore**, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa dhe **8 masa janë të pa zbatuara.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 114-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

-Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimin e tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

-Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

1.2. Rekomandim: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil si dhe të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke marrë masa për certifikimin e audituesve të pa certifikuar.

2.3. Rekomandim: Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Rrogozhinë.

3.1. Rekomandim: Në Bashkinë Rrogozhinë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa që të paraqesin projektet e planifikuara për buxhetin me të gjitha specifikimet sipas kërkesave ligjore dhe EMP të secilit program, të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e Planit të zhvillimit vendor dhe Strategjive Kombëtare kryesisht atyre të mjedisit dhe pyjeve, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

4.1 Rekomandim: Në Bashkinë Rrogozhinë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

5.1. Rekomandim: Kryetari e Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e

lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim zvogëlimin e detyrimeve të prapambetura.

7.2. Rekomandim: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të nisin procedurat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie dhe të rivlerësojnë aktivet e bashkisë, me qëllim kontabilizimin e vlerave të sakta të tyre në llogaritë përkatëse të AAGJM në pasqyrat financiare.*

7.3. Rekomandim: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me njësitë e tjera në strukturë të hartojnë regjistrin e asetëve të bashkisë, ku të identifikohen dhe të pasqyrohen gjithë të dhënat konform udhëzimeve ligjore.*

7.4. Rekomandim: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të nisin procedurat pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për pajisjen me certifikata pronësie dhe të rivlerësojnë aktivet e bashkisë, me qëllim kontabilizimin e vlerave të sakta të tyre në llogaritë përkatëse të AAGJM në pasqyrat financiare.*

8.1. Rekomandim: *Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ligjore, Burimeve njerëzore dhe Komunikimit, menaxherët e të gjitha njësive të strukturës në Bashkinë Rrogozhinë të kompozojnë dhe miratojnë një strukturë organizative konform funksioneve që i atribuon ligji, për rritjen e efektivitetit të shërbimeve që bashkia i ofron komunitetit.*

9.1. Rekomandim: *Titullari i AK, të ngrejë grupe pune me urdhrat përkatës për përlllogaritjen e fondit limit pa copëzuar fondet, duke evidentuar mënyrën e ndjekur sipas rregullave të prokurimit publik duke dokumentuar me procesverbalet përkatëse procesin e vlerësimit, renditjes, tërheqjes dhe ftesën e OE për të lidhur kontratë.*

9.2. Rekomandim: *Komisioni për Blerjet e Vogla, të dokumentojë me procesverbalet përkatëse procesin e vlerësimit, renditjes, tërheqjes dhe ftesën e OE për të lidhur kontratë. Të administrohen dokumentet e OE me të cilët lidhet kontrata, dhe në çdo rast të shoqërohet me fletë hyrjen e mallit në magazinë, të firmosur nga personi përgjegjës.*

9.3. Rekomandim: *Të evitohet copëzimi i fondeve nga AK. Procedurat për mallra/ shërbime me objekt të njëjtë ose të ngjashëm, të kryhen nëpërmjet procedurave në përputhje me vlerën e fondit përkatës kur ajo e kalon vlerën 1,000,000 lekë, dhe jo të copëzohet në disa të tilla.*

9.4. Rekomandim: *Drejtoria e Financës në Bashkinë Rrogozhinë, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.*

10.1. Rekomandim: *Drejtoria e Planifikimit Urban në procesin e miratimit për lejet e ndërtimit, të respektojë rregullat e zhvillimit të territorit kjo për të mundësuar trajtim të barabartë të parametrave teknik të zhvillimit, duke mos cenuar të drejtat e zhvillimit të subjekteve tjera sipas njësive strukturore.*

11.1. Rekomandim: *Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit.*

11.2. Rekomandim: *IMT Bashkia Rrogozhinë, të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.*

11.3. Rekomandim: *IMT Bashkia Rrogozhinë, të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve. Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.*

11.5. Rekomandim: *IMT Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Taksave, të bashkërendojnë punën për të mundësuar arkëtimin e gjobave të nxjerra.*

12.1. Rekomandim: *Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik/Bashkia Rrogozhinë të marrë masat për krijimin e një regjistri elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të*

klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit.

12.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik.

12.3. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Rrogozhinë nga taksat që mbledhen nga këta agjent. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Rrogozhinë të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;

13.1. Rekomandim: Kontrolli i Lartë i Shtetit inkurajon subjektin Bashkia Rrogozhinë që krahas punës që ka bërë për zbatimin e rekomandimeve, të vijojë procedurat administrative e ligjore për zbatimin e masave të pazbatuara dhe në proces zbatimin deri në mbylljen e plotë të tyre.

B. Masa shpërblim dëmi

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **93,600 lekë pa TVSh** nga BOE "B-B" Shpk & "B. N" Shpk & "M" Shpk & "P- V" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2283 prot., datë 07.05.2020, me objekt: "Rikonstruksion i rrug. të lagjes sipër Stacionit të Trenit faza I", Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **694,583 lekë pa TVSh** nga BOE "B-I" Shpk, & "Sh" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1521/2 prot., datë 26.05.2021, me objekt: "Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë.", Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

C. Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave e Zhvillimit Ekonomik /Bashkia Rrogozhinë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifën vendore progresive në vlerën totale 343,141 mijë lekë (familjarë dhe biznese), duke ndjekur procedurat si më poshtë vijon:

-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.

-Të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme/Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme)

-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

-Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Rrogozhinë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, duke i njoftuar nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) dhe ndjekjen e konfirmimit prej familjeve, të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit etj.

1.2. Rekomandim: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtorinë Ligjore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 38,580,035 lekë dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Kavajë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

1.3. Rekomandim: DAZHE në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj 5 subjekteve për arkëtimin e vlerës 4,100,000 lekë krijuar nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.

1.4. Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutivë, duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën totale 5,700,000 lekë.

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **446,103 lekë** ndaj subjektit R. K për taksën e ndikimit në infrastrukturë e cila është përlllogaritur gabim nga personat përgjegjës.

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të marrë masat për hartimin e kriterëve teknike në dokumentet e tenderit, të argumentuara dhe në përputhje me objektin e kontratës dhe të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimin pa ekonomicitet dhe eficencë të fondeve publike për vlerën **627,332 mijë lekë pa TVSh.**

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Sharrdushk (Pjec) - Kryevidh, L=1400 ml”, Bashkia Rrogozhinë, me vlerë të kontratës (me TVSh) 13,994,400 lekë me TVSH, fituar nga OE “A-A” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 80,300 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 753 prot datë 24.02.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë dhe OE “A-A” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 84-92, të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **80,300 lekë pa TVSh** nga OE “A-A” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 753 prot datë 24.02.2023, me objekt “Sistemim Asfaltim rruga Sharrdushk (Pjec) - Kryevidh, L=1400 ml”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit, Loti III”, Bashkia Rrogozhinë, me vlerë të kontratës (me TVSh) 246,446,031 lekë me TVSH, fituar nga OE “H” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 77,578 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2862 prot, datë 07.08.2019, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Rrogozhinë dhe OE “H” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 84-92 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Rrogozhinë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **77,578 lekë pa TVSh** nga OE “H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2862 prot, datë 07.08.2019, me objekt “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit, Loti III”, Bashkia Rrogozhinë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se deri më datën 31.12.2022, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë dhe biznesi i madh i vogël në vlerën **162,634,404 lekë**. Gjate vitit 2023 janë krijuar debitorë në vlerën **35,273,359 lekë**. Në total detyrimet tatimore në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, për abonentët familjarë dhe subjektet fizik/juridik janë në vlerën **197,907,763 lekë e cila përbën të ardhura të munguar për Buxhetin e Bashkisë Rrogzhinë**, pasi nuk janë të kontabilizuar në pasqyrat financiare, si më poshtë:

- vlera 130,935,324 lekë për 4235 familje nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore;
- vlera 35,448,527 lekë për 4604 familje nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës;
- vlera 17,858,354 lekë për 4663 familje nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit;
- vlera 13,665,558 lekë për 4359 familje nga mos arkëtimi i tarifës së shërbimit komunitar;

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në **vlerën totale 208,542,829 lekë**, në zbatim të kuadrit ligjorë në fuqi.

Menjëherë dhe vijmësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Rrogzhinë për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, rezulton se janë vendosur **15** gjoba në vlerën prej 6,840,000 lekë, të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit Ekonomik, Sektori juridik dhe IMTV nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" . Gjithashtu nga IMTV dhe sektori Juridik përgjatë periudhës objekt auditimi nuk është bërë asnjë kërkesë për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit të gjobave.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Ligji, nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative”.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.6, faqe 98-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: IMTV-ja dhe Drejtoria Juridike e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun të marrë masa për kryerjen e të gjitha procedurave që ligji parashikon, për të bërë të mundur

arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **6,840,000 lekë**, të vendosura nga IMTV. Gjithashtu, të merren masat për përlllogaritjen e kamat-vonesës dhe vjeljen e saj në çdo rast që gjobat nuk paguhen brenda afateve të përcaktuara, për vendosjen në dijeni dhe rritjen e bashkëpunimit me Shërbimin Përmbartimor, si dhe Drejtorinë e Financës dhe Shërbimit Social Bashkia Rrogozhinë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Politikave Urbane Bashkia Rrogozhinë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave emërore për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALIZNI-t Kavajë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe të destinuara për regjistrim në ZVRPP (sot ASHK Kavajë).

Referuar të dhënave të evidentuara në auditimin e ushtruar nga KLSH në auditimin e mëparshëm situata debitorë për mos pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale më datë 31.12.2022, është në vlerën 26,778,170 lekë për 1018 persona, ndërsa për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, nga Drejtoria e Politikave Urbane nuk disponohen aktrakordime dhe të dhëna në lidhje me situatën debitorë për mos likudimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se nga ASHK Kavajë nuk janë evidentuar sipërfaqet e objekteve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **26,778,170 lekë për 1018 persona.**

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Rrogozhinë ka lidhur 63 kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve të plazheve në zonat bregdetare si Spille (Kryevidh) dhe Vilë-Bashtovë (Gosë). Deri në fund të vitit 2023 janë debitorë **2 subjekte në vlerën 913,660 lekë**, respektivisht: subjekti “A . M me Nipt L.....Q për vlerën 292,660 lekë dhe subjekti “K” për vlerën 621,000 lekë .

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Rrogozhinë ka aktive 6 kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve të nga asetet e fondit pyjor kullosor. Deri në fund të vitit 2023 është debitorë **1 subjekt në vlerën 2,475,500 lekë**, për subjektin “S. Gj” me Nipt M.....B.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e sipërfaqeve të plazheve dhe ato të fondit pyjor kullosor në vlerën **3,389,160 lekë**, sipas kushteve të kontratës, respektivisht:

- **vlera 292,660 lekë**, ndajë subjektit “A.M”;
- **vlera 621,000 lekë**, ndajë subjektit “K”;

- vlera **2,475,500 lekë**, ndajë subjektit “S. Gj”.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se detyrimet për subjektet fizik dhe juridik progresiv deri me 31.12.2023 janë në vlerën **43,542,236 lekë**, nga e cila kamatëvonesë në vlerën 5,319,033 lekë, vlerë e cila është kontabilizuar në pasqyrat financiare dhe njohët nga subjekti si detyrim, por që nuk ka ndërmarrë hapet e nevojshëm ligjore për arkëtimin e tyre në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2.6, faqe 42-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtorja e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për vlerën detyrimit prej **43,542,236 lekë**, të subjekteve fizik/juridik sipas listave që vetë Drejtorja e Taksave administron, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin, në zbatim të kuadrit ligjorë në fuqi.

Menjëherë dhe vijimësi

E. MASA DISIPLINORE.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, dhe kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i **rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë** të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga shërbimi civil/ Largim nga puna**”, për **5 (pesë)** punonjësit, si më poshtë:

E.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

1. Z. R. V, me detyrë Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave:

Për moszbatim të nenit 98, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në procedurën “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për nevojat e Bashkisë Rrogzhinë”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

- Shkeljet e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare.

2. Z. N. T, me detyrë, “Përgjegjës i Njësisë së Auditit të Brendshëm” (për periudhën Tetor-Dhjetor 2023), për mos zbatimin e Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, pasi për çdo angazhim auditimi të kryer përgjatë vitit 2023, nuk janë evidentuar dhe dokumentuar të gjitha proceset e punës audituese, veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

3. Z. B. S, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 02.10.2023-31.12.2023), për mangësitë e evidentuara në organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Rrogzhinë. U konstatua se kjo strukturë nuk e ka përmbushur

plotësisht qëllimin e saj, garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore përkatëse, veprime në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

E.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës .

1. Z. I. B, në cilësinë e nëpunësit pranë Drejtorisë së Politikave Urbane, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara, për **3 (tre)** raste. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me:

- mosrespektimin e kondicioneve urbane në dy raste, siç janë mosrespektimi i lartësisë maksimale të lejuar, Koeficientit të Shfrytëzimit të Territorit (KSHT), distancat midis objekteve, nga kufiri i pronës dhe trupi i rrugës, numrin minimal të vend-parkimeve për strukturat akomoduese;
- mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi në tre raste;
- nuk janë respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me kontributin që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik të banesave sociale në një rast;
- shqyrtimi i aplikimeve me afate të tejzgjatura, më shumë se afatet e parashikuara në ligj në dy raste.

2. Z. A. P, me detyrë zv Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

Për moszbatim të nenit 98, pika 2, të të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në procedurën “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re.

E.3. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **4 ish- punonjësit** e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre, përkatësisht:

1. Z. G. Gj, me detyrë Drejtor i Politikave Urbane, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

-Për moszbatim të nenit 98, pika 2, të të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në procedurën “Blerje karburanti (Gazoil 10 ppm), për nevojat e Bashkisë Rrogozhinë”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

- Për parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara për **3 (tre)** raste.

2. Z. D. D, në cilësinë e Kryeinspektorit të IMTV-së (për periudhën 01.01.2023-02.10.2023), për mangësitë e evidentuara në organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Rrogozhinë;

3. Z. A. B, në cilësinë e ish Përgjegjës të Njësisë së Auditit të Brendshëm (për periudhën Janar-Tetor 2023), pasi për çdo angazhim auditimi të kryer përgjatë vitit 2023, nuk janë evidentuar dhe dokumentuar të gjitha proceset e punës audituese;

4. Z. H. P, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun (për periudhën 01.01.2023-31.12.2023), për mangësitë e evidentuara në funksionimin e veprimtarisë së Burimeve Njerëzore;

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore në pikat “E” dhe “F” më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit për punonjësit e listuar në pikën “E”, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Ti kërkojë Departamentit të Administratës Publike kryerjen e verifikimeve nëse punonjësit e listuar në pikën “F” janë pjesë e shërbimit civil dhe të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e procedurës disiplinore, mbi bazën e fakteve të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.
3. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Projekt Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHETIT